



Projekt i financuar nga BE dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Katalogu i Rekomandimeve



Projekti i BE-së "Mbështetje për Këshillin Gjyqësor të Kosovës/Këshillin Prokurorial të Kosovës

Contract 2011 / 271 – 244 & 2014 / 350 – 729



Projekt i financuar nga BE dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Hyrje në 'Katalogun e Rekomandimeve'

Shkurt 2016

Publikimi është përgatitur me ndihmën e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e vetme e Human Dynamics dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të reflektojë pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Implementuar nga Konsorciumi i Udhëhequr nga Hulla&Co. Human Dynamics





Projekt i financuar nga BE dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Hyrje në 'Katalogun e Rekomandimeve'

Historiku

Projekti "Mbështetje për Këshillin Gjyqësor të Kosovës / Këshillin Prokurorial të Kosovës" ka qenë në vitin e tretë të implementimit kur është përgatitur versioni i parë i Katalogut të Rekomandimeve, që më pas të diskutuar dhe miratuar nga KGJK dhe KPK dhe u është shpërndare të gjithë akterëve në Korrik 2014.

Kjo ka qenë koha më e përshtatshme për të gjetur një balance adekuat dhe për të konstatuar se çka është arritur nga ana e Projektit dhe çka duhet të adresohet ende.

Në tetor 2014 Projekti është zgjatur edhe për 18 muaj, dhe në këtë kohë janë shtuar aktivitete të reja në Planin e Punës së Projektit

Në kohën e hartimit të këtij raporti, Projekti është në përfundim të fazës së dytë të implementimit (Tetor 2014 – Prill 2016), dhe versioni i parë i Katalogut të Rekomandimeve është rishqyrtuar dhe ndryshuar për të pasqyruar shkallën e implementimit të rekomandimeve. Në këtë mënyrë, Projekti i siguron KGJK dhe KPK një version të ndryshuar të Katalogut që përmban një shtyllë të re "Komentet Përfundimtare – Shkurt 2016". Versioni i përditësuar i Katalogut ka për qëllim të identifikojë statusin aktual të implementimit të secilit rekomandim, duke mbështetur kështu punën e Këshillit në zbatimin e aktiviteteve të mëtutjeshme sipas rekomandimeve.

Aktivitetet e projektit janë fokusuar në katër fusha kryesore:

- Organizimi, funksionimi dhe struktura e Këshillave (Komponenti I)
- Sistemi i rekrutimit dhe emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve (Komponenti II.1 dhe III.1)
- Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve (Komponenti II.2 dhe III.2)
- Sistemi disiplinor për gjyqtarë dhe prokurorë (Komponenti II.3 dhe III.3)

Në një aneks të shtuar nga viti 2013 janë përfshirë edhe disa aktivitete shtesë:

- Mjetet juridike kundër vendimeve të KGJK/KPK (Komponenti I)
- Komunikimi Publik për KGJK (Komponenti IV)
- Sistemi Shtetëror i Centralizuar i Dosjeve Penale (SSHCDP) (Komponenti IV)

Në Planin e ri të Punës së Projektit pas zgjatjes prej 18 muajve të përshkruar më lartë, janë shtuar edhe 22 aktivitete të reja në kuadër të katër komponentëve që tashmë janë implementuar, së bashku me produktet që i janë dorëzuar KGJK dhe KPK nga Projekti.

Shtylla e re që është shtuar në Katalogun e Rekomandimeve me titull “Komentet Përfundimtare – Shkurt 2016) i referohet gjetjeve të Projektit gjatë periudhës së zgjatjes së Projektit, arritjet e Këshillave gjatë një viti e gjysmë, sfidat e reja, dhe në fund komentet në ndryshimet Ligjore të katër Ligjeve: LKGJK, LKPK, LGJ dhe LPSH të miratuara me 28 Maj 2015.

Struktura e Katalogut

Për të vlerësuar se çka është arritur dhe çka duhet të adresohet, projekti ka përgatitur një katalog gjithëpërfshirës, që përmban:

- rekomandimet kryesore të bëra gjatë tërë procesit të implementimit të projektit në fushat kryesore;
- organi përgjegjës kryesor për zbatimin e rekomandimit
- informata të shkurtra lidhur me statusin e implementimit dhe veprimet që ende duhet të ndërmerren.
- një vlerësim të statusit të implementimit duke përdorur tre indikatorë:
 - ‘J’ për ‘JO’, që nënkupton se rekomandimi nuk është implementuar
 - ‘P’ për ‘PO’, që nënkupton se rekomandimi është implementuar plotësisht
 - ‘PJ’ për ‘Pjesërisht’, që nënkupton se rekomandimi është implementuar pjesërisht.
- Referim në dokumente ndërkombëtare që përmbajnë standarde ndërkombëtare (shih më poshtë: standardet ndërkombëtare)
- Një shpjegim të shkurtër të statusit të implementimit deri në Shkurt 2016 (shtylla e fundit)

Si të lexohet katalogu?

Gjatë përgatitjes së katalogut, ka qenë e rëndësishme që të gjendet një balance mes plotshmërisë dhe dobishmërisë së katalogut. Ka qenë e rëndësishme që të përfshihen detale të mjaftueshme por jo të tepërta që të mos mbingarkohet dokumenti. Për këtë arsye, **vetëm rekomandimet kryesore** janë përfshirë në mënyrë të përmbledhur.

Një numër i konsiderueshëm i **rekomandimeve janë pranuar nga Këshillat të cilat kanë miratuar Rregulloret, Kodet dhe Planet** përkatëse. Shumica e komenteve dhe rekomandimeve që janë parashtruar në kontekstin e elaborimit të Rregulloreve **nuk janë përfshirë në katalog**. Megjithatë, ato janë

implementuar. Është e rëndësishme të theksohet se aktet ligjore në vijim duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit të statusit të implementimit të rekomandimeve:

Gjithashtu, duhet të theksohet se Projekti ka përgatitur gjithsej **shtatë Manualë gjatë periudhës fillestare të implementimit të Projektit**, që përmbajnë **128 formularë**.

- Manuali për Vlerësimin e Prokurorëve: 12 formularë
- Manuali për Emërimin e Prokurorëve: 28 formularë
- Manuali për Procedurat Disiplinore ndaj Prokurorëve në Kosovë: 10 formularë
- Manuali për Procedurat Disiplinore nga Gjyqtarëve në Kosovë: 9 formularë
- Manuali për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve: 17 formularë
- Manuali për Emërimin e Gjyqtarëve: 34 formularë
- Manuali për Hetimet në Çështje Disiplinore (ZPD): 18 formularë

Të gjithë këta manualë përmbajnë udhëzime për implementimin e rekomandimeve në fushën e emërimeve, vlerësimit dhe përgjegjësisë disiplinore në punën e përditshme të personelit mbështetës, Komisioneve të Këshillave dhe të vetë Këshillave.

Procesi i vazhdueshëm i hartimit dhe miratimit të Rregulloreve të reja dhe ndryshimeve në Rregulloret ekzistuese ka vazhduar me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtare. Rrjedhimisht ekziston nevoja për ndryshimin e PSV-ve të përgatitura nga Projekti dhe të përfshira në Manualet e listuara më lartë. Disa nga PSV-të tashmë janë ndryshuar dhe Projekti ka përgatitur edhe PSV të reja. Për shembull, Projekti ka mbështetur hartimin e një PSV të re për zbatimin e Rregullores së re të KPK për Rekrutimin, Provimin dhe Emërimin e Prokurorëve të miratuar nga KPK me 1 Dhjetor 2015. Megjithatë, të dy Këshillat ende duhet të mbështesin ndryshimin e shumicës së PSV-ve sipas kornizës së re ligjore.

Gjithashtu, Projekti ka përgatitur Tabelën Ndërlidhëse e cila i lidh dispozitat e Kodit të Etikës për Prokurorë dhe normat ligjore dhe paragrafët e Komentarit të Parimeve të Bangalorit, që tregojnë mënyrën se si duhet të aplikohen standardet ndërkombëtare në fushën e përgjegjësisë disiplinore. Fatkeqësisht, gjatë vlerësimit të statusit të implementimit të rekomandimeve në Shkurt 2016 është konstatuar se ky dokument shumë i dobishëm ende nuk është zbatuar nga organet disiplinore.

Gjithashtu, janë përgatitur 111 përshkrime të detyrave të punës dhe 3 organograme gjatë fazës së parë të implementimit të Projektit, si vijon:

- 66 përshkrime të detyrave të punës për KGJK:
- 32 përshkrime të detyrave të punës për KPK dhe Sekretariatit të Kryeprokurorit të Shtetit
- 13 për ZPD

Vlen të theksohet se krijimi i një Sekretariati të ri dhe të veçantë për KPK ne ndryshim plotësimet e LKPK kërkon zbatimin e disa masave nga ana e KPK, duke përfshirë nxjerrjen e një Rregullore të re, miratimin e organogramit të ri të Sekretariatit, rishikimin dhe ndryshimin e përshkrimeve të detyrave të punës dhe kështu me radhë.

Përfundimisht, projekti ka mbështetur – kryesisht KPK – gjatë periudhës së tranzicionit me qëllim të strukturimit të reformës deri në fund të vitit 2013 dhe ka nxjerrë një gamë të gjerë të rekomandimeve që i referohet disa akteve përgatitore. Shumica e këtyre rekomandimeve janë pranuar.

Gjithashtu, këto dokumente janë masa implementuar nga natyra dhe për këtë arsye janë pjesë e statusit të implementimit. Megjithatë, ato nuk reflektohen plotësisht në katalog.

Nëse marrin një qasje të thjeshtë numerike, është shumë e arsyeshme të supozojmë se shumica e rekomandimeve janë implementuar plotësisht gjatë fazës fillestare të Projektit, për shkak se ato janë përfshirë në Rregulloret, Kodet, përshkrimet e punës dhe Planet e miratuara si dhe në PSV-të që janë përfshirë në Manualet që janë në përdorim. Megjithatë, pas ndryshim plotësimi të katër ligjeve themelore – LKGJK, LKPK, LGJ, LPSH me 28 maj 2015, kërkohet miratimi i shumë rregulloreve të reja dhe ndryshimit dhe plotësimi të rregulloreve ekzistuese nga KGJK dhe KPK. Ndryshimet e bëra në ligjet themelore është dashur që të pasqyrohen në rregullore dhe PSV. Për këtë arsye, Projekti dhe Këshillat kanë qenë të përfshirë në një proces mjaftë intensiv të hartimit, rishikimit, komentimit dhe diskutimit të rregulloreve dhe PSV-ve gjatë 8 muajve të fundit. Të dy Këshillat kanë miratuar Planet e Punës për nxjerrjen e rregulloreve përkatëse pas ndryshimeve në ligjet themelore. Aktivitetet e projektit në këtë drejtim janë komentuar në kuadër të Raporteve Tremujore të Progresit dhe në Raportin Përfundimtar. Disa nga produktet janë përmbledhur në kuadër të komenteve të përfshira në shtyllën e re të Katalogut.

Projekti ka ofruar mbështetje të konsiderueshme për Këshillat në fushën e Planifikimit Strategjik, Zhvillimit të Politikave, Buxhetimit në Sistemin Gjyqësore dhe Prokurorial, krijimit të një Sistemi Shtetëror të Centralizuar të Dosjeve Penale gjatë fazës së dy të implementimit (Tetor 2014 – Prill 2016), që janë analizuar dhe vlerësuar në raportin përfundimtar. Shumë pak rekomandime lidhur me fushat e përmendura më lartë janë përfshirë në Katalog. Në këtë mënyrë, Katalogu nuk duhet të konsiderohet si dokument gjithëpërfshirës që i përmban të gjitha rekomandimet e Projektit.

Katalogu duhet të shihet si listë e rekomandimeve të cilat i referohen drejtpërdrejtë standardeve ndërkombëtare dhe që ende duhet të adresohen dhe jo vetëm si raport i asaj që është arritur dhe jo.

Megjithatë, është e rëndësishme që të potencohen disa pika:

- Katalogu nuk është renditur në bazë të prioritetëve. Rekomandimet janë renditur sipas fushës së tyre përkatëse dhe jo sipas rëndësisë. Është plotësisht e qartë se jo gjithçka mund të arrihet njëkohësisht. Caktimi i prioritetëve duhet të bëhet nga Këshillat, për shkak se anëtarët e Këshillave janë në pozicionin më të mirë për ti ditur nevojat urgjente, të cilat varen edhe nga shumë faktorë tjerë si, vullneti politik, buxheti i alokuar, burimet në dispozicion sa i përket kapacitetit, kohës dhe personelit. Megjithatë, nga perspektiva e Sundimit të Ligjit dhe të drejtave themelore, mund të propozohet një prioritizim në vija të përgjithshme (shih më poshtë).

- Jo të gjitha rekomandimet janë të së njëjtës rëndësi, disa nga to janë thjeshtë opsione, që i referohet shembujve të praktikave të mira.
- Një numër i madh i rekomandimeve kërkojnë ndryshimin e legjislacionit. Sa i përket kësaj çështje, nuk është në duart e Këshillave që të përcaktojnë afatet kohore dhe përmbajtjen e ndryshimeve. Megjithatë, Këshillat duhet të adresohen dhe të konsultohen pasi që mund të luajnë një rol më aktiv në zhvillimin e politikave në sektorin e drejtësisë dhe në parashtrimin e rekomandimeve të politikave për organet legislative. Ndryshim plotësimet në ligjet themelore të bëra së fundmi dhe veprimet që janë ndërmarrë nga Këshillat për implementimin e tyre sipas rekomandimeve të përfshira në Katalog janë komentuar shkurtimisht në shtyllën e fundit të Katalogut.
- Vendimet e politikave kërkojnë kohë dhe sistemi duhet të ketë kohë për 'shqyrtimin' e rekomandimeve. Në shumë raste, një rekomandim mund të implementohet në mënyra të ndryshme. Opsionet e ndryshme duhet të sqarohet, peshohen, diskutohen me akterët e ndryshëm dhe të merret vendimi përkatës. Ky është aktivitet që merr kohë. Të gjithë e dimë se ndryshimi dhe plotësimi i disa ligjeve nganjëherë merr disa vite: ato duhet të planifikohen me kujdes dhe në mënyrë transparente me përfshirjen e të gjithë akterëve përkatës. Aktivitetet e Projektit të implementuara gjatë fazës së dytë (një vit e gjysmë) kanë qenë të orientuara në masë të madhe drejt zhvillimit të kapaciteteve të Këshillave për analizimin e politikave dhe vendimet e politikave. Projekti ka përgatitur disa koncept dokumente, duke përfshirë koncept dokumentin për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, koncept dokumentin për sistemin disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve, koncept dokumentin për Projektligjin për ZPD dhe kështu me radhë. Në këtë mënyrë Projekti u ka ofruar Këshillave dokumente të reja të politikave që janë të fokusuara në zhvillimin e kapaciteteve të organeve gjyqësore në vendimet e politikave.
- Gjatë pjesës së parë të implementimit të projektit ka ndodhur edhe reformimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial si dhe miratimi i Kodit të ri të Procedurës Penale. Këto ndryshime janë implementuar me sukses gjatë vitit 2011/12 dhe kanë konsumuar shumë burime të Këshillave por edhe të projektit gjatë periudhës fillestare të implementimit të tij. Sfidat e reja për Këshillat është që të analizojnë efektshmërinë dhe efikasitetin e strukturës së re, dhe të ndërmarrin hapat e nevojshëm për fuqizimin e gjykatave dhe prokurorive të reja.
- Disa rekomandime janë shumë të përmbledhura, këto rekomandime janë shënuar me "PJ" me c' rast shumica e rekomandimeve janë implementuar dhe mbeten vetëm disa çështje të vogla që duhet të adresohen.

Standardet Ndërkombëtare

Për shumicën e rekomandimeve, Katalogu i Rekomandimeve siguron një referim në një ose më shumë dokumente që përmbajnë apo rregullojnë një standard ndërkombëtar.

Disa organe në nivel Evropian (kryesisht në nivel të Këshillit të Evropës) apo nivel ndërkombëtar (kryesisht në nivel të KB-së) kanë miratuar rekomandime, opinione apo parime lidhur me standardet e gjyqësorit në një shoqëri demokratike që i përkasin natyrës së këshillimit dhe jo të detyrimit.

Këto standarde ndërkombëtare jo detyruese synojnë theksimin e një sërë çështjesh që duhet konsideruar lidhur me administrimin e drejtësisë. Gjatë përdorimit të këtyre dokumenteve në kontekst kombëtar, përdoruesi duhet të rishikojë dispozitat e kushtetutës së vendit dhe ligjet tjera, dhe të vlerësojë rregullat, procedurat ekzistuese dhe mekanizmat e përgjegjshmërisë. Për të bërë këtë, pa dyshim, duhet të merren parasysh kapaciteti dhe burimet e tij,

dhe niveli i zhvillimit ekonomik; mekanizmat ekzistues por të ndryshëm që në mënyrë adekuate adresojnë brengat e njejta; dhe parimet fundamentale të të vet sistemit ligjor. Përfundimisht, zakonisht këto dokumente janë më të zgjëruara në fushëvperim dhe nuk radhisin një rank të masave të shtëruara që mund të miratohen lidhur me sistemin e drejtësisë; ato përgjithësisht janë të hapura ndaj qasjeve alternative që mund të plotësojnë frymën dhe kërkesat e tyre.

Përveç kësaj, duhet të theksohet që këto standarde ndërkombëtare vazhdimisht evoluojnë. Përderisa, për shembull, në Opinionin 10/2007 të KKGJE thuhet se Këshilli për Gjyqësorin mund të përbëhet vetëm nga gjyqtarët ose mund të ketë përbërje të përzier me gjyqtarë dhe jo gjyqtarë dhe se kryesuesi duhet të jetë gjyqtarë, Rekomandimi i Komisionit të Ministrave të Këshillit të Evropës KM/Rek (2010)12 kërkon që 'jo më pak se gjysma e anëtarëve të tillë të këshillave (gjyqësor) duhet të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga kolegët e tyre për të gjitha nivelet e gjyqësorit dhe me respekt të pluralizmit brenda gjyqësorit'. Komisioni i Venecias në 2011 në Opinionin e tij Nr. 626/2011 duke iu referuar Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Malit të Zi sugjeron një 'përbërje me një barazi të anëtarëve që vijnë nga gjyqësori me një pjesë tjetër nga pjesa tjetër e shoqërisë' në mënyrë për të shmangur 'menaxhimin autokratik të gjyqtarëve'. Vazhdon më tej duke propozuar që kryesuesi i Këshillit 'të zgjedhet nga Këshilli Gjyqësor në mesin e anëtarëve porotë në mënyrë për të siguruar linqet e nevojshme mes gjyqësorit dhe shoqërisë dhe për të shmangur rrezikun e një menaxhimi autokratik të gjyqësorit'. Këto shembuj qartë tregojnë që këto standarde ndërkombëtare duhet të lexohen dhe të kuptohen rregullisht në kontekstin dhe natyrën e tyre evoluese. Prandaj institucionet e Kosovës duhet të marrin parasysh faktet dhe rrethanat vendore dhe të marrin vendime të thurura politike. Ku një vendim merr parasysh standarde divergjente ndërkombëtare dhe – i referohet specifikimeve vendore – është i bazuar në konsiderime transparente dhe mirë të arsyetuara, kjo do të njihet edhe nga komuniteti vendor dhe ndërkombëtar.

Standardi ndërkombëtar i referuar mund të mos gjendet dhe të identifikohet më të njëjtin formulim fjalësh, por raporti mbrapa rekomandimit ka bazën në dokumentin e referuar. Disa rekomandime janë shumë të përgjithshme dhe standardi ndërkombëtar mund të jetë më specifik dhe me i detajuar dhe anasjelltas.

Veç kësaj, standarde shtesë mund të gjinden në këto dokumente. Siç u theksua edhe në hyrje, ky Katalog është grumbullim i rekomandimeve të propozuara nga Ekspertët e Projektit në kuadër të mandatit të tyre në rrjedhën e zbatimit të aktiviteteve të Projektit, që gjithnjë ka pasur fushëveprime të kufizuara.

Dokumentet ndërkombëtare të përdorura si dokumente referimi për katalogun janë listuar më poshtë. Kolona 'standard ndërkombëtar' në Katalog i referohet vetëm numrit të dokumentit të vendosur në këtë listë. Shumica e rekomandimeve i referohen disa dokumenteve ndërkombëtare. Megjithatë, referimet nuk janë shteruese. Dokumente tjera ndërkombëtare mund të jenë relevante.

Dokumentet ndërkombëtare të listuara më poshtë janë përkthyer në gjuhën Shqipe nga Projekti dhe janë përfshirë në librin e referencave me dokumente ndërkombëtare, që u është dorëzuar Këshillave dhe organeve dhe institucioneve tjera relevante në Tetor 2014.

Gjithashtu, gjatë fazës së dytë të implementimit të Projektit, janë mbledhur dhe përdorur edhe dokumente të tjera ndërkombëtare nga ekspertët. Shumica e raporteve dhe komenteve të përgatitura gjatë kësaj periudhe u referohen këtyre dokumenteve të reja ndërkombëtare. Projekti ka përgatitur një listë të re të dokumenteve ndërkombëtare (më shumë se 70) që ndërlidhen me aktivitetet e projektit dhe që janë ndarë sipas fushave, me lidhe në uebfaqet

përkatëse në internet. Lista e re e dokumenteve ndërkombëtare (që është shtuar në formë të shtojcës në Raportin Përfundimtar të Projektit) është shumë e dobishme për Këshillat dhe për programet e ardhshme ndërkombëtare që kanë për qëllim zhvillimin e mëtutjeshëm dhe fuqizimin e Këshillave.

Lista e dokumenteve referuese të përfshira në Katalog dhe në Librin e Referencave, që përmbajnë standarde ndërkombëtare:

1. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së
2. Parimet Themelore të KB për Pavarësinë e Gjyqësorit, 1985
3. Karta Evropiane për statutin e gjyqtarëve (1998)
4. Rekomandimi Rek (2000)19, i Komisionit të Ministrave për rolin e prokurorisë publike në sistemin e së drejtës penale
5. Opinioni nr. 1/2001 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian (KKGJE) për Standardet lidhur me pavarësinë e Gjyqësorit dhe pamundësinë e shkarkimit të gjyqtarëve
6. Opinioni nr. 3/2002 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian (KKGJE) për parimet dhe rregullat për qeverisjen e sjelljes profesionale të gjyqtarëve, ne veçanti etikën, sjellje të papërshtatshme dhe paanshmëri
7. Opinioni nr. 4/2003 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian (KKGJE) për trajnimin e duhur dhe gjatë shërbimit për gjyqtarë në nivele kombëtare dhe Evropiane
8. Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (KEED) për Këshillat e Gjyqësorit në Shtetet e BE-së, 2003
9. Opinioni Nr. 6/2004 i KKGJE për gjykim të drejtë brenda afatit të arsyeshëm dhe roli i gjyqtarit në gjykime duke marrë parasysh mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve
10. Opinioni Nr. 403/2006 i Komisionit të Venecias për Emërimet Gjyqësore
11. Opinioni Nr. 10/2007 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian (KKGJE) për Këshillin për Gjyqësorin në shërbim të shoqërisë
12. Opinioni Nr. 626/2011 i Komisionit të Venecias për draft amendamentimin e Kushtetutës së Malit të Zi, po ashtu edhe draft amendamentimin e Ligjit për Gjykata, Ligjit për Prokurorin e Shtetit dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor
13. Rekomandimet e Kievit për Pavarësinë Gjyqësore në Evropën Lindore, Kaukazin Jugor dhe Azinë Qendrore, 2010, OSBE dhe ODIHR

14. Masat për Zbatimin Efektiv të Parimeve të Bangalorës për Sjellje Gjyqësore, 2010
15. Rekomandimi KM/Rek(2010)12 për gjyqtarë: pavarësi, efikasitet dhe përgjegjësitë
16. KKGJE 3/2010, MAGNA CARTA PËR GJYQTARË (Parimet Themelore)
17. Opinioni Nr. 648/2011 i Komisionit të Venecias për Siguri Ligjore dhe Pavarësi të Gjyqësorit në Bosnje e Hercegovinë
18. Opinioni Nr. 668/2012 i Komisionit të Venecias Për Aktin Hungarez për Shërbimin Prokurorial dhe Statusin e Prokurorit të Përgjithshëm, Prokurorët dhe Punëtorë tjerë Prokurorial dhe për Karrierën Prokuroriale
19. Rrjeti Evropian 2012 – 2013 i Këshillave për Gjyqësorin për Standardet Minimale lidhur me vlerësimin e performancës profesionale dhe pamundësinë e shkarkimit të anëtarëve të gjyqësorit
20. Opinioni i Komisionit të Venecias Nr. 712/2013 për draft Ligjin për Gjyqësorin e Lartë dhe Këshillin Prokurorial të Bosnjës dhe Hercegovinës
21. Komisioni i Venecias dhe DDNJ nr. 751/2013 Opinioni i Përbashkët për draft Ligjin për ndryshim-plotësimin e Kodit Gjyqësor (sistemi i vlerësimit për gjyqtarë) në Armeni
22. Opinioni i Komisionit të Venecias Nr. 755/2014 për draft Ligjit e Republikës së Moldavisë për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve

Konkludimet

Gjithsej, janë identifikuar 141 rekomandime. Më shumë se 2/3 e tyre varen, të paktën pjesërisht, nga amendamenti i Kushtetutës dhe ligjeve të fushës së drejtësisë. Megjithëse prioritizimi është detyrë themelore e Këshillit dhe akterëve tjerë vendor, disa fusha duhet të konsiderohen më prioritare nga perspektiva e sundimit të ligjit dhe të drejtave themelore.

Statistikat:

Tabela përfshin **141 rekomandime**, që ndërlidhen me fushat në vijim:

• Përbërja dhe Struktura e Këshillave	14	} 12	Komponenti I
• Kompetencat e Këshillave dhe Masat Procedurale			
• Trajtimi si detyrë e Këshillave	13		
• Vlerësimi i Sistemit të Drejtësisë	3		
• Çështjet Buxhetore	5		
• Planifikimi Strategjik	6		
• Emërimi/Transferimi/Ngritja në Detyrë e Gjyqtarëve/Prokurorëve ³¹		} 31	Komponenti II dhe III
• Vlerësimi i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve	24		
• Disiplina e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve	35		

Sipas vlerësimi të kryer në Korrik 2014:

- Nga 141 rekomandimet e përfshira – përveç atyre që janë transpozuar me rregullore / plane / vendime përshkrime të detyrave të punës –
6 janë implementuar plotësisht
80 janë implementuar pjesërisht
55 nuk janë implementuar

Ndërsa implementimi i **96 rekomandimeve varet (pjesërisht) nga ndryshimi i ligjeve.**

- Sipas vlerësimit të ri të kryer në Shkurt 2016:

Nga 141 rekomandimet e përfshira në katalog:

- 23 janë implementuar plotësisht;
- 88 janë implementuar pjesërisht;
- 40 nuk janë implementuar.

Nëse e krahasojmë nivelin e implementimit, vërehet një rritje e numrit të rekomandimeve që janë implementuar në 18 muajt e fundit. Gjithashtu, niveli i implementimit të 101 rekomandimeve duhet të konsiderohet njëloj sic është konsideruar në Korrik 2014 (implementuar, pjesërisht e implementuar dhe e pa implementuar). Komentet e shtuara në kolonën e fundit të tabelës tregojnë se edhe nëse niveli i implementimit është i njëjtë, disa përmirësime dhe zhvillime janë vlerësuar pozitivisht. Më shumë se 50% e rekomandimeve që kanë statusin e njëjtë të implementimit (101 gjithsej) duhet të konsiderohen si rekomandime në proces të implementimit. Veprimet përkatëse që janë ndërmarrë nga ligjvënësi, Këshillat ose Projekti janë përmendur shkurtimisht në komentet e *status quo*.

Konkludimet tjera të rëndësishme të bazuara në analizën krahasuese të nivelit të implementimit të rekomandimeve në Korrik 2014 dhe Shkurt 2016 mund të bëhen lidhur me vlerësimin e fushave. Arritjet më të rëndësishme pozitive kanë të bëjnë me implementimin e rekomandimeve për përmirësimin e organizimit, funksionimit dhe strukturës së Këshillave (në kuadër të Komponentit I), dhe sistemin e emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Sa i përket sistemit disiplinor për gjyqtarë dhe prokurorë, ky sistem ende nuk është në pajtim me standardet ndërkombëtare. Edhe në amendamentet e fundit ligjore në këtë fushë të miratuara me 28 Maj 2015 janë kyçe. Nenet e reja që përcaktojnë afatet e parashkrimit për rastet disiplinore dhe përbërjen e Komisionit Disiplinor të KPK nuk janë pranuar mirë. E para adreson mundësin e analizës së politikave para miratimit të amendamenteve ligjore lidhur me rastet disiplinore në pritje dhe pasojat ligjore nga implementimi i këtyre dispozitave të reja. Prandaj, shumë raste që aktualisht janë në vazhdim e sipër duhet të hedhen poshtë sipas dispozitave të reja ligjore. Përbërja e re e Komisionit Disiplinor të KPK e përcaktuara në LKPK nuk është në pajtim me Kushtetutën.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se statistikave nuk tregojnë rëndësinë e implementimit ose mos implementimit të Katalogut të Rekomandimeve. Prandaj, Këshillat duhet ti kushtojnë vëmendje këtij vlerësimi, dhe duhet ti referohen rekomandimeve përkatëse gjatë hartimit të Raporteve Vjetore dhe Planeve të Punës së Këshillave.

Nga perspektiva e Projektit, vlerësimi i implementimit të shumës së rekomandimeve tashmë është përfshirë në kuadër të raporteve të Projektit të përgatitura gjatë muajve të fundit dhe që janë analizuar në Raportin Përfundimtar.

Prioritizimi dhe aktivitetet përcjellëse

Siç është përcaktuar më lartë, prioritizimi duhet të bëhet nga Këshillat.

Megjithatë, nga perspektiva e Sundimit të Ligjit dhe të drejtave themelore, rekomandimet në vijim që kanë të bëjnë me **masa legislative** konsiderohet prioritare (të ngjyrosura me ngjyrë rozë në katalog):

- Kompetencat kushtetuese të Këshillave për miratimin e rregulloreve dhe shqyrtimit gjyqësor të rregulloreve
- Përbërja dhe struktura e Këshillave – amendamentet e reja ligjore në LKPK tashmë përcaktojnë strukturën dhe përbërjen e re të KPK
- Mjetet juridike / procedura e ankimit kundër vendimeve të Këshillit – amendamentet re reja ligjore të miratuara në vitin 2015 nuk i adresojnë këto rekomandime

- Sa i përket sistemit të përgjegjësisë disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë, konkludimi përfundimtar i Projektit lidhur me këtë është se sistemi disiplinor në Kosovë për gjyqtarë dhe prokurorë ka nevojë për rishikim gjithëpërfshirës në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria me standardet përkatëse ndërkombëtare
- Sistemi i emërimit konsiderohet si fushë tjetër prioritare sa i përket qëndrueshmërisë. Në amendamentet ligjore të bëra në vitin 2015 është paraparë krijimi i një sistemi të emërimit për gjyqtarë dhe prokurorë. Sfidat që janë identifikuar deri më tani kanë të bëjnë me interpretimin e dispozitave të reja ligjore, hartimin dhe aprovimin e akteve nënligjore dhe PSV nga Këshillat, miratimin e një Ligji të ri për AGJK nga Kuvendi dhe harmonizimi i këtij ligji me LKGJK, LGJ, LKPK dhe LSHP dhe kështu me radhë.

Në **nivel operacional** Projekti propozon që fushat në vijim të trajtohen me prioritet (të ngjyrosura me ngjyrë të gjelbër në katalog):

- Ngritja e kapaciteteve të Këshillit / Anëtarëve të Këshillit / Personelit, duke përfshirë aktivitete si:
 - Trajnimi në aftësitë themelore të hartimit dhe zhvillimit të opsioneve të politikave;
 - Hartimi dhe aprovimi i akteve nënligjore sipas amendamenteve të 28 Majit 2015;
 - Shqyrtimi, ndryshimi i PSC në pajtim me aktet nënligjore lidhur me takimet e Këshillave – Përcaktimi i detyrave jashtë mbledhjeve; përgatitja e mbledhjeve; përgatitja e pikave për diskutim dhe agjendës së mbledhjeve;
 - Përgatitja e raporteve;
 - Mbikëqyrja dhe kapaciteti i udhëzimit të personelit;
 - Elaborimi i mekanizmit të llogaridhënies (përgjegjësisë);
- Mjetet dhe kapacitetet për zhvillimin e karrierës dhe kapaciteteve, sipas aktiviteteve
 - Aktet nënligjore lidhur me transferet dhe ngritjet në detyrë;
 - Harmonizimi i akteve nënligjore që kanë të bëjnë me zhvillimin e karrierës;
 - Trajnimi, monitorimi dhe ngritja në detyrë;
 - Sesionet e trajnimit për vlerësim.

Hartuar nga
Anita Mihailova.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
Përbërja dhe Struktura e Këshillit											
I	1	<p>Përbërja e KGJK/KPK Rekomandohet që KGJK/KPK të përbëhet nga një shumicë e gjyqtarëve/prokurorëve të zgjedhur nga kolegët e tyre, ose të paktën që jo më pak se 50% e anëtarëve të jenë gjyqtarë/prokurorë të zgjedhur nga kolegët e tyre nga të gjitha nivelet e gjyqësorit dhe më respekt për pluralizëm brenda gjyqësorit</p>	x	x		x	Kusht , LKGJK, LKPK	3, 5, 10 11 13 14 15 16 17 20 22	PJ	<p>Implementuar: 5 nga 9 anëtarët e KPK janë prokurorë. Të paktën 9 nga 13 anëtarët e KGJK janë gjyqtarë. Gjyqtarët dhe prokurorët janë shumicë në Këshillat përkatës.</p> <p>Pikë veprimi: Neni 108 (6) i Kushtetutës dhe Neni 5 i Ligjit për KGJK/KPK mund të shqyrtohen për ndryshim dhe plotësim në mënyrë që jo më pak se 50% e anëtarëve të zgjedhen nga kolegët e tyre.</p>	Neni 5 i Ligjit për KGJK nuk është ndryshuar sa i përket përbërjes për shkak të kufizimeve Kushtetuese. Neni 5 i Ligjit për KPK është ndryshuar në vitin 2015 dhe rekomandimi është implementuar për KPK (KPK tani do të përbëhet nga 13 anëtarë me mandat pesë vjeçar dhe dhjetë (10) anëtarë të cilët zgjedhën nga radhët e prokurorëve).
I	2	<p>Detyrat dhe zëvendësimi i kryesuesve të Këshillave Detyrat dhe përgjegjësitë si dhe zëvendësimi i kryesuesit të KGJK/KPK duhet të përcaktohen me ligj.</p>	x	x		x	LKGJK, LKPK	11,22	J	<p>Pikë veprimi: Nevojitet ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për KGJK/KPK për ndryshimin e dispozitave lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë dhe zëvendësimin e kryesuesit të KGJK/KPK.</p>	Ky rekomandim është implementuar vetëm për KPK përmes amendamenteve në Ligjin për KPK të vitit 2015 dhe miratimit të nenit të ri 5/A.
I	3	<p>Kryesuesi i KPK Kryesuesi i KPK duhet të ndahet nga funksioni i Kryeprokurorit dhe duhet të zgjidhet nga radhët e prokurorëve në KPK. Pozita e kryesuesit të KPK duhet të jetë pozitë me orar të plotë.</p>		x		x	LKPK	10 11 13	J	<p>Pikë veprimi: ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për KPK për të përcaktuar se kryesuesi zgjedhet nga Këshillat dhe përcaktimin e pozitës së kryesuesit të KPK si pozitë me orar të plotë.</p>	Ky rekomandim është implementuar plotësisht përmes amendamenteve në Nenin 3, paragrafi 5 të LNP-LKPK (Kryesuesi i Këshillit e pezullon pozitën e kryeprokurorit të shtetit dhe ka të drejtë të kthehet në shërbimin prokurorial si prokuror pas përfundimit të mandatit si Kryesues i Këshillit)

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
I	4	<p>Ministri i Drejtësisë si Anëtar i Këshillit Ministri i Drejtësisë është ex officio anëtar i KPK. Megjithatë, kompetenca për disiplinimin e një prokurori ose vendimet për emërimin/transferimin dhe ngritjen në detyrë duhet i epen një autoriteti ose tribunali që është i pavarur nga dega legislative dhe ekzekutive , dhe që përbëhet nga prokurorë aktual ose të pensionuar, mirëpo që mund të përfshijë në përbërjen e tij persona që nuk janë prokurorë, me kusht që këta persona nuk janë anëtarë të degës legislative ose ekzekutive . Sipas standardeve ndërkombëtare, Ministri i Drejtësisë nuk duhet të jetë anëtar i Këshillit . Në rastet kur Ministri i Drejtësisë është ex officio anëtar i këshillit, atëherë të paktën duhet të përcaktohet me ligj se ai/ajo nuk mund të marrë pjesë në takimet e Këshillit në të cilat vendoset për zhvillimin e karrierës së prokurorëve ose në takimet ku shqyrtohet çështja e përgjegjësisë disiplinore të prokurorëve .</p>	x	x	x	LKPK	3, 5, 6 10 11 13 17	J	<p>Pikë veprimi: Një dispozitë specifike në ligj duhet të sqarojë mandatin e kufizuar të Ministrit të Drejtësisë si anëtar i Këshillit.</p>	<p>Ky rekomandim është implementuar: përmes amendamenteve ligjore të vitit 2015 (Neni 3 i LNP-LKPK) është hequr Ministri i Drejtësisë nga anëtarësia e KPK.</p>	
I	5	<p>Kryetarët e Gjykatave/Kryeprokurorët si anëtarë të Këshillit. Rekomandohet që të përcaktohet shprehimisht me ligj se Kryetarët e Gjykatave/Kryeprokurorët nuk mund të jenë anëtarë të Këshillave. Në rastet kur një Kryetar Gjykatë / Kryeprokuror zgjidhet anëtar i Këshillit ai/ajo duhet të japë dorëheqje nga pozita e tij/saj.</p>	x	x	x	LKJK; LKPK	13	J	<p>Pikë veprimi: Ligjet duhet të ndryshohen me plotësohen.</p>	<p>Ky rekomandim është implementuar plotësisht (Neni 3, paragrafi 8 i LNP-LKJK përcakton: Kryetarët e Gjykatave nuk mund të jenë anëtarë të KGJK) Neni 3.1.5 i LNP-LKPK përcakton se anëtarët e KPK, përveç, Kryeprokurorit të Shtetit nuk mund të ushtrjnë njëkohësisht funksionin e kryeprokurorit në ndonjë prokurori.</p>	

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
i	6	<p>Ekzistenca dhe Kompetencat e Komisioneve Ekzistenca dhe detyrat/kompetencat e Komisioneve të Këshillave duhet të bazohen në ligj, në të cilin duhet të parashihen pak komisione të përhershme dhe të ketë fleksibilitet për më shumë komisione ad hoc.</p> <p>Gjithashtu, duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë se - përveç Komisionit Disiplinor - anjë komision tjetër nuk ka fuqi vendimmarrëse; të gjitha komisionet duhet ti paraqesin Këshillave një raport dhe të gjitha dokumentet që janë të nevojshme për të arsyetuar marrjen e një vendimi të caktuar.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	9, 11, 20, 22	PJ	<p>Implementuar: Komisionet Disiplinore përcaktohen me ligj. Kompetencat e tyre përshkruhen me ligj.</p> <p>Pikë veprimi: Nevojitet ndryshimi dhe plotësimi i KGJK/KPK që përcakton bazën për punën e komisioneve tjera të përhershme dhe ad hoc të Këshillit</p>	Ky rekomandim është implementuar përmes amendamenteve të vitit 2015 në LKGJK dhe LKPK përmes themelimit të Komisioneve të Përhershme të Këshillave.
i	7	<p>Përbërja e Komisioneve Rregullat themelore për përbërjen e komisioneve duhet të përcaktohen me ligj. Komisionet e Këshillave duhet të kenë anëtarë të mjaftueshëm për të mundësuar diskutim të gjerë. Njëkojesisht, numri i anëtarëve duhet të jetë mjaftueshmërisht i ulët për të lejuar punën efektive . Nëse përfaqësuesit e profesioneve tjera janë anëtarë të komisionit, numri i gjyqtarëve/prokurorëve gjithnjë duhet të jetë më i madh.</p> <p>Rregullat themelore për zëvendësimin e anëtarëve që kanë konflikt të interesit duhet të përcaktohen me ligj. Ky ligj duhet të jetë në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit gjatë Ushtrimit të Funksioneve Publike. Ligji duhet shprehimisht të kërkojë që kryesuesi i Këshillit, për shkak të natyrës së funksioneve të tij, nuk mund të jetë anëtar i komisioneve.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	11, 14, 17, 21, 22	J	<p>Pikë veprimi: Nevojitet ndryshimi i Ligjit pr KGJK/KPK për të parashikuar përbërjen e komisioneve të Këshillit.</p>	Kërkesat lidhur me përbërjen e Komisioneve të Këshillave nuk janë përfshirë në amendamentet e fundit në LKGJK dhe LKPK të vitit 2015. Në amendamentet e LKPK është përcaktuar përbërja e re e Komisionit Disiplinor të KPK, që është Komisioni i vetëm vendim-marrës i Këshillit. Prandaj, amendamentet e Ligjit nuk janë në përputhshmëri me Kushtetutën.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
I	8	<p>Detyrat e Anëtarëve të Komisioneve KGJK/KPK rekomandohet të sigurojnë që anëtarët e Komisioneve të lirohen nga detyrat e tjera, nëse është e nevojshme, për të siguruar që të përmbushin detyrën e anëtarit të komisionit, të shqyrtojnë draft vendimet dhe të kryejnë funksionet tjera. Posaçërisht për Komisionin Disiplinor, rekomandohet që të përcaktohet një parim i rotacionit dhe raportuesve alternativ, në mënyrë që të ndahet ngarkesa e punës.</p>	x	x		x	LKGJK; LKPK	11, 22	PJ	<p>Implementuar: Në rregulloret që përcaktojnë normat për gjyqtarë dhe prokurorë është parashikuar që detyrat brenda këtyre komisioneve duhet të merren parasysh. Pikë veprimi: Nevojitet krijimi i rregullave për të siguruar që anëtarët e komisioneve të ushtrorjnë detyrat e tyre në komisione dhe në veçanti që anëtarët e Komisionit Disiplinor të kenë kohë për të hartuar vendimet dhe për të përgatitur në mënyrë efikase sesionet e diskutimit.</p>	Lidhur me këtë rekomandim nuk janë bërë amendamente ligjore. Këshillat kanë aprovuar disa Rregullore që përmbajnë dispozita që kanë për qëllim përmirësimin e procedurave dhe specifikimin e detyrave të Komisioneve të përhershme.
I	9	<p>Procedura në Komisione Disa rregulla themelore të procedurës në Komisione duhet të përcaktohen me ligj, si p.sh kuorumi, hedhja e votave dhe zgjidhjet tjera në rast të votave të barabarta etj.</p>	x	x		x	LKGJK; LKPK	9, 13, 21	J	<p>Pikë veprimi: Nevojitet ndryshimi i Ligjit për KGJK/KPK.</p>	Lidhur me këtë rekomandim nuk janë bërë amendamente ligjore, përveç se LNP-LKGJK në nenin 11 ka shtuar paragrafin në vijim në Nenin 19A, paragrafi 5: "Përbërja, mandati, kriteret, metodat dhe çështjet tjera lidhur me vlerësimin e performancës së gjyqtarëve përcaktohen me këtë ligj dhe me rregullore të miratuar nga Këshilli ". Neni 14/B i LKPK gjithashtu përmban një dispozitë identike.
I	10	<p>Bashkëpunimi i Këshillave me Kryetarët e Gjykatave / Kryeprokurorët. Bashkëpunimi mes Këshillave dhe Kryetarëve të Gjykatave / Kryeprokurorëve duhet të definohet dhe fuqizohet më shumë.</p>	x				LKGJK; LKPK	17, PM	PJ	<p>Implementuar: IGJK organizon në bazë vjetore një Konferencë të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës. KPK fton Kryeprokurorët në takimeet e KPK sipas nevojës për diskutimin e raporteve të prokurorive të tyre. Pikë veprimi: Ligjet duhet të përcaktojnë shprehimisht bashkëpunimin e Këshillave me Kryetarët e Gjykatave / Kryeprokurorëve dhe KGJK/KPK.</p>	Lidhur me këtë rekomandim nuk janë bërë amendamente ligjore. Megjithatë, Projekti ka dorëzuar në KPK dhe KGJK rekomandime dhe propozime për përmirësimin e këtij bashkëpunimi. (QPR, 2015)

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016	
I	11	<p>Krijimi i një Mekanizimi të Koordinimit dhe Bashkëpunimit mes Këshillave</p> <p>Rekomandohet që të krijohet një mekanizëm i përshtatshëm dhe i përhershëm për përpunimin e bashkëpunimit mes KGJK/KPK me qëllim të shmangies së izolimit dhe për të siguruar aplikimin e unifikuar të dispozitave të ngjashme ligjore. Ky mekanizëm mund të aplikojë elementet në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Një anëtar i KGJK/KPK të veprorë si vëzhgues në takimet e këshillit tjetër - takime të rregullta të detyrueshme mes udhëheqësve të sekretariatit/departamenteve në nivel administrativ • Takime të përbashkëta ku mund të diskutohen praktikimet më të mira dhe pyetjet lidhur me aplikimin e ligjit dhe aplikimin e unifikuar të ligjit <p>Për realizimin e kësaj nevojitet një dispozitë themelore për koordinimin mes këshillave në ligj.</p>	x	x		x	LKGJ K; LKPK	17, 20	PJ	<p>Implementuar: është miratuar një rregullore e cila përmban rregulla për vendimarrjen në takime përbashkëta të Këshillave. Këshillat zhillojnë rregullisht takime të përbashkëta. Gjatë miratimit të rregulloreve, dispozitat e Këshillit tjetër merren parasysh rregullisht. Trajnimet e përbashkëta gjatë pilot trajnimeve dhe trajnimit e vazhdueshme në të ardhmen do të rrisin vetëdijësimin për praktikimet e implementimit brenda dy Këshillave dhe Komisioneve të tyre.</p> <p>Pikë veprimi: Ligji për KGJK/KPK duhet të ndryshohet. Megjithatë është bërë përparim i dukshëm, edhe ka hapësirë për përmirësim të mëtejshëm të bashkëpunimit mes dy Këshillave.</p>	Lidhur me këtë rekomandim nuk janë bërë amendamente ligjore.	
I	13	<p>Sekretaria e Vecantë për KPK</p> <p>KPK duhet të ketë sekretarinë e saj të veçantë që merret me çështje të brendshme administrative dhe që është e vecantë nga sekretaria e Kryeprokurorit të Shtetit.</p>		x			x	LKPK	11	J	<p>Pikë veprimi: Një ndryshim i Ligjit për KPK, që parasheh Sekretar të veçantë për KPK dhe për Kryeprokurorin e Shtetit, duke përfshirë strukturën themelore dhe përgjegjësitë.</p>	Neni 10 i LNP-LKPK ka ndryshuar Nenin 14 të ligjit bazik duke themeluar një Sekretariat të veçantë për KPK. Më shumë mbështetje nevojitet për zbatimin adekuat të këtyre dispozitave ligjore
I	14	<p>Organogrami i vecantë për KPK</p> <p>KPK duhet të ketë një organogram të veçantë nga ai i Kryeprokurorit të Shtetit, që pasqyron strukturën e bazuar në ligje dhe akte nënligjore.</p>							11	J	<p>Pikë veprimi: KPK duhet të përgatisë një organogram të veçantë nga organogrami i Kryeprokurorit të Shtetit.</p>	Organogrami i Sekretariatit të sapo themeluar aktualisht është në proces të përgatitjes. Organogrami duhet të jetë në pajtim me rregulloren e re për Sekretariatit (ende të pa miratuar nga KPK)
I	15	<p>Publikimi i organogrameve të këshillave</p> <p>Organogrami duhet të publikohet në uebfaqe dhe duhet të paraqesë ndërlidhjen me gjykatat/prokuroritë</p>	x	x					13	J	<p>Pikë veprimi: Asnjëri nga Këshillat nuk i kanë publikuar organogramet e tyre.</p>	Ky rekomandim është implementuar nga KGJK.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
Kompetencat e Këshillave dhe Masat Procedurale											
I	16	<p>Kompetencat kushtetuese për nxjerrjen e rregulloreve Kushtetuta parashih vetëm nxjerrjen e rregulloreve nga qeveria. Kompetencat e Gjykatës Kushtetuese gjithashtu janë në kufizuar në rishikimin e kushtetutshmërisë së rregulloreve qeveritare . Kompetencat e Këshillave për nxjerrjen e rregulloreve dhe kompetencat e Gjykatës Kushtetuese për rishikimin e këtyre rregulloreve duhet të parashihen shprehimisht përmes ndryshimeve kushtetuese.</p>	x	x		x	Kusht	SL 10, 11, 17	J	Pikë veprimi: Kërkohen ndryshime kushtetuese.	Nuk ka pasur amendamente Kushtetuese.
I	17	<p>Llojet e vendimeve të Këshillave Në pajtim me Parimin e Sundimit të Ligjit, rekomandohet që të referohet në ligj dhe në praktikë saktësisht llojet e akteve normative. Zakonisht, rregulloret janë dispozita të përgjithshme juridike që nxirren nga autoritetet administrative dhe u drejtohen personave që i nënshtrohen ligjit . Kompetencat e përgjithshme kushtetuese në këtë rast ndërlidhen vetëm me rregulloret implementuese për specifikimin e dispozitave të përgjithshme ligjore. Rregulloret të cilat i ndryshojnë ose plotësojnë ligjet përgjithësisht nuk janë të lejuara ose për nxjerrjen e tyre kërkohen kompetenca kushtetuese. Vendimet janë zakonisht instrumente administrative për zbatimin e ligjit që u drejtohen një ose më shumë personave të emëruar në mënyrë specifike. Udhëzimet mund të jenë rregullore administrative (udhëzime të përgjithshme ose qarkore) ose vendime administrative që i drejtohen një ose më shumë individëve të emëruar në mënyrë specifike. Ndryshimi i një rregullore gjithashtu duhet të quhet rregullore dhe jo vendim, etj.</p>	x	x		x	Ligji	SL	J	Pikë veprimi: Ligji për Aktet Normative nuk është miratuar ende. Në praktikë, Këshillat nuk përdorin terme të unifikuara për aktet normative që miratohen nga to .	Ky rekomandim nuk është implementuar. Të dy Këshillat ende kanë nevojë për zhvillim të kapaciteteve në hartimin e akteve nën-ligjore dhe llojeve tjera të vendimeve të Këshillave

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
I	18	<p>Publikimi i vendimeve të këshillave</p> <p>Ligji duhet të përcaktojë shprehimisht se ku duhet të publikohen vendimet e Këshillave.</p> <p>Nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj, rekomandohet që vendimet e Këshillave si rregull duhet të publikohen.</p>	x	x			Ligji	SL 11, 13	PJ	<p>Implementuar: KGJK publikon në uebfaqen e saj rregulloret, vendimet, udhëzimet. KPK gjithashtu publikon aktet ligjore të saj në uebfaqen e Kryeprokurorit të Shtetit.</p> <p>Pikë veprimi: Rekomandohet të që shtohet funksioni i 'kërkimit', të shënohet në mënyrë të qartë data e publikimit dhe dhe të publikohen versionet e konsoliduara. KPK rekomandohet të ketë një uebfaqe të veçantë nga ajo e Kryeprokurorit të Shtetit.</p>	Lidhur me këtë rekomandim nuk janë bërë amendamente ligjore. Të dy Këshillat kanë nevojë për mbështetje të vazhdueshme për hartimin e rregullave për publikimin e vendimeve të Këshillave
I	19	<p>Hyrja në fuqi e akteve ligjore</p> <p>Parimi i Sundimit të Ligjit kërkon që ligjet të hyjnë në fuqi vetëm pas publikimit të tyre (aktet ligjore me zbatueshmëri të përgjithshme) ose pas pranimit të vendimit nga i adresuari (vendimet). Këshillat rekomandohet që të përcaktojnë në rregulloret dhe vendimet e tyre datat e publikimit të akteve përkatëse dhe datën e hyrjes në fuqi të tyre.</p>	x	x		x	Ligji	SL 11	PJ	<p>Implementuar: Në disa raste Këshillat i referohen datës së publikimit/pranimit si data e hyrjes në fuqi.</p> <p>Pikë veprimi: Hyrja në fuqi duhet të sqarohet me ligj dhe Këshillat duhet ti referohen datës së publikimit/pranimit si data e hyrjes në fuqi.</p>	Lidhur me këtë rekomandim nuk janë bërë amendamente ligjore. Këshillat duhet të krijojnë një praktikë unike lidhur me këtë.
I	20	<p>Roli i Këshillave në vendimet e politikave</p> <p>Ligji duhet që shprehimisht ti autorizojë Këshillat që të përfshihen në procesin e hartimit të legjislacionit përmes dërgimit të rekomandimeve të politikave si dhe të komentojnë në ligjet që kanë të bëjnë me fushën e drejtësisë.</p> <p>Këshillat rekomandohen që të jenë më aktiv në zhvillimin e politikave për fushën e drejtësisë.</p>	x	x		x	LKGJK, LKPK	11, 17	PJ	<p>Implementuar: Këshillat së fundi kanë marrë një rol më aktiv në zhvillimin e politikave në sektorin e drejtësisë.</p> <p>Pikë veprimi: Nevojitet ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për KGJK/KPK për të përcaktuar të drejtën e Këshillave që të përfshihen në procesin e hartimit të legjislacionit që rregullon fushën e drejtësisë.</p>	Kapacitetet e të dy Këshillave janë zhvilluar për vendimet e politikave dhe hartimin e dokumenteve të politikave me mbështetjen e Projektit. Këshillave u janë dorëzuar dokumentet e përgatitura nga Projekti që përmbajnë analizën e politikave dhe opsionet e politikave. Projekti ka realizuar disa trajnime këtë fushë në vitin 2015.
I	21	<p>Kompetencat e Këshillave lidhur me (ri)emërimin, transferimin, ngritjen në detyrë, vlerësimin dhe disiplinën</p> <p>Të gjitha vendimet për (ri)emërimin, transferimin dhe ngritjen në detyrë si dhe vlerësimin dhe disiplinën duhet të merren nga Këshillat.</p>	x	x		x	LKGJK; LKPK; LIGJK / JAL	3, 5, 11, 10, 13, 14, 20	PJ	<p>Implementuar: Ligjet në përgjithësi japin të drejtën për propozimin e kandidatëve për (ri) emërim, transferim dhe ngritje në detyrë Këshillave. Vlersimi dhe vendosja e përgjegjësisë disiplinore gjithashtu është në kompetencë të Këshillave.</p> <p>Pikë veprimi: Ligjet duhet të ndryshohen sa i përket kompetencave në fushën e emërimit (pranimit të kandidatëve në trajnimin fillestar).</p>	Me hyrjen në fuqi të ligjeve për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve për KGJK dhe KPK, Ligjit për Gjykatat dhe Ligjit për Prokurorin e Shtetit me 15 Korrik 2015, dhe me miratimin e Rregullores së KPK për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit në Dhjetor 2015, ky Rekomandim është zbatuar plotësisht sa i përket KPK, si dhe KGJK-së, pasi që draft rregullorja e saj për të njëjtën fushë duhet të respektojë dispozitat e reja ligjore

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	22	<p>Transparenca e procesit të emërimit, transferimit, ngritjes në detyrë dhe përgjegjësisë disiplinore</p> <p>Në mënyrë që të garantohet që sistemi i rekrutimit, përgjedhjes dhe emërimit, transferimit, ngritjes në detyrë, vlerësimit dhe disiplinës së gjyqtarëve të jetë i pavarur, i hapur dhe transparent, organi duhet të publikojë komencat në bazë të të cilave përcakton se një kandidat i caktuar ka meritën dhe të gjitha burimet e informacionit që do të përdor për vlerësim.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	3, 5, 9, 10, 11, 13, 14, 20, 21	PJ	<p>Implementuar: Të dy Këshillat kanë publikuar Rregulloren për Procesin e Rekrutimit, Emërimit dhe Riemërimit si dhe për Vlerësimin, që përfshin të gjithë treguesit dhe burimet e informacionit që përdoren në procesin e emërimit/vlerësimit. Ligji për KGJK/KPK përmban përkufizimin e shkeljes disiplinore.</p> <p>Pikë veprimi: Ligji duhet të përmbajë dispozita themelore për transparencën. Burimet e informatat duhet të listohen shprehimisht në ligj si dhe nevojiten rregulla më të detajuara për procesin e transferimeve dhe ngritjeve në detyrë. Përkufizimet e llojeve të shkeljeve disiplinore nuk janë mjaft të qarta.</p>	Lidhur me këtë rekomandim nuk janë bërë amendamente ligjore në kuadër të amendamenteve të miratuara në Ligjin për KGJK dhe Ligjin për KPK në Korrik 2015. Megjithatë, me miratimin e Rregullores së KPK për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit në Dhjetor 2015, ky rekomandim është zbatuar sa i përket KPK duke listuar kërkesat për përgjedhjen dhe emërimin sipas Nenit 18 të LKPK, në kombinim me Nenin. 8, 9, 14, 17, 18, 21, dhe 22 të Rregullores së KPK. Sa i përket draft Rregullores së KGJK për të njëjtën fushë, Nenet. 7, 8, 13, 14, 15, 17, 18, 19, 22, dhe 23 të draft rregullores aktuale duket se i plotësojnë këto kërkesa.
II & III	23	<p>Konfidencialiteti i diskutimeve lidhur me vendimet për emërimin, transferimin, vlerësimin dhe procedurën disiplinore</p> <p>Duhet të krijohen procedura adekuare për të garantuar konfidencialitetin e diskutimeve lidhur me emërimin, transferimin, ngritjen në detyrë dhe përgjegjësinë disiplinore. Rekomandohet që të dhënat dhe informatat e fituara ose të mirëmbajtura gjatë procesit duhet të jenë konfidenciale dhe nuk do të zbulohen. Identiteti i individëve që kanë siguruar informatat lidhur me gjyqtarët/prokurorët përkatës duhet të mbahet konfidencial. Megjithatë, gjyqtari / prokurori duhet të ketë qasje në të gjitha informatat e përfshira në dosje.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	9, 10, 21	PJ	<p>Implementuar: Të dyja Rregulloret për Procesin e Rekrutimit dhe (Ri) Emërimit si dhe ato për Vlerësimin dhe Procedurat Disiplinore përmbajnë rregulla për konfidencialitetin e këtyre proceseve. Rregullorja për KPK e përjashton prokurorin nën vlerësim.</p> <p>Pikë veprimi: Ligji duhet të përmbajë dispozita themelore për konfidencialitetin. Rregullat më të hollësishme për konfidencialitetin e procesit të transfereve dhe ngritjeve në detyrë duhet të përcaktohen me akte nënligjore. Përjashtimi i prokurorit të vlerësuar nuk është paraparë në Rregulloren e KGJK për Vlerësimin.</p>	Lidhur me këtë rekomandim nuk janë bërë amendamente ligjore në kuadër të amendamenteve të miratuara në Ligjin për KGJK dhe Ligjin për KPK në Korrik 2015. Megjithatë, me miratimin e Rregullores së KPK për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit me 1 Dhjetor 2015, Rregullorja thekson nevojën për siguri he kërkon ruajtjen e konfidencialitetit lidhur me procesin e rekrutimit sipas Neneve. 5.7, 7.3, 11, 14 të Rregullores. Sa i përket draft Rregullores së KGJK për të njëjtën fushë, Nenet. 6, 12, 19, 28, dhe 30 të draft rregullores ofrojnë edhe më shumë garanci se sa rregullorja e KPK.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	24	<p>Dokumentimi i procedurës së emërimit, transferimit dhe ngritjes në detyrë, vlerësimit dhe disiplinimit</p> <p>Rekomandohet që të krijohet një dosje e mjaftueshme për secilin aplikues në mënyrë që të sigurohet që të ketë një proces të verifikuesueshëm, të pavarur, të hapur dhe të drejtë e transparent dhe për të garantuar efektshmërinë e ankesave të pavarura ose procesit të ankimit të cilin mund ta përdor cilido aplikues i pasuksesshëm nëse ai/ajo beson se është trajtuar në mënyrë të padrejtë gjatë procesit të emërimit / transferimit / ngritjes në detyrë / vlerësimit / procesit disiplinor . Të gjitha informatat e përdorura gjatë procesit duhet të dokumentohen në dosjet përkatëse.</p>	x	x		x	LKGJK, LKPK	9, 10, 11, 21	PJ	<p>Implementuar: Të dyja Rregulloret për Procesin e Rekrutimit dhe (Ri) Emërimit përmbajnë rregulla për ruajtjen e të dhënave në të gjitha hapat e procesit të emërimit. Gjithashtu, formularë të ri tani përdoren për ruajtjen e këtyre të dhënave. Rregullorja për Vlerësimin dhe Procedurat Disiplinore gjithashtu përmban dispozita përkatëse.</p> <p>Pikë veprimi: Ligji duhet të përmbajë dispozita themelore për dokumentimin.</p>	<p>Megjithatë, me miratimin e Rregullores së KPK për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit në Dhjetor 2015. Megjithatë, me miratimin e Rregullores së KPK për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit me 1 Dhjetor 2015, rekomandim është zbatuar në bazë të përmbajtjes së Neneve. 8.8, 16, dhe 27 të Rregullores së KPK. Sa i përket Rregullores së KGJK për të njëjtën fushë, Nenet. 7.6, 17, 18, 27, dhe 30 të këtij drafti duket se e plotësojnë këtë rekomandim.</p>
II & III	25	<p>Politika e konfidencialitetit për ruajtjen e dosjeve / arkivave</p> <p>Këshillat rekomandohen që të rishikojnë politikën e konfidencialitetit lidhur me procesin e emërimit, vlerësimit dhe atë disiplinor për të siguruar që të gjitha dokumentet e dorëzuara lidhur me cilindo kandidat të jenë në dispozicion të të gjithë anëtarëve të Komisioneve kompetente të KGJK/KPK, duke përfshirë personelin e pranuar mbështetës, dhe njëkohësisht që asnjë person tjetër të mos ketë qasje në dosje.</p> <p>Gjithashtu, Këshillat rekomandohen që të sigurojnë që dosjet të fshihen pas një periudhe të caktuar kohore që duhet të përcaktohet veçmas për emërimin, vlerësimin dhe procedurën disiplinore dhe duhet të jetë në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave.</p>	x	x				PM	PJ	<p>Implementuar: Të dy Këshillat kanë krijuar një praktikë për ruajtjen konfidenciale të dosjeve dhe arkivave.</p> <p>Pikë veprimi: Duhet të miratohet dhe implementohet një politikë githpërfshirëse për ruajtjen e dosjeve/arkivave.</p>	<p>Për zbatimin e plotë të këtij rekomandimi nuk është marrë një veprim. Megjithatë, KGJK ka filluar procedurën e hartimit të rregullave për ruajtjen e dosjeve dhe arkivimit. Më shumë mbështetje për këtë fushë kërkohet.</p>

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016	
1	26	<p>Qasja e publikut dhe mediave në informacion dhe Marrëdhëniet me Publikun</p> <p>Komunikimi i jashtëm dhe marrëdhëniet me publikun duhet të rriten, respektivisht niveli i vetëdijësimit të publikut me ligjet, të drejtat dhe mekanizmat në dispozicion për realizimin e të drejtave. Procesverbalet e mbledhjeve të Këshillave duhet të publikohen duhe marrë parasysh rregullat e mbrojtjes së të dhënave.</p> <p>Krijimi i një Komisioni për Marrëdhënië me Publikun dhe/ose caktimi i një zëdhënsi të trajtnuar rekomandohet.</p> <p>Gjithashtu rekomandohet përgatitja e udhëzimeve për zbulimin e informatave në mënyrë që të rritet komunikimi aktiv dhe gjithëpërfshirës mes Këshillave dhe publikut.</p> <p>Trajnimet specifike, të koordinuara mirë me institucioin e trajnimit për çështje të marrëdhënieve me publikun nevojiten për anëtarët e Këshillit, zëdhënsit dhe personelin mbështetës.</p>	x	x				LKGJ K, LKPK	6, 9, 11, 13, 14, 15, 20	J	<p>Pikë veprimi: Duhet të përpilohet një politikë dhe të hartohet legjislacioni përkatës për qasjen e publikut dhe medias në informacionin e Këshillave, gjykatave dhe prokurorive. Një strategji për marrëdhënie me publikun gjithashtu duhet të jetë pjesë e Planit Strategjik.</p>	<p>KGJK ka miratuar Strategjinë e saj të Komunikimit dhe Rregulloren për Zyrën e Komunikimit / Koordinimit të KGJK, përderisa KPK është në proces të miratimit të Strategjisë së Komunikimit dhe Rregulloren. Projekti u ka siguruar të dy Këshillave analiza dhe rekomandime në këtë drejtim gjatë vitit 2015.</p>
1	27	<p>Planifikimi dhe strategjia e burimeve njerëzore</p> <p>Vëmendje adekuate duhet ti kushtohet procesit të planifikimit të nevojave të burimeve njerëzore.</p> <p>Në veçanti, duhet të konsiderohen faktorët në vijim:</p> <p>1) rregullat e qarta / mbledhja e informacion për pensionim dhe</p> <p>2) politikat afatgjate për hapjen e pozitave të reja të gjyqtarëve / prokurorëve.</p> <p>Kjo gjithashtu do të ketë efektin e planifikimit më të mirë të nevojave të trajnimit, veçanërisht në aspekt afatgjatë.</p>	x	x				PM	PJ	<p>Implementuar: Të dy këshillat kanë mbledhur të dhënat relevante sa i përket pensionimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.</p> <p>Pikë veprimi: Nevojitet planifikim dhe strategji më e mirë për burimet njerëzore.</p>	<p>Të dy Këshillat i kanë Draft Strategjitë e Burimeve Njerëzore. Megjithatë, më shumë mbështetje nevojitet për përmirësimin e draft strategjive, analizës dhe konsiderimin e të gjithë faktorëve relevant, miratimin dhe zbatimin e Strategjive të BNJ.</p>	

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
Trajnimi si Detyrë e Këshillave											
I	28	<p>Krijimi i një mekanizmi të koordinimit dhe bashkëpunimit mes Këshillave dhe institucionit të trajnimit</p> <p>Mekanizmat e koordinimit dhe bashkëpunimit me IGJK lidhur me analizën e nevojave të trajnimit, koordinimin për zgjedhjen e trajnerëve, kurrikulën e trajnimit dhe vlerësimin e nevojave të trajnimit që duhet të zhvillohen më shumë. Anëtarët e Këshillave duhet të përfaqësohen në Bordin e IGJK.</p> <p>IGJK duhet të ketë rol qendror në trajnimi ne gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe personelit mbështetës. Neni 40(2) i Ligjit për KPK mund të ketë nevojë të ndryshohet për shmangiene dyfishimit të institucioneve të trajnimit.</p> <p>Rekomandohet që të krijohet një Komision ose strukturë tjetër adekuate që merret me të gjitha çështjen e trajnimit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit mbështetës dhe koordinimin me institucionet e trajnimit.</p> <p>Komisioni i Trajnimit mund të ketë këto përgjegjësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ndërlidhjen me institucionet e trajnimit • caktimin e kritereve për përzgjedhjen e gjyqtarëve/prokurorëve mentor • udhëzimin dhe mbikëqyrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve mentor • sigurimin e menaxhimit cilësor të mentorëve • sigurimin e analizës së nevojave të trajnimit në koordinim me IGJK • rishikimin e kurrikulës së trajnimit • përgatitjen e aprovimit të kërkeave për autorizimin e trajnimeve dhe rekomandimin për Këshillin të vendimeve përkatëse • kriteret e përgjithshme për pjesëmarrje në trajnime • rishikimi i regjistrimit të trajnimeve • elaborimi i formularëve dhe procedurave standarde të veprimit 	x	x	x	LKGJ K, LKPK	11, 14	PJ	<p>Implementuar: Ligji për IGJK përcakton se KGJK/KPK përfaqësohen në Bord. Janë krijuar njësitë e trajnimit brenda Këshillave, mirëpo kapaciteti i tyre duhet të zhvillohet.</p> <p>Pika veprimi: Ka nevojë për dispozita më të qarta ligjore lidhur me kompetencat e Këshillave dhe institucionit të trajnimit në 4 ligjet e drejtësisë dhe në ligjin për funksionimin e institucionit të trajnimit.</p> <p>Koordinimi dhe bashkëpunimi mes Këshillave dhe institucionit të trajnimit duhet të rritet dhe duhet të krijohen procedurat standarde të veprimit.</p> <p>Këshillat mund të shqyrtojnë mundësinë e krijimit të një Komisioni për Trajnime me detyra specifike.</p> <p>Anëtarët e Këshillave në Bordin e IGJK në fakt duhet të përfaqësojnë Këshillat dhe duhet të obligohen nga politikat dhe vendimet e Këshillave. Duhet të shqyrtohet mundësia që të mos ketë delegim të përfaqësuesve na kryetari/kryesuesi i Këshillave në Bord (siç parashihet tani nga Ligji për IGJK) por që një anëtar i 'specializuar' i Këshillit përkatës të marrë pjesë (për shembull: kryesuesi i Komisionit të ardhshëm të Trajnimit).</p>	<p>Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk është bërë ndonjë amendament ligjor. Projekti ka përgatitur komente në Draft Ligjin për AGJK në vitin 2015. Më shumë mbështetje nevojiten për përmirësimin e versionit përfundimtar të LAGJK dhe harmonizimin e këtij ligji me amendamentet e fundit në LKGJK, LKPK, LGJ dhe LPSH.</p>	

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	29	<p>Roli i Këshillave lidhur me trajnimin fillestar</p> <p>Ligji duhet të sqarojë rolin e Këshillave në përcaktimin e kornizës themelore për trajnimin fillestar dhe trajnimin e politikave. KGJK/KPK duhet të ketë rol udhëheqës për përcaktimin e kornizës së trajnimit fillestar dhe vlerësimit të nevojave të trajnimit. Përgjegjësia e qeverisë për trajnim gjyqësor duhet të kufizohet në sigurimin e burimeve adekuate për të siguruar ofrimin e trajnimit të përshtatshëm gjyqësor.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK, LIGJK /JAL	11, 13, 14	PJ	<p>Implementuar: Neni 40 i Ligjit për KPK dhe Neni 50 i Ligjit për KGJK tashmë vetëm përcaktojnë se Këshillat do të vendosin politikat, standardet dhe direktivat sipas të cilave rregullohen gjyqtarët/prokurorët. Të dy Këshillat kanë paraqitur rekomandimet e politikave për sqarimin e rolit të Këshillave si dhe për shtimin e një dispozite lidhur me trajnimin fillestar. Qasja e propozuar do të parashihte aspektet teorike dhe praktike të trajnimit fillestar.</p> <p>Pikë veprimi: Nenet 17/18 të Ligjit për KGJK/KPK dhe 26 të Ligjit për Gjykatat dhe Neni 19 i Ligjit për PSH si dhe Ligji për IGJK duhet të ndryshohen. Pas ndryshimeve ligjore duhet të ndryshohen edhe Rregulloret përkatëse.</p>	Në amendamentet e LKGJK dhe LKPK të miratuara me 28 Maj 2015 përcaktohet periudha fillestare e trajnimit të obligueshëm prej 12 muajve. Projekti u ka dorëzuar Këshillave një Koncept Dokument për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në vitin 2015 që ka për qëllim përcaktimin e politikave dhe standardeve për trajnimin fillestar. Më shumë mbështetje nevojitet për zhvillimin e politikave dhe standardeve sipas amendamenteve ligjore dhe ligjit të ri për AGJK.
II & III	30	<p>Përmbajtja e trajnimit fillestar</p> <p>Trajnimi fillestar duhet të përfshirë edhe aspektet teorike por edhe praktike dhe të mbulojë të gjitha fushat ligjore që janë relevante për një gjykatë/prokurori duke oforuar gjithashtu edhe aftësi dhe njohuri të tjera (si etika, menaxhimi i rasteve, administrimi i gjykatave, teknologjitë e informacionit, gjuhët e huaja, shkencat sociale, vetëdijësimi social, zgjidhja alternative e kontesteve si dhe kuptimi i plotë i fushave të ndryshme që pasqyrojnë kompleksitetin e jetës në shoqëri). Kjo duhet të përcaktohet në ligj.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK, LIGJK /JAL	6, 11, 13, 14	PJ	<p>Implementuar: Të dy Këshillat kanë paraqitur rekomandimet e politikave për përcaktimin e përmbajtjes së trajnimit fillestar.</p> <p>Pikë veprimi: Ligji për KGJK/KPK dhe Ligji për IGJK duhet të ndryshohen. Pas ndryshimeve ligjore duhet të ndryshohen edhe Rregulloret përkatëse.</p>	Në amendamentet ligjore të bëra në LKGJK dhe LKPK në vitin 2015 është paraparë periudha fillestare e trajnimit prej 12 muajve. Megjithatë, përmbajtja e trajnimit fillestar duhet të sqarohet me institucionin e trajnimit. Projektligji për Akademinë Gjyqësore të Kosovës (LAGJK) nuk është miratuar ende nga Kuvendi. Harmonizimi i amendamenteve të fundit në LKGJK, LKPK dhe LAGJK rekomandohet.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	31	<p>Përcaktimi i trajnerëve/specialistëve në fushën e emërimit/vlerësimit/disiplinës</p> <p>KGJK/KPK rekomandohen që t caktojë nga radhët e gjyqtarëve/prokurorëve me përvojë kryesuesin/anëtarët e Komisionit të Emërimit/Vlerësimit/Disiplinor si dhe trajnues për rekrutim/vlerësim/disiplinë'. Detyrat e specialistit mund të jenë si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ofrimi i trajnimeve në programin e trajnimeve fillestare ose mbështetjen e një trajneri të IGJK në fushën përkatëse • Ofrimi i trajnimeve çdo herë që nevojitet për anëtarët e ri të Komisioneve të Emërimit/Rishqyrtimit/Vlerësimit/Disiplinore • Siguron që materiet relevante, manualët, formularët të azhurnohen vazhdimisht • Siguron që KGJK/KPK të informohet për pyetjet e ardhshme dhe KGJK/KPK të ketë informatat relevante për marrjen e vendimeve të nevojshme • Siguron që përvoja dhe gjetjet lidhur me nevojat për ndryshime ti bëhen të ditura Këshillave. • Pjesëmarrja në trajnime për metodat dhe teknikat e trajnimit <p>Këshilla rekomandohen që të gjitha pyetjet lidhur me emërimet/vlerësimet/disiplinën ti bëhen të ditura vazhdimisht specialistit.</p>	x	x				11, 21	PJ	<p>Implementuar: Këshillat kanë caktuar trajnerët/specialistët në pothuajse të gjitha fushat. Këta trajnerë kanë marrë pjesë aktive në trajnimin pilot dhe janë dërguar në IGJK si trajnerë potencial.</p> <p>Pikë veprimi: KGJK ende duhet të caktojë një trajner/specialist në fushën e emërimeve dhe vlerësimit. Trajnerët/specialistët duhet të vazhdojnë të konsiderohen dhe të 'përdoren'.</p>	<p>Ky rekomandim është implementuar pjesërisht. Dy këshillat ende duhet të përdorin në mënyrë adekuate kapacitetet e anëtarëve të Këshillave, personelit mbështetës, gjyqtarëve dhe prokurorëve të trajnuar nga Projekti dhe programet tjera ndërkombëtare dhe të specializuar në fushën e emërimit, vlerësimit dhe disiplinës.</p>

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II. & III.	32	<p>“Zhvillimi i Praktikave të Mira” Rekomandohet që</p> <p>a) një anëtar i caktuar i Komisionit përkatës të regjistrojë çështjet problematike të ngritura gjatë takimeve dhe procedurave (lidhur me interpretimin/aplikimin e ligjit/aktet nënligjore ose për mënyrën e vlerësimit të dokumenteve/situatave/fakteve të caktuara, ose për kufizimin mes etikës dhe sjelljes relevante disiplinore etj)</p> <p>b) specifikisht për vlerësim: Kryetarët e Gjykatave/Kryeprokurorët regjistrojnë çështjet që dalin në kontekstin e vlerësit ose mentorimit të performancës</p> <p>c) zhvillimi i punëtorive për anëtarët e Komisionit përkatës (dhe lidhur me vlerësimin me Kryetarët e Gjykatave/Kryeprokurorët; dhe eventualisht për të gjitha çështjet me anëtarët e Këshillit tjetër, eksperët, etj.) në baza vjetore për diskutimi ne këtyre çështjeve</p> <p>d) çështjet kyçe mund ti bëhen të ditura Këshillave dhe mund të kërkohen udhëzime</p> <p>e) konkludimet/gjetjet mund të shkruhen në një Manual të Përgjithshëm të Udhëzimeve që azhurnohet vazhdimisht</p> <p>f) Manuali i Përgjithshëm i Udhëzimeve duhet të bëhet publik dhe të jetë në dispozicion të të gjithë gjyqtarëve/prokurorëve dhe (pjesërisht) për publikun.</p>	x	x				9, 11, 13, 21	PJ	<p>Implementuar: Proporcioni pas këtij rekomandimi është shpjeguar gjatë trajnimit pilot.</p> <p>Pikë veprimi: Rekomandimi duhet të zbatohet.</p>	Implementimi i këtij rekomandimi varet nga zhvillimi i Këshillave dhe përmirësimi i performancës së Komisioneve përkatëse të Këshillave. Ky rekomandim nuk është implementuar.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	33	<p>Kursi për emërime/vlerësim/përgjegjësi disiplinore në kuadër të trajnimeve fillestare. Rekomandohet që:</p> <ul style="list-style-type: none"> të përfshihet në kurrikulumin e programit të trajnimeve fillestare në kuadër të udhëzimeve për organizimin e trajnimeve gjyqësore . të selektohen trajnerët e njëjtë me ata që janë përcaktuar nga Këshillat si trajnerë gjatë pilot trajnimit të organizuar nga projekti. Përmbajtja kryesore e programit fillestar të trajnimit duhet të përfshijë Standardet ndërkombëtare dhe parimet e emërimit/vlerësimit/përgjegjësisë disiplinore Aspektet kryesore procedurale dhe materiale të kornizës ligjore në Kosovë në këto fusha 	x	x				6, 11, 13	PJ	<p>Implementuar: IGJK ka pranuar rekomandimin dhe është në proces të miratimit të programit (kurrikulit) përkatës. Pikë veprimi: Programi duhet të miratohet dhe implementohet.</p>	Nuk ka pasur ndryshime për implementimin e këtij rekomandimi.
II & III	34	<p>Trajnimi i vazhdueshëm në fushën e emërimeve/vlerësimit/disiplinës IGJK në bashkëpunim me KGJK/KPK rekomandohet të</p> <ul style="list-style-type: none"> ofrojë trajnime të përshtatshme çdo herë që themelohet një Komision i Emërimit/Rishqyrtimit/Vlerësimit/Disiplinor si dhe kur zgjedhen anëtarët e rinj të Këshillit. ofrimin e trajnimeve të drejtpërdrejta për anëtarët e rinj të emëruar ose të zgjedhur në rast të ndërprerjes së mandatit të anëtarëve individual në rast të vlerësimit, të përfshihen në të gjitha trajnimet edhe Kryetarët e Gjykatave / Kryeprokurorët dhe eventualisht ofrimi i trajnimeve specifike për Kryetarët e Gjykatave / Kryeprokurorët ofrimi i një programi të trajnimit për të gjithë gjyqtarët/prokurorëtnë baza të rregullta sa herë që ndodhin ndryshime në kronizën ligjore për vlerësimin dhe përgjegjësinë disiplinore përdorimi i materialeve të trajnimit të ofruara dhe të sugjeruara nga Projekti dhe azhurnimi i vazhdueshëm i materialit të trajnimit 	x	x				6, 13, 21	PJ	<p>Implementuar: IGJK dhe dy Këshillat kanë pranuar rekomandimin dhe planifikojnë të ofrojnë trajnimet përkatëse. Pikë veprimi: Trajnimi duhet të ofrohet sa herë që ka nevojë.</p>	Ky rekomandim nuk është implementuar. Pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për AGJK duhet të krijohet një mekanizëm koordinues mes KGJK/KPK dhe AGJK.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III 35	<p>Zhvillimi i Kapaciteteve për Sekretarët Ligjor dhe Personelin Mbështetës</p> <p>Këshillat rekomandohen që të zhvillojnë kapacitetet e personelit të tyre në mënyrë që të përgatisin zyrtarët për odrimin e mbështetjes profesionale, efikase për funksionimin e Këshillave. Në veçanti duhet ti kushtohet vëmendje e veçantë zhvillimit të kapaciteteve të Sekretarëve Ligjor të Komitetit dhe udhëheqësit të njëjësive/zyrave të Sekretariatit/NJSHPP, në mënyrë që të mbështeten për të asistuar në mënyrë më efikase Komisionet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • për dokumentimin më adekuat të të gjitha vendimeve duke përfshirë indeksimin, • në të gjitha veprimet që ndërlidhen me ruajtjen e të dhënave dhe komunikimin me palët, • për të siguruar aplikimin e njëtrajtshëm të ligjit, • për rritjen e kapaciteteve të hulumtimit ligjor. 	x	x				9, 13, 14	PJ	<p>Implementuar: Sekretarët Ligjor dhe personeli mbështetës ka marrë pjesë në trajnimet pilote dhe kanë qenë të përfshirë në mënyrë aktive në përgatitjen e procedurave standarde të veprimit.</p> <p>Pikë veprimi: Sekretarët Ligjor dhe Komisionet si dhe personeli tjetër mbështetës kanë nevojë për zhvillim të mëtutjeshëm të kapaciteteve.</p>	Ky rekomandim është implementuar pjesërisht. Projekti ka zhvilluar trajnime shtesë në vitin 2015. Megjithatë, në amendamentet ligjore të vitit 2015, rregulloret e reja dhe ndryshimet dhe plotësimet e disa rregulloreve në fuqi, kërkohet ndryshimi i programeve ekzistuese të trajnimit dhe zhvillimi i trajnimeve në bazë të ANT.
II & III 36	<p>Trajnimi i përbashkët i Anëtarëve të Komisionit dhe personelit</p> <p>Personeli i Këshillave do të mbështesë Komisionet dhe Këshillat në mënyrë efikase. Për këtë arsye është e rëndësishme të zgjerohen njohuritë e personelit për procesin e rekrutimit/vlerësimit/disiplinës. Personeli duhet të ketë një vision të finalitetit dhe përdorimit të dokumenteve. Kjo do të ndihmojë në mirëkuptim të ndërjellët. Për këtë arsye, zyrtarët e identifikuar duhet të jenë pjesë e grupit të targetuar për trajnim të vazhdueshëm në të ardhmen.</p>	x	x				9, 14	PJ	<p>Implementuar: Trajnimet pilote pjesërisht janë zhvilluar së bashku.</p> <p>Pikë veprimi: Në të ardhmen, trajnimet gjithashtu duhet të ofrohen (pjesërisht) së bashku.</p>	Projekti ka ofruar disa trajnime të përbashkëta në vitin 2015 sipas këtij rekomandimi. Kërkohet implementimi i vazhdueshëm i këtij rekomandimi.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	37	<p>E drejta dhe detyrimi për pjesëmarrje në trajnim të vazhdueshëm Ligji duhet të sqarojë se secili gjyqtar/prokuror, i cilitdo rank, duhet të mbetet i informuar me zhvillimet dhe trajnimet që janë në dispozicion të të gjithë gjyqtarëve/prokurorëve, dhe të gjithë gjyqtarët/prokurorët duhet të kërkojnë që të pranojnë trajnim të vazhdueshëm gjyqësor. Pjesëmarrja në trajnim duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit.</p>	x	x			LGJ, Ligji për PSH	3, 4, 11, 14, 16	J	<p>Pikë veprimi: Ligjet duhet të përfshijnë të drejtën dhe detyrimin për pjesëmarrje në trajnime .</p>	<p>Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk janë bërë ndryshime në ligjet përkatëse. Megjithatë, rregulloret për vlerësimin e performancës përcaktojnë vlerësimin e pjesëmarrjes në trajnime.</p>
II & III	38	<p>Promovimi dhe monitorimi i trajnimit të vazhdueshëm Trajnimi i vazhdueshëm në të gjitha nivelet e sistemit gjyqësor/prokurorial duhet të promovohet. Duhet të krijohet një sistem që i lejon Këshillave që të monitorojnë aktivitetet e trajnimit të secilit gjyqtar/prokuror dhe që siguron që në trajnim të marrin pjesë ata që vërtet kanë nevojë.</p>	x	x			11, 14	PJ	<p>Implementuar: KGJK/KPK kanë themeluar zyrat e trajnimit ku koordinohen të gjitha aktivitetet e trajnimit për gjyqtarë/prokurorë. Pikë veprimi: Ende duhet të krijohet një mekanizëm për vlerësimin e vazhdueshëm të nevojave të trajnimit dhe për aprovimin e pjesëmarrjes në trajnime.</p>	<p>Pas themelimit të një Zyre për Trajnime në NJSHPP, nuk janë ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm për koordinimin e aktiviteteve të trajnimit.</p>	

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
Vlerësimi i Sistemit të Drejtësisë											
II & III	39	<p>Qëllimi i vlerësimit të sistemit të drejtësisë</p> <p>Qëllimi i vlerësimit të sistemit të drejtësisë si të tillë duhet të përcaktohet me ligj. Qëllimi i vlerësimit të sistemit të drejtësisë duhet të përfshijë:</p> <p>a) ngritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë</p> <p>b) përmirësimin e performancës së sistemit të drejtësisë</p> <p>c) rritjen e kualitetit dhe kuantitetit të sistemit</p> <p>d) përcaktimin e pragjeve konsistente të kualitetit dhe kuantitetit</p> <p>e) informimin e vendimeve të KGJK/KPK në relacion me burimet njerëzore, nevojat e trajnimit dhe zhvillimin e karrierës</p> <p>f) informimin e vendimeve të KGJK/KPK për çështjet buxhetore</p> <p>g) monitorimin e performancës me qëllim të planifikimit dhe menaxhimit afatgjatë</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	9, 10, 11, 21	J	Pikë veprimi: Ligji për KGJK/KPK duhet të ndryshohet.	Një mekanizëm për vlerësimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial nuk është krijuar ende. Në Ligjet për KGJK, LGJ, KPK dhe PSH nuk janë përfshirë amendamentet përkatëse.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
I	40	<p>Mbledhja e të dhënave dhe kontrolli i cilësisë në sistemin e drejtësisë</p> <p>Rekomandohet që të dhënat statistikore të mblidhen nga gjykatat/prokuroritë dhe të dërohen në Këshilla. Të dhënat statistikore duhet të përpunohen në mënyrë elektronike. Të dhënat e mbledhura duhet ti referohen secilës gjykatë/prokurori si dhe gjyqtarëve/prokurorëve individual.</p> <p>Publikimi i të dhënave statistikore lidhur me rastet aktuale dhe të kaluara në secilën gjykatë/prokurori rekomandohet për të rritur transparencën dhe ndarjen e punëve. Format e përshtatshme duhet të gjinden për lirim të informatave të rezervuara për hulumtuesit dhe të gjyqësuesin në mënyrë që të monitorohet përmirësimi i sistemit.</p> <p>Këshillat duhet të zhvillojnë një proces të monitorimit të vazhdueshëm. Ky monitorim duhet të ndihmojë në identifikimin e mangësive dhe nevojave lidhur me organizimin e gjykatave/prokurorive ose alokimin e burimeve njerëzore dhe materiale. Duhet të ketë bashkëpunim të mirë mes të gjithë akterëve për interpretimin dhe shpërndarjen e të dhënave. Ligji duhet të përmbajë një rregull të përgjithshëm për kompetencat e Këshillave për mbledhjen e të dhënave dhe për sigurimin e kontrollit të cilësisë.</p>	x	x	x	LKGJK, LKPK	9, 13	PJ	<p>Implementuar: Të dy Këshillat mbledhin të dhëna nga Gjykatat/Prokuroritë dhe të dhëna për rastet të cilat u caktohen gjyqtarëve/prokurorëve individual. Që nga mesi/fundi i vitit 2013 të dhënat përpunohen në mënyrë elektronike dhe përmbajnë të dhëna relevante lidhur me të gjitha gjykatat/prokuroritë si dhe për gjyqtarët/prokurorët individual. Sistemi elektronik i mbledhjes së të dhënave në KPK është përshtatur me Kodin e ri të Procedurës Penale.</p> <p>Pikë veprimi: Ligji për KGJK/KPK duhet të ndryshohet në mënyrë që të sigurohet baza e rregullt për Këshillat që të mbledhin dhe përpunojnë të dhënat. Duhet të implementohet një mekanizëm gjithpërfshirës për kontrollin e cilësisë dhe mekanizmat për mbledhjen e të dhënave duhet të përmirësohen vazhdimisht.</p>	<p>Ligji për KPK ka krijuar bazën ligjore për mbledhjen e të dhënave statistikore: neni. 4 1.13. parashikon sigurimin dhe publikimin e informatave dhe të dhënave statistikore për sistemin prokurorial. Ende nuk është krijuar një mekanizëm për kontrollin e cilësisë.</p>	

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	41	<p>Vlerësimi i sistemit gjyqësor/prokurorial</p> <p>Cilësia e drejtësisë duhet të matet me të dhëna objektive, siç janë kushtet e qasjes në drejtësi dhe mënyra se si priten qytetarët në gjykata/prokurori, lehtësinë me të cilën zbatohen procedurat në dispozicion dhe afatet kohore brenda të cilave nxjerren dhe zbatohen vendimet.</p> <p>Gjithashtu duhet të vlerësohet vlera e vendimeve të nxjerra dhe mënyrës së si perceptohen këto vendime nga publiku.</p> <p>Duhet të marrë parasysh informatat e natyrës më shumë politike, siç është proporcioni i buxhetit shtetëror që alokohet për drejtësi dhe perceptimi i degëve tjera të pushtetit për pavarësinë e sistemit gjyqësor/prokurorial.</p> <p>Vlerësimi duhet të marrë parasysh kontekstin edhe më të gjerë, d.m.th ndërvperimin e drejtësisë me variablat tjerë (gjyqtarët dhe avokatët, drejtësia dhe politika, praktika gjyqësore dhe legjislati etj), pasi që shumica e problemeve në sistemin e drejtësisë rrjedhin nga mungesa e koordinimit mes akterëve të ndryshëm.</p> <p>Gjithashtu, ndërveprimi mes cilësisë së drejtësisë dhe pranisë së infrastrukturës adekuate dhe personelit mbështetës duhet të shqyrtohet. "Cilësia" e drejtësisë nuk duhet të kuptohet si sinonim për thjeshtë "produktivitetin" e sistemit gjyqësor/prokurorial; një qasje kualitative duhet të adresojë aftësinë e sistemit për plotësimin e kërkesës për drejtësi në pajtim me synimet e përgjithshme të sistemit të drejtësisë, në të cilin shpejtësia e procedurave është vetëm njëri nga elementet.</p>	x	x				9, 11	PJ	<p>Implementuar: Të dy Këshillat kryejnë një vlerësim të punës së këshillave në bazë vjetore dhe raportojnë përmes Raportit Vjetor. Në Mars 2014 NJSHPP ka përgatitur një raport shumë të detajuar dhe analitik lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për Rritjen e Efektshmërisë së Sistemit Prokurorial për Luftën Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit .</p> <p>Pikë veprimi: Deri më tani nuk është përgatitur ndonjë raport gjithëpërfshirës për sistemin gjyqësor/prokurorial.</p>	<p>Pjesa analitike e raporteve të përgatitura nga KGJK, NJSHPGJ, KPK, NJSHPP, Sekretariatet është përmirësuar kohëve të fundit. Raportet ende duhet të bëhen më gjithëpërfshirëse dhe të strukturohen më mirë. Konkludimet, rekomandimet dhe propozimet në këto raporte duhet të pasqyrojnë politikën, vendimet dhe planet e Këshillave.</p>

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
Cështje Buxhetore											
I	42	<p>Roli i Këshillave në procesin buxhetor</p> <p>Pa paragjykuar përgjegjësitë aktuale të qeverisë për propozimin e buxhetit për gjyqësorin në parlament, është e këshillueshme që Këshillat të paraqesin në qeveri nevojat buxhetore të sistemit të drejtësisë në mënyrë që të merren vendime të informuara buxhetore. Këshillat duhet gjithashtu të marrin pjesë gjatë shqyrtimeve buxhetore në Kuvend. Këshillat gjithashtu mund të luajnë një rol në shpërndarjen e buxhetit brenda sistemit gjyqësor/prokurorial.</p> <p>Rekomandohet që të shqyrtohet mundësia e delegimit të kompetencës për administrimin e buxhetit të ZPD në Sekretarinë e ZPD dhe për shqyrtimin e delegimeve të aprovuara financiare të KGJK/KPK si organizata buxhetore.</p>	x	x		x	LKGJK; LKKPK	11, 13	PJ	<p>Implementuar: Ligji për KGJK/KPK i japin kompetencën Këshillave që të përgatisin buxhetor vjetor të Këshillave dhe për gjykatat/prokuroritë. Nëse Ministri i Financave dorëzon një buxhet të ndryshëm nga ai i propozuar nga Këshillat, duhet njëkohësisht të dorëzojë propozimin e Këshillave.</p> <p>Pikë veprimi: Këshillat duhet të kenë të drejtën që të dëgjohen nga parlamenti. Kjo çështje duhet të përcaktohet me ligj. Deligimimi i pushtetit për administrimin e buxhetit duhet të konsiderohet.</p>	LNP-LKGJK, Neni. 5 që ndryshon Nenin 6 paragrafi 3 të ligjit bazik përcakton: 'i Propozon Kuvendit buxhetin e propozuar të Këshillit për shpenzimet operative dhe të personelit të Këshillit dhe Gjykatave'; Gjithashtu Neni 9 i LNP-LKGJK që ndryshon Nenin 15 paragrafi 1 të ligjit bazik me dispozitën në vijim: 'Këshilli përgatit propozimin vjetor buxhetor dhe e dorëzon atë në Kuvendin e Kosovës për miratim. Ky rekomandim pjesërisht e zgjidh situatën.'
I	43	<p>Mbështetja e Procesit Vjetor të Planifikimit Buxhetor</p> <p>Rekomandohet që të përmirësohen rregulloret e brendshme buxhetore dhe afatet e brendshme për gjykatat/prokuroritë, departamentet dhe njësitë në të cilat mbështetet drejtori financiar për marrjen e informatave të detajuara buxhetore dhe të cilat më pas konsolidohen në buxhetin e KGJK/KPK nga Sekretaria e KGJK, respektivisht administrata e KPK.</p> <p>Gjithashtu, procedurat stadarde të veprimit lidhur me aspektet specifike të dokumentacionit të kërkuar si pjesë e procesit buxhetor, për shembull - caktimi i sybimeve, objektive dhe treguesve të performancës duhet të zhvillohet.</p>	x	x			11	J	<p>Pikë veprimi: Rishikimi i rregullave të brendshme buxhetore dhe afateve kohore, trajnimet për mbështetjen e aspekteve të caktuara të dokumentacionit.</p>	Projekti ka përgatitur një Manual dhe ka zhvilluar katër punëtori në vitin 2015 që kanë për qëllim përmirësimin e buxhetimit në sistemin gjyqësor dhe zhvillimin e kapaciteteve të personave përgjegjës për buxhetim në kuadër të Këshillave, Gjykatave dhe Prokurorive. Hapa të mëtejshëm për zbatimin e Manualit duhet të ndërmerren nga Këshillat.	

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
I	44	<p>Raportimi dhe Monitorimi Rekomandohet krijimi i një mekanizmi për monitorimin e vazhdueshëm të buxhetit dhe për rritjen e kapaciteteve për raportin financiar tremujor dhe vjetor. Përmbajtja e prezantimit të buxhetit si dhe procesi i prezantimit të raporteve financiare në Komisionin për Buxhet dhe Financa të KGJK/KPK duhet të përmirësohet. Rekomandohet që të rritet vetëdijësimi dhe rëndësia e përmbajtjes së raportit të auditimit, çështjet materiale që ngriten për shqyrtim në nivel të Bordit dhe veprimet përcjellëse në bazë të gjetjeve të auditimit (Raporti për KGJK/KPK nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm dhe Raportet e Auditimit të Brendshëm).</p>	x	x				11	J	<p>Pikë veprimi: Raportimet brenda vitit, raportimet tremujore dhe vjetore si dhe monitorimi i buxhetit nga KGJK/KPK.</p>	<p>Manuali i përgatitur nga Projekti dhe i dorëzuar në KGJK dhe KPK në vitin 2015 përmban propozime të qarta për raportimin financiar dhe monitorimin e zbatimit të buxhetit.</p>
I	45	<p>Zhvillimi i Kapaciteteve të KGJK/KPK dhe Sekretariatit për Menaxhim Financiar Rekomandohet që të rritet vetëdijësimi i anëtarëve të KGJK/KPK dhe anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa të KGJK/KPK lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë për përpilimin, aprovimin dhe monitorimin e buxhetit të KGJK/KPK. Komisionet për Buxhet dhe Financa duhet të përmirësojnë planifikimin e pikave të agjendës të KGJK/KPK me fokus të veçantë në tabelat e procesit vjetor buxhetor, rishikimin buxhetor në mes të vitit, prezantimin e shifrave dhe shqyrtimin dhe përgjigjen ndaj raporteve të brendshme dhe të jashtme të auditimit.</p>	x	x				11	J	<p>Pikë veprimi: Zhvillimi I mëtutjeshëm I kapaciteteve të anëtarëve të KGJK/KPK dhe anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa.</p>	<p>Materialet e trajnimit për punëtoritë e organizuara nga Projekti në vitin 2015 për anëtarët e KGJK/KPK dhe anëtarët e Komisioneve për Buxhet të tyre janë dorëzuar në Këshilla për organizimin e trajnimeve të ardhshme sipas nevojës.</p>
I	46	<p>Mbështetje për Udhëheqësit e Njërive / Menaxherët Jo Financiar që kanë përgjegjësi buxhetore të KGJK/KPK dhe për Zyrarët Financiar Rekomandohet që të bëhet zhvillimi i kapaciteteve të menaxherëve jo financiar në mbështetje të asaj pjesë të detyrave të tyre që pritet të jetë e përfshirë në procesin e planifikimit buxhetor, ekzekutimit dhe monitorimit të buxhetit. Gjithashtu, ka nevojë për zhvillimin e kapaciteteve të zyrtarëve financiar në gjykata/prokurori.</p>	x	x				11	J	<p>Pikë veprimi: Trajnimi në çështje buxhetore për menaxherët jo financiar dhe zyrtarët financiar të gjykatave/prokurorive.</p>	<p>Materialet e trajnimit për punëtoritë e organizuara nga Projekti në vitin 2015 për anëtarët e personelit përgjegjës për buxhetim janë dorëzuar tek Këshillat për organizimin e trajnimeve të ardhshme sipas nevojës.</p>

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
Planifikimi Strategjik											
I	47	<p>Struktura dhe përmbajtja e planit strategjik</p> <p>Sfidat kryesore në vijim duhet të paraqiten ne Planin Strategjik:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rishikimi dhe Zhvillimi Institucional • Korniza Ligjore dhe Reforma • Zhvillimi i Burimeve Njerëzore • Infrastruktura dhe Teknologjia Informative • Qasja në drejtësi <p>Gjithashtu duhet të adresohen çështjet në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vizioni dhe Drejtimi Strategjik i KGJK/KPK, duke përfshirë vlerat (njerëzit, drejtësinë, pavarësinë, integritetin, profesionalizmin, respektin dhe kredibilitetin), • misioni dhe synimet strategjike (fuqizimi i kornizës ligjore, fuqizimi i aspekteve institucionale, zhvillimi i kapaciteve të burimeve njerëzore, zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme, rritja e qasjes në drejtësi, transparenca dhe komunikimi), • supozimet dhe rreziqet, • treguesit (për matjen e progresit në implementimin e planit strategjik) 	x	x				PM	P	<p>Implementuar: Draft Planet Strategjike janë përgatitur nga dy Këshillat.</p> <p>Pikë veprimi: Draft Planet Strategjike aktualisht janë në proces të përgatitjes nga Këshillat.</p>	KGJK ka aprovuar Planin Strategjik pesëvjeçar dhe Planin e Veprimit për zbatimin e Planit Strategjik në vitin 2014. KPK ka aptovuar Planin Strategjik tre vjeçar, të përgatitur më mbështetjen e projektit me 12.02.2016.
I	48	<p>Plani i Veprimit për Implementimin e Planit Strategjik</p> <p>Çdo plan strategjik duhet të përfshijë një Plan të Veprimit për Implementimin e Planit Strategjik të KGJK/KPK me afate, buxhet dhe persona përgjegjës për implementimin e tij.</p>	x	x				PM	P	<p>Implementuar: KGJK tashmë ka përgatitur Planin e Veprimit.</p> <p>Pikë veprimi: KGJK është aktualisht në proces të miratimit të Planit Strategjik së bashku me Planin e Veprimit. KPK ende duhet të përgatisë një Plan të Veprimit për Implementimin e Planit Strategjik dhe ta miratojë atë.</p>	Ky rekomandim është implementuar nga KGJK. Projekti ka përgatitur draft Planin e Veprimit të KPK.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
I	49	Zhvillimi i Kapaciteteve dhe Krijimi i Zyrës për Planifikim Strategjik Është evidente se kapacitet aktuale në fushën e poitikave dhe planifikimit janë të kufizuara. Rekomandohet fuqishëm të bëhet zhvillimi i kapaciteteve për planifikim strategjik dhe menaxhim. Aktualisht nuk ka ndonjë strukturë në KGJK/KPK që është përgjegjëse për koordinim, planifikim dhe hulumtim të politikave. Prandaj, menaxhmenti i KGJK/KPK duhet të konsiderojë themelimin e Zyrës për Planifikim Strategjik në KGJK/KPK ose të paktën të caktojë zyrtarë për zbatimin e këtyre aktiviteteve.	x	x				PM	J	Pikë veprimi: Në kuadër të KGJK/KPK duhet të krijohet një strukturë me përgjegjësi për planifikim strategjik dhe për koordinim, planifikim dhe zhvillim të politikave .	KGJK ka implementuar këtë rekomandim. KPK e ka pranuar rekomandimin. Megjithatë, Këshilli i sapo krijuar është ende në proces të vendosjes lidhur me Sekretariatit dhe njësitë e tij.
I	50	Krijimi i Grupit Monitorues të Punës Rekomandohet që të krijohet një Grup Punues ose Komision për monitorimin e zbtimit të Planit Strategjik të KGJK/KPK.	x	x				PM	J	Pikë veprimi: Në kuadër të KGJK/KPK duhet të themelohet një strukturë me përgjegjësi për planifikim strategjik .	Personat e emëruar në Sekretariatit e KGJK kanë përgjegjësinë për monitorimin e zbatimit të Planit Strategjik.
I	51	Rishikimi Funkcional Gjatë dhe pas implementimit të Planit Strategjik të KGJK/KPK, rekomandohet që të zhvillohet një rishikim funksional i funksionalitetit të strukturës së re të propozuar të gjykatës/prokurorisës, tërë sistemit gjyqësor/prokurorial si dhe organizimit dhe funksionimit të KGJK/KPK.	x	x				PM	J	Pikë veprimi: Plani Strategjik së pari duhet të implementohet dhe më pas të kryhen rishikimet funksionale.	Rishikimi dhe vlerësimi i funksionalitetit të strukturës së re të Gjykatave / Prokurorive është proces i vazhdueshëm. Të dy Këshillat duhet të iniciojnë dhe të zhvillojnë një analizë gjithëpërfshirëse dhe të ndërmarrin masat për zhvillimin e strukturës së re përshtatshëm.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
I	52	<p>Planifikimi Strategjik (Organizativ) dhe Planifikimi Financiar Rekomandohet që të ofrohet mbështetje për Drejtorin e Financave dhe Buxhetit (ose udhëheqësit të emëruar nga KGJK/KPK për Planifikim Strategjik) për zhvillimin e pjesëve financiare të Planit Strategjik të KGJK 2014-2019 dhe Planit Strategjik të KPK 2014-2016 – kjo mund të përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Planifikimin strategjik dhe të skenareve për identifikimi ndhe pritjen e zhvillieve të konsiderueshme afatmesme të KGJK/KPK siç është ndikimi i skemave kapitale të riorganizimit. Lehtësimi dhe paraqitja e kostove për këtë ndryshime në kuptim afatmesëm. • Mbështetja për hartimin e komponentës financiare të nivelit të lartë të Planit Strategjik, duke përfshirë ndërlidhjen me objektivat strategjike të KGJK/KPK, aktivitetet dhe rezultatet e matshme • Nga identifikimi i çështjeve të konsiderueshme afatmesme që dalin nga procesi i Planifikimit Strategjik dhe nga Deklarata e Prioriteteve të KGJK/KPK 2014-2016, identifikimi imënyrave për ndërlidhjen më të mirë me planifikimin vjetor buxhetor për secilin vit fiskal 	x	x				PM	J	<p>Pikë veprimi: Rishikimi i pjesës financiare të Planit Strategjik.</p>	<p>Plani Strategjik dhe Plani i Veprimit i KGJK janë miratuar. Pjesa financiare e Planit Strategjik është shqyrtuar dhe shtjelluar përshtatshëm. Plani Strategjik i KPK është miratuar me 12 Shkurt 2015 dhe është në pajtim me amendamentet e fundit ligjore dhe dokumentet e projektit të përgatitura për mbështetjen e buxhetimit të sistemit për vitin 2015 (planifikimi, raportimi, niveli i decentralizimit, etj.)</p>

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	LKP	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
Emërimi, Transferimi dhe Ngritja në Detyrë											
II & III	53	<p>Kompetencat e Këshillave për (ri)emërimine, transfere dhe ngritje në detyrë</p> <p>Të gjitha vendimet lidhur me (ri)emërimet, transferet dhe ngritjet në detyrë që merren nga Këshillat.</p>	x	x		x	LKGJK; LKP; LIGJK /JAL	3, 5, 10, 11, 13, 16, 17, 20	PJ	<p>Implementuar: Ligjet - në përgjithësi - caktojnë kompetencën për propozimin e kandidatëve për (ri) emërim, transferim dhe ngritje në detyrë para Këshillaves.</p> <p>Pikë veprimi: Kompetenca për pranimin e kandidatëve në trajnimin fillestar (të obligueshëm) duhet të sqarohet më mirë. Amendamenti i ligjit është ende në proces e sipër.</p>	<p>Rekomandimi është implementuar – LKGJK dhe LKP janë ndryshuar dhe plotësuar përshtatshëmish: Neni 4.1.19, LKGJK përcakton se KGJK “në bashkëpunim me institutin, organizon ekzaminimin përgatitës të kualifikimeve të kandidatëve për gjyqtar, dhe është shtuar një paragraf i ri që i jep kompetencën për procesin e emërimit KGJK në Nenin 4. 1.28: “nxjerrjen e një rregullore për caktimin e kushteve dhe procedurave për organizimin e provimit për kandidatët për gjyqtarë”; paragrafi. 1.29: "shpalljen dhe organizimin e provimit për gjyqtarë). LKP është ndryshuar dhe plotësuar në këtë drejtim - Neni.4.1.2.8, Neni.4.1.31. LKP.</p>
II & III	54	<p>Mos përcaktimi i kriterëve të emërimit nga KGJK me rregullore</p> <p>Neni 26(1) i Ligjit për Gjykatat duket se i lejon KGJK që të përcaktojë kriteret me rregullore. Kjo është në konflikt me kushtetutën që kërkon përcaktimin e kriterëve me ligj dhe me standarde ndërkombëtare.</p>	x			x	LGJ	5, 13, 15, 20	PJ	<p>Implementuar: KGJK ka përgatitur një rekomandim të politikave për shfuqizimin e kësaj dispozite.</p> <p>Pikë veprimi: Neni 26 i Ligjit për Gjykatat duhet të ndryshohet.</p>	<p>Ky rekomandim është zbatuar. Neni. 26 i LGJ është ndryshuar dhe plotësuar në vitin 2015 dhe kriteret e emërimit janë përcaktuar me ligj.</p>
III	55	<p>Kriteret dhe procedura speciale për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit</p> <p>Kryeprokurori i Shtetit është faktor kyq për pavarësinë e shërbimit prokurorial për shkak se të gjithë prokurorët i përgjigjen atij/saj dhe teorikisht ai/ajo mund të ndikojë në vendimet që merren nga të gjithë prokurorët.</p> <p>Është e këshillueshme që kjo pozitë të hapet për prokurorët që nuk janë aktualisht në shërbim duke përcaktuar me ligj kriteret e qarta dhe transparente dhe një procedurë të hapur dhe të drejtë të emërimit dhe pa ndikime politike. Rekomandohet që ti epet prioritet prokurorëve aktiv me performancë të lartë profesionale dhe që për prokurorët jo aktiv të kërkohet të paktën e njëjta peirudhë e përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë penale dhe përvojë e ngjashme në funksione menaxheriale.</p>		x		x	LPSH	2, 9, 10, 11, 13, 14	PJ	<p>Implementuar: KPK ka përgatitur një rekomandim të politikave për hapjen e pozitës së Kryeprokurorit edhe për prokurorë që nuk ushtrojnë detyrën aktualisht.</p> <p>Pikë veprimi: Rregullat më të qarta procedura për procesin e emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit duhet të përcaktohen me ligj. Ndryshimi dhe plotësimi i ligjit ende është në proces e sipër.</p>	<p>Sipas amendamenteve në LNP-LPSH, nuk ka kriteret specifike për emërimin e KPSH. Vetëm në një dispozitë LNP-LPSH përcakton kriteret për kushtet e emërimit të KPSH (Neni. 8 që ndryshon Nenin 20 të ligjit bazik.) që kërkohet të ketë 8 vjet përvojë. Përveç kësaj, si LNP-LPSH ashtu edhe LNP-LKP nuk përmbajnë dispozita për zbatimin e këtij rekomandimi.</p>

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	56	Kompetencat e Presidentit lidhur me (ri)emërimet Nëse kompetenca për emërimin e gjyqtarëve/prokurorëve do të qëndrojë të Presidenti i Republikës, ligji duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë se propozimi i kandidatëve për emërim nga KGJK/KPK është i detyrueshëm.	x	x		x	Kusht , LKGJ K, LKPK	3, 5, 10, 11, 13	PJ	Implementuar: Gjykata Kushtetutë në mënyrë të qartë ka theksuar se kompetencat e Presidentit janë të kufizuara. Pikë veprimi: Kushtetuta dhe Ligji për KGJK/KPK duhet të përcaktojnë në mënyrë të qartë se kompetencat e Presidentit në këtë fushë janë të kufizuara.	Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk është bërë ndonjë amendament ligjor.
II & III	57	Harmonizimi i kualifikimeve minimale për gjyqtarë dhe prokurorë Ligji për Gjykatat dhe Ligji për PSH përcaktojnë kualifikimet minimale që janë të ndryshme për gjyqtarë dhe prokurorë. Rekomandohet që këto ligje të harmonizohen.	x	x		x	LGJ, LPSH	11	PJ	Implementuar: Të dy Këshillat kanë dorëzuar rekomandime të politikave për përfshirjen e dispozitave për harmonizimin e kualifikimeve minimale. Pikë veprimi: Neni 26 i Ligjit për Gjykatat dhe Neni 19 i Ligjit për PSH duhet të ndryshohen.	Dispozitat ligjore janë amendamentuar në vitin 2015. Përmes këtyre amendamenteve, kualifikimet minimale janë harmonizuar për gjyqtarë dhe prokurorë.
II & III	58	Kriteret e (ri)emërimit Rekomandohet që kriteret e (ri)emërimit për gjyqtarë dhe prokurorë të përcaktohen në pajtim me Nenin 17 të Ligjit për KGJK dhe Nenin 18 të Ligjit për KPK. Rekomandohet shtimi i kriterit 'reputacioni i lartë profesional dhe integriteti moral' në Ligjin për KGJK/KPK dhe të sqarohet përmbajtja e kriterit 'integriteti personal' dhe 'integriteti moral'.	x	x		x	LKGJ K, LPLGJ	2, 3, 4, 5, 10, 11, 13, 14, 15, 16	PJ	Implementuar: Të dy Këshillat kanë dorëzuar rekomandime të politikave për përfshirjen e një dispozite lidhur me ristrukturimin e kriterëve dhe për përkufizimin e termeve. Pikë veprimi: Neni 17/18 i Ligjit për KGJK/KPK dhe Neni 26 i Ligjit për Gjykatat dhe Neni 19 i Ligjit për PSH duhet të ndryshohen.	Kriteret për 'reputacionin e lartë profesional' dhe 'integritetin personal' janë paraparë në amendamentet e LGJ dhe LPSH që kanë hyrë në fuqi me 15 Korrik 2015. Neni 26, LGJ dhe Neni 19 LPSH janë ndryshuar dhe plotësuar përshtatshmërisht.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	59	<p>Kriteret e posaçme të riemërimit</p> <p>Kriteret për riemërim janë të njëjta sikurse për emërim. Kjo është e pranueshme. Megjithatë, baza për riemërim duhet të jetë kryesisht vlerësimi i performancës së gjyqtarëve/prokurorëve gjatë mandatit fillestar të tyre. Në rast të trajnimit të obligueshëm fillestar pas emërimit, rezultatet e provimit gjatë trajnimit fillestar dhe vlerësimit gjatë trajnimit fillestar, duke përfshirë trajnimit në terret duhet të merret parasysh. Nota minimale në provime dhe vlerësimet për riemërim duhet të përcaktohen me ligj/rregullore.</p> <p>Në fund të mandatit fillestar, gjyqtari/prokurori duhet të ketë të drejtën e pranimit të një vendimi të shkruar dhe të arsyetuar për riemërimin e tij/saj apo jo.</p>	x	x			LKGJ K, LKPK, LIGJK /JAL	3, 4, 5, 10, 11, 13	PJ	<p>Implementuar: Kriteret për riemërim janë përcaktuar me ligj. Këshillat kanë dorëzuar një rekomandim të politikave për bazimin e vendimin për riemërim në procesin e vlerësimit, duke përfshirë rezultatet e provimeve të zhvilluara gjatë trajnimit fillestar si dhe vlerësimet e performancës gjatë mandatit fillestar.</p> <p>Pikë veprimi: Procesi i ndryshimit të ligjit aktualisht është në proces e sipër.</p>	<p>Ky rekomandim është zbatuar përmes ndryshimeve dhe plotësimeve të ligjeve në vitin 2015 – dy vlerësime parashihen pas emërimit fillestar: njëri pas trajnimit fillestar 12 muor dhe i dyti 3 vite pas emërimit fillestar si parakusht për emërim të përhershëm.</p>
II & III	60	<p>Kontrollet e të kaluarës</p> <p>Rekomandohet që të përcaktohet në mënyrë të qartë me ligj fushëveprimi i kontroleve të të kaluarës, qasja e kandidatëve në të gjitha dokumentet e mbledhura gjatë kontrollit, e drejta për tu dëgjuar dhe mundësia e rishikimit gjyqësor. Gjatë kontrollit të së kaluarës duhet të respektohet privatësia dhe dinjiteti i kandidatëve dhe ti referohet dosjes penale dhe bazave tjera të shkualifikimit nga politika, anti-korrupsioni, administrata tatimore, njësia e intelegjencës financiare dhe autoritetet disiplinore.</p>	x	x			LKGJ K, LKPK	2, 3, 13, 15	PJ	<p>Implementuar: Të dy këshillat kanë dorëzuar një rekomandim të politikave për përfshirjen e një dispozite në ligjet përkatëse për kontrollet e të kaluarës.</p> <p>Pikë veprimi: Ligjet për KGJK/KPK duhet të ndryshohen.</p>	<p>Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk janë bërë amendamente ligjore. Projekti ka rekomanduar respektimin e Rekomandimeve të Kievit të OSBE për Pavarësinë e Gjyqësorit në Evropën Lindore, Kaukazin Jugor dhe Azinë Qendrore të vitit 2010.</p>
II & III	61	<p>Përkufizimi i përvojës 'ligjore'</p> <p>Neni 26 i Ligjit për Gjykatat e përkufizon përvojën ligjore për të përfshirë përvojën si prokuror, gjykatës, avokat apo akademik. Ligji për PSH nuk përmban ndonjë përkufizim. Rekomandohet që të llogaritet vetëm përvoja profesionale pas diplomimit nga fakulteti juridik he të zgjerohet përkufizimi i Ligjit për Gjykatat (për të përfshirë përvojën si bashkëpunëtor ligjor ose zyrtar ligjor në gjykatë/prokurori) si dhe të përfshihet një përkufizim i harmonizuar në Ligjin për PSH.</p>	x	x			LJG, LPSH	3, 10, 11, 13, 14, 15	PJ	<p>Implementuar: Të dy Këshillat kanë dorëzuar rekomandime të politikave për përfshirjen e një dispozite në ligjet përkatëse e cila e përkufizon 'përvojën ligjore'.</p> <p>Pikë veprimi: Neni 26 i Ligjit për Gjykatat dhe Neni 19 i Ligjit për PSH duhet të ndryshohen.</p>	<p>Në amendamentet ligjore për Nenin 26, paragrafi 2 dhe Nenin 19 të LPSH është përkufizuar "përvoja ligjore" Për qëllime të këtij neni, përvoja në fushën ligjore përfshin përvojën në institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare, përvojën si noter apo si përmbartes privat. Ky rekomandim është zbatuar.</p>

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	62	Burimet e informacionit për emërim Rekomandohet që të përdorët një serë e gjërë burimesh të informacionit dhe të listohen shprehimisht me ligj burimet e informacionit të cilat Këshillat do t'i përdorin gjatë procedurës së rekrutimit dhe emërimit.	x	x		x	LKGJK; LKKPK	5, 10, 11, 13, 14, 15	PJ	Implementuar: Të dy Këshillat kanë dorëzuar rekomandime të politikave për përfshirjen e një dispozite në ligjet përkatëse e cila e përkufizon 'përvojën ligjore'. Pikë veprimi: Neni 26 i Ligjit për Gjykatat dhe Neni 19 i Ligjit për PSH duhet të ndryshohen.	Në amendamentet ndaj LKGJK, LKKPK, LGJ dhe LPSH nuk është paraparë specifikimi i mëturjshëm i burimeve të informacionit për emërim. Prandaj, KPK ka përcaktuar burimet e informacionit në Rregulloren e sapo miratuar për Rekrutimin, Provimin dhe Emërimin (të miratuar me 1 Dhjetor 2015)
II & III	63	Trajnimi i obligueshëm fillestar Rekomandohet që të parashihet trajnimi i obligueshëm fillestr për të gjithë kandidatët e emëruar si gjyqtar/prokurator, me kohëzgjatje eventuale të ndryshme për kandidatët me përvojë të mëparshme profesionale.	x	x		x	LGJ, LPSH	3, 4, 9, 11, 13, 14	PJ	Implementuar: Të dy Këshillat kanë përgatitur rekomandime të politikave për përfshirjen e një dispozite në ligjet përkatëse që kërkon trajnimin e detyrueshëm të të gjithë kandidatëve. Pikë veprimi: Ligjet duhet të ndryshohen.	Ky rekomandim është zbatuar: në amendamentet ligjore të vitit 2015 kërkohet periudha fillestare e trajnimit prej 12 muajve.
II & III	64	Kompetenca për përcaktimin e numrit të kandidatëve dhe pranimin në kursin fillestar të trajnimit Planifikimi i burimeve njerëzore duhet të përfshirë informatat afatgjate mbi numrin e personave që emërohen në pozita të paktën gjatë periudhës së mandatit të Këshillave. Kompetenca e Këshillave për të përcaktuar numrin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët pranohen në trajnim fillestar duhet të përcaktohet me ligj . Pranimi në trajnimin fillestar duhet të bazohet në një provim konkurrues, me shkrim dhe anonim dhe burime tjera të informacionit, siç janë rezultatet gjatë provimeve të mëparshme dhe duhet të zhvillohet nga KGJK/KPK. Pranimi në trajnim fillestar duhet të ofrojë garanci të lartë për kandidatët për emërim si gjyqtar/prokurator. Juritë në provimet me shkrim dhe gojore duhet të përbëhen nga gjyqtarë/prokurorë dhe persona tjerë meritore në fushat që vlerësohen.	x	x		x	LKGJK, LKKPK, LIGJK /JAL	10, 11	PJ	Implementuar: Të dy Këshillat kanë dorëzuar rekomandime të politikave për përfshirjen në ligjet përkatëse të një dispozite për harmonizimin e kërkesave për trajnim fillestar dhe për qasjen e sistemit i cili u lejon Këshillave që të vendosin për provimin pranues. Qasja e propozuar i ep një garanci për zgjedhje përfundimtare si gjyqtarë dhe prokurorë. Aktualisht është në kompetencë të Këshillave që të përcaktojnë numrin e gjyqtarëve/prokurorëve të cilët pranohen për trajnim fillestar. Në rast të ndryshimit të ligjit sipas rekomandimeve të Këshillave kjo çështje do të zgjidhet. Pikë veprimi: Nenet 17/18 të Ligjit për KGJK/KPK dhe Neni 26 i Ligjit për Gjykatat si dhe Neni 19 i Ligjit për PSH si dhe Ligji për IGJK duhet të ndryshohet. Pas ndryshimeve ligjore duhet që gjithashtu të ndryshohen edhe Rregulloret.	Amendamentet ligjore që kanë hyrë në fuqi në Korrik 2015 lidhur me sistemin e rekrutimit, përzgjedhjes dhe emërimit të kandidatëve krijojnë bazën ligjore për përgatitjen e një politike të Këshillave dhe krijimin e një politike të planifikimit për gjyqtarët dhe prokurorët e rinjë që duhet të emërohen në pesë vitet e ardhshme. Më shumë mbështetje për Këshillat në këtë fushë është e nevojshme.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	65	<p>Vlerësimi/provimet gjatë trajnimit fillestar</p> <p>Kurdo që trajnimi fillestar gjyqësor konsiderohet si parakusht për përzgjedhje dhe emërim në pozitë gjyqësore, progresi në zhvillimin e aftësive dhe njohurive të nevojshme për ushtrimin e detyrave të gjyqtarit/prokuratorit duhet të vlerësohet nga organi përgjegjës për ofrimin e trajnimit ose në bazë të rregullt ose në mënyrë periodike ose përmes provimeve në fund të trajnimit. Rezultatet e provimeve dhe vlerësimeve duhet të merren parasysh gjatë procedurës së përzgjedhjes dhe (ri)emërimit.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	5, 10, 11	PJ	<p>Implementuar: Duke marrë parasysh faktin se Kushtetuta parasheh një mandat fillestar dhe në bazë të opsioneve të politikave, Këshillat kanë përpiluar një rekomandim i cili do të sigurojë që vendimi për riemërim të merret në bazë të rezultateve të provimeve të zhvilluara gjatë periudhës fillestare të trajnimit dhe vlerësimit gjatë mandatit fillestar.</p> <p>Pikë veprimi: Neni 17/18 i Ligjit për KGJK/KPK si dhe aktet nënligjore duhet të ndryshohen.</p>	Neni 9 i LNP-LGJ ndryshon dhe plotëson Nenin 27, paragrafi 3 të ligjit bazik dhe përcakton "Gjyqtarët e emëruar do të vlerësohen pas rezultateve të trajnimit fillestar në pajtim me dispozitat përkatëse ë këtij ligji..." I njëjti amendament është bërë në LNP-LPSH, Neni 8 që ndryshon Nenin 20 të ligjit bazik. Ky rekomandim është zbatuar.
II & III	66	<p>Faza e mentorimit gjatë trajnimit fillestar</p> <p>Faza e mentorimit është fazë esenciale gjatë përgatitjeve për emërimin e një gjyqtari/prokuratorit dhe duhet të bëhet me mbikëqyrjen e Këshillave. Aktualisht, faza e mentorimit gjatë trajnimit fillestar zgjat 6 muaj. Rekomandohet që të zgjatet kjo periudhë të paktën deri në 1 vit.</p> <p>Gjatë kësaj faze, kandidatit duhet ti epet përgjegjësia hap pas hapi, në mënyrë që, në periudhën e fundit të kësaj faze ata të mund të ushtrojnë disa veprime gjyqësore/prokuratoriale dhe detyra vetëvetiu (duke përfshirë kryesimin e seancave dëgjimore), megjithëse kjo duhet të bëhet nën mentorimin e gjyqtarit/prokuratorit mentor i cili në fund duhet të nënshkruajë dhe aprovojë.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	9, 11	PJ	<p>Implementuar: Të dy Këshillat kanë përgatitur rekomandime të politikave të cilat u japin përgjegjësinë e plotë Këshillave për mentorimin e gjyqtarëve/prokuratorëve.</p> <p>Pikat e veprimit: Neni 17/18 i Ligjit për KGJK/KPK si dhe aktet nënligjore duhet të ndryshohen.</p>	Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk janë ndryshuar Nenet 17/18 të LKGJK/LKPK. Për atë që faza e mentorimit është e përfshirë në trajnimin fillestar dhe trajnimi fillestar është në kompetencë të organit për trajnim gjyqësorë, ligji i ri për AGJK (ende draft) mund të përmbajë dispozitat përkatëse. Koordinimi mes KGJK, KPK dhe AGJK në këtë fushë duhet të përcaktohet në LAGJK.
II & III	67	<p>Përzgjedhja dhe mbikëqyrja e mentorëve</p> <p>Gjyqtarët/prokuratorët mentor duhet të zgjidhen me kujdes. Krijimi i një statuti të posaçëm / akti nënligjor për gjyqtarë mentor duhet të shyrtohet (dhe që eventualisht duhet të parashikojë kompesim për ushtrimin e kësaj detyre ose të paktën lirimin e tyre nga një pjesë e punës së rregullt për ushtrimin e detyrës së mentorit, etj.), në mënyrë që të sigurohet që gjyqtarët/prokuratorët më të mirë të jenë të interesuar që të punojnë si mentor.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	9	PJ	<p>Implementuar: Të dy Këshillat kanë përgatitur rekomandime të politikave për krijimin e bazës ligjore për përzgjedhjen dhe mbikëqyrjen e mentorimit të gjyqtarëve/prokuratorëve.</p> <p>Pikë veprimi: Ligji për KGJK/KPK dhe aktet nënligjore duhet të ndryshohen/miratohen.</p>	Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk është bërë ndonjë amendament. Për atë që faza e mentorimit është e përfshirë në trajnimin fillestar dhe trajnimi fillestar është në kompetencë të organit për trajnim gjyqësorë, ligji i ri për AGJK (ende draft) mund të përmbajë dispozitat përkatëse. Mekanizmi koordinues duhet të krijohet me ligj.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	68	<p>Përgjegjësia disiplinore gjatë fazës fillestare të trajnimit Kandidatët duhet të kenë përgjegjësi disiplinore për sjelljen e tyre gjatë trajnimit fillestar nëse janë emëruar për një mandat fillestar para trajnimit fillestar. Sjelljet e parregullta (mos pjesëmarrja në kurse, komunikimi i parregullt dhe sjelljet tjera të parregullta të kandidatëve) duhet të hetohen nga ZPD dhe mund të rezultojnë në sanksione serioze të përcaktuara me ligj.</p>	x	x		x	LKGJ K; LKPK	PM	P	<p>Implementuar: Pas emërimit në mandatin fillestar, të emëruarit kanë përgjegjësi disiplinore.</p>	Ky rekomandim është implementuar
II & III	69	<p>Konsultimi me gjykatën/prokurorinë para (ri) emërimit Rekomandohet që të kufizohet kërkesa për kërkimin e opinionit nga gjykata / prokuroria përkatëse para dorëzimit të propozimit për emërim ose rimërim te Presidenti.</p>	x	x		x	Kusht , LKGJ K, LKPK	11, 13	J	<p>Pikë veprimi: Dispozitat përkatëse në Nenin 104(3) të Kushtetutës, Neni 17 (3) të Ligjit për KGJK, Neni 17 (3) të Ligjit për KPK duhet të shfuqizohen.</p>	Në amendamentet për LKGJK, LKPK, LGJ dhe LPSH nuk është paraparë ndonjë specifikim i mëtutjeshëm. Rekomandimi Nr. 69 është zbatuar pjesërisht. Neni. 31 i draft Rregullores së KGJK dhe Neni 32 i Rregullores së KPK (miratuar me 1 Dhjetor 2015) nuk i kufizojnë kushtet dhe kërkesat për kërkimin e opinionit nga gjykata ose prokuroria përkatëse, mirëpo vetëm përmendin se opinionin duhet të jetë i arsyetuar nëse përmban një vlerësim negativ të kandidatit. Opinioni ka karakter konsultativ.
II & III	70	<p>Mos emërimi në një pozitë specifike Gjyqtarët/prokurorët duhet të emërohen si gjyqtarë/prokurorë, pa përcaktuar gjykatën/prokurorinë ku do të punojnë. Caktimi i pozitës së punës bëhet më pas me vendim të KGJK/KPK. Rrjedhimisht, transferet dhe ngritjet në detyrë nuk përbëjnë emërim të ri por lëvizje/avancim në karrierë .</p>	x	x				3, 9	PJ	<p>Implementuar: Rregulloret për Procesin e Emërimit nuk i përmbajnë më këto referenca. Pikë veprimi: KGJK/KPK duhet të implementojnë këtë praktikë.</p>	Megjithëse në amendamentet e LKGJK, LKPK, LGJ dhe LPSH kjo çështje nuk është specifikuar më tutje, Neni 33 i draft Rregullores së KGJK dhe Neni 34 i Rregullores së KPK parashohin emërimin e gjyqtarëve ose prokurorëve, ndërsa Neni 32 i Draft Rregullores së KGJK dhe Neni 33 i Rregullores së KPK përcaktojnë caktimin në një pozitë specifike nën autorizimin e Këshillave përkatës.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	71	<p>Caktimi i pozitës së parë të gjyqtarit/prokurorit</p> <p>Është e këshillueshme që gjykatat/prokuroritë në të cilat vendosen gjyqtarët/prokuroretë në vitet e para të punës (gjykatat/prokuroritë me më pak ngarkesë / më pak të specializuara për të mundësuar konsolidimin gradual të aftësive gjyqësore/prokuroriale) të zgjidhen me kujdes.</p> <p>Duke marrë parasysh rangimin e kandidatëve gjatë vlerësimit nga KGJK/KPK, vaktimi i parë në një gjykatë/prokurori duhet të bëhet sipas rangimit.</p> <p>KGJK/KPK duhet të shpallë pozitat në dispozicion dhe të gjithë gjyqtarët/prokuroretë duhet të konkurrojnë për vendosje në gjykatat/prokuroritë përkatëse.</p>	x	x				9	PJ	<p>Implementuar: Rregulloret e reja e lejojnë këtë qasje.</p> <p>Pikë veprimi: KGJK/KPK duhet ta implementojnë këtë praktikë.</p>	<p>Megjithëse në amendamentet e LKGJK, LKPK, LGJ dhe LPSH kjo çështje nuk është specifikuar më tutje, Neni 32 i Draft Rregullores së KGJK dhe Neni 33 i Rregullores së KPK përcaktojnë caktimin në një pozitë specifike nën autorizimin e Këshillave përkatës. Preferencat e kandidatëve dhe procedurat e caktimit duhet të përcaktohen dhe definohen më mirë.</p>
II & III	72	<p>Emërimi në mandatin fillestar</p> <p>Emërimi për një mandat fillestar është diskutabil sa i përket pavarësisë. Megjithatë, kjo nuk duhet të interpretohet për të përjashtuar të gjitha mundësitë për emërimin e gjyqtarëve/prokuroreëve të përkohshëm. Në shtetet me sistem të ri gjyqësor mund të ketë nevojë praktike për të përcaktuar së pari nëse një gjyqtar është në gjendje të ushtrojë funksionet përkatëse para eërimit të përhershëm. Nëse emërimet e përkohshme konsiderohen të domosdoshme, 'refuzimi' për konfirmimin e gjyqtarit/prokurorit në emërim të përhershëm duhet të bëhet në bazë të kritereve objektive dhe me të njëjtat mbrojtje procedurale që janë në dispozicion në rast të shkarkimit të një gjyqtari/prokurori. Në këtë mënyrë, gjyqtarët/prokuroretë që num ri-emërohet kanë të drejtë që të marrin një vendim me shkrim dhe të arsyetuar të cilin mund ta kundërshtojnë pranë gjykatës kompetente.</p>	x	x	x		Kusht , LKGJ K, LKPK	2, 3, 5, 9, 10, 11, 14, 15, 18	PJ	<p>Implementuar: Kushtetuta parasheh emërimin për një mandat fillestar. Këshillat kanë përgatitur rekomandime të politikave të cilat sigurojnë që riemërimi të bazohet në rezultatet e provimeve të zhvilluara gjatë trajnimit fillestar si dhe të gjitha vlerësimet e mbajtura gjatë mandatit fillestar. Për procesin e ri-emërimin do të përdoren vetëm kritere objektive. Propozohet parashikimi i një procedure të apelit.</p> <p>Pikë veprimi: Në afatgjatë duhet të shqyrtohen mundësia e ndryshimit të Kushtetutës. Në bazë të sistemit aktual duhet të parashihet mundësia e shqyrtimit gjyqësor të vendimeve.</p>	<p>Në amendamentet ligjore të miratuara në vitin 2015 nuk është parapare ndonjë mundësi ankese ndaj vendimeve të Këshillave lidhur me propozimet për riemërim pranë një gjykate të pavarur Megjithatë, amendamentet ligjore përcaktojnë dy vlerësime të performancës së gjyqtarëve dhe prokuroreëve gjatë emërimin fillestar dhe rezultatet e vlerësimeve duhet të merren parasysh nga Këshillat gjatë marrjes së vendimit për propozimin për ri-emërim.</p>

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016	
II & III	73	<p>Ankesa kundër vendimit lidhur me propozimin për (ri) emërim dhe ngritje në detyrë Kandidatët e pasuksesshëm duhet të kenë të drejtë që të marrin një vendim të arsyetuar. Kjo krijon nevojën për një proces të pavarur për shqyrtimin e ankesave të cilin mund ta përdorin aplikuesit nëse besojnë se janë trajtuar në mënyrë të padrejtë gjatë procesit të emërimit.</p> <p>Gjykata Supreme konsiderohet organ i përshtatshëm për rishikimin e vendimeve të Këshillit. Mund të kufizohet në çështje ligjore dhe mund të parashihen afate strikte për aplikuesin dhe për Gjykatën Supreme (për shembull 2 javë). Këshillat duhet të obligohen nga vendimi i Gjykatës Supreme dhe të dorëzojnë një propozim për (ri) emërim për Presidentin që është në pajtim me vendimin e Gjykatës Supreme.</p>	x	x				LKGJ K, LKPK	3, 4, 5, 9, 11, 10, 20	PJ	<p>Implementuar: Të dy Këshillat kanë paraparë në rregulloret e tyre obligimin e Komisionit për Emërime dhe Rishqyrtim që ti njoftojë kandidatët me shkrim, duke përfshirë arsyetimet. Rregulloret parashohin një proces të rishqyrtimit.</p> <p>Pikë veprimi: Mjetet juridike duhet të parashihen me ligj.</p>	Në amendamentet ligjore të miratuara në vitin 2015 nuk është paraparë ndonjë mundësi për ankesë ndaj vendimeve të Këshillave lidhur me propozimin për ri-emërim. Prandaj, procedura e rishikimit pranë Komisionit për Rishqyrtim të krijuar nga Këshilli është paraparë në Rregulloren e KPK dhe draft Rregulloren e KGJK. Megjithatë, rekomandimi ende duhet të konsiderohet si pjesërisht i zbatuar.
II & III	74	<p>Formularët për procesin e (ri) emërimit Rekomandohet që të rishikohen formularët që përdoren gjatë procesit të (ri) emërimit dhe të cilët duhet të publikohen në uebfaqen e Këshillave.</p>	x	x					9	PJ	<p>Implementuar: Formularët janë përgatitur.</p> <p>Pikë veprimi: Manuali, që përmban formularët ende duhet të publikohet.</p>	Projekti ka përgatitur PSV të reja dhe ka përditësuar disa nga PSV-të e mëparshme për ti përshtatur me ndryshimet ligjore dhe me Rregulloren e re t KPK për Rekrutimin, Provimin dhe Emërimin e Prokurorëve të miratuar me 1 Dhjetor 2015. Trajnimi përkatës është organizuar në Janar 2015. KGJK ende nuk ka qenë aktive në këtë drejtim, pasi që Rregullorja përkatëse është ende duke u hartuar.
II & III	75	<p>Mos emërimi i rregullt në pozita më të larta Rekomandohet që pozitat më të larta dhe më kërkuese të caktohen kryesisht përmes ngritjes në detyrë dhe transferimit të gjyqtarëve/prokurorëve ekzistues.</p>	x	x					3	PJ	<p>Implementuar: Në proceset e fundit të rekrutimit dhe emërimit, Këshillat kanë hapur shpalljet e vendeve të lira të punës vetëm në pozitat në Gjykatat/Prokuroritë Themelore.</p> <p>Pikë veprimi: Ligji duhet që shprehimisht të kërkojnë emërimin në pozita më të larta në bazë të vlerësimit.</p>	Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk është bërë ndonjë amendament.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	76	<p>Kriteret dhe procedura e transferimit</p> <p>Kriteret e transferimit duhet të përcaktohen në mënyrë të qartë me ligj dhe masat kryesore procedurale të përcaktohen me ligj. Ligji duhet të përcaktojë se gjyqtarët/prokurorët nuk do të transferohen kundër vullnetit të tyre. Përjashtimet mund të parashikohen në rastet në vijim: si rezultat i masave disiplinore; në rast të shuarjes së pozitës së tij/saj të vendosur në bazë të kriterëve objektive dhe transparente. Duhet të shqyrtohet mundësia e përmirësimeve strukturore (dhe jo tranzitore) ose ndryshimeve në ndarjen administrative dhe territoriale si bazë për krijimin/shuarjen e pozitive.</p> <p>Ligji duhet të përcaktojë të drejtën e gjyqtarit/prokurorit pozita e të cilit është shuar që të zgjedhë gjykatën/prokurorinë në të cilën dëshiron të transferohet.</p> <p>Çdo vendim për transferim duhet të jetë me shkrim dhe i arsyetuar.</p>	x	x		x	LKGJK, LKPK	3, 4, 9, 11	PJ	<p>Implementuar: Parimi se nuk duhet të ketë transferim kundër vullnetit të personit tashmë vetëm është përfshirë në ligj.</p> <p>Pikë veprimi: Përjashtimet nga parimi për ndalimin e transfereve kundër vullnetit të personit përkatës ('rrethanat e jashtëzakonshme' ose 'mungesa e gjyqtarëve/prokurorëve') që aktualisht janë përcaktuar në Nenin 20 të Ligjit për KGJK dhe Nenin 22 të Ligjit për KPK janë të mjegullta. Ligji duhet të përcaktojë kriteret më të qarta. Gjithashtu, vendimet për transferim duhet të jenë me shkrim dhe të përmbajnë një arsyetim të rregullt. Këto aspekte procedurave gjithashtu duhet të parashihen me ligj.</p>	<p>Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk është bërë ndonjë amendament ligjor. Megjithatë, Projekti ka ofruar komente dhe rekomandime për KGJK për përmirësimin e Rregullores së KGJK për transferimin e gjyqtarëve. Ekspertët e Projektit kanë dorëzuar në KPK një koncept dokument për transferimin dhe ngritjen në detyrë të prokurorëve dhe Draft Rregulloren në pajtim me standardet Evropiane. Draft Rregullorja ende nuk është miratuar nga Këshilli.</p>
II & III	77	<p>Analiza rregullt e nevojave për transfer</p> <p>Nevoja për transfer duhet të vlerësohet nga KGJK/KPK në bazë të rregullt, mirëpo jo shumë shpesh për të shmangur mundësinë që të shndërrohet në faktor të jo stabilitetit (për shembull çdo 5 vite), dhe rezultatet e tij – duke përfshirë numrin e gjyqtarëve/prokurorëve që nevojiten në secilën gjykatë/prokurori duhet të bëhet publik.</p>	x	x		x	LKGJK, LKPK	9	PJ	<p>Implementuar: Neni 20 i Ligjit për KGJK/22 i Ligjit për KPK e ndalojnë transferimin kundër vullnetit të gjyqtarit/prokurorit.</p> <p>Pikë veprimi: Në ligj duhet të përfshihet një dispozitë e qartë për kohën e shuarjes/krijimit të pozitive të reja në gjykata/prokurori.</p>	<p>Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk është bërë ndonjë amendament ligjor. Shih komentet në R.76 më lartë</p>

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	78	<p>Kriteret për aprovimin e aplikacionit për transfer</p> <p>Transferimi i një gjyqtari/prokurori duhet të bazohet në rezultatet e vlerësimit në mënyrë që të sigurohet konkurrenca dhe zhvillimi i karrierës. Në rast të notimit të barabartë në vlerësim duhet ti epet preferencë kandidatëve nga minoritetet / gjinitë që nuk janë mirë të përfaqësuar dhe më pas atyre personave që kanë më shumë përvojë si gjyqtar/prokuror (senioriteti);</p>	x	x		x	LKGJ K; LKPK	3, 4, 9	J	Pikë veprimi: Ligji nuk përmban kritere për transfere.	Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk është bërë ndonjë amendament ligjor. Megjithatë, Draft Rregullorja e KPK për Transferimin dhe Ngritjen në Detyrë të Prokurorëve e hartuar nga Grupi Punues i KPK me mbështetjen e projektit, përcakton se transferimi duhet të bazohet në rezultatet e vlerësimit të performancës së prokurorëve.
II & III	79	<p>Parimi i pamundësisë së lëvizjes</p> <p>Rekomandohet që të zhvillohet një koncept për të siguruar parimin e pamundësisë së lëvizjes. Sistemi aktual nuk e garanton në masë të mjaftueshme parimin e pamundësisë së lëvizjes (transferi për gjashtë muaj pas aprovimit nga kryetari i gjykatës / kryeprokurori në rast të mundësisë së gjyqtarëve/prokurorëve) nuk duket se lejon fleksibilitet të mjaftueshëm (transferimi për 30 ditë në rrethana të jashtëzakonshme).</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	3, 5, 9, 11	J	Pikë veprimi: Duhet të krijohet një koncept më i qartë për parimin e pamundësisë së lëvizjes që ofron fleksibilitet të mjaftueshëm.	Ky rekomandim nuk është implementuar. Të dy Këshillat duhet të gjejnë balancën mes zbatimit të parimit të pamundësisë së shkarkimit dhe transferimit të gjyqtarëve / prokurorëve. Rekomandohet përgatitja e një koncept dokumenti.
II & III	80	<p>Apeli kundër vendimit për transfer</p> <p>Duhet të ekzistojë mundësia e apelit (për shembull para Gjykatës Supreme) kundër të gjitha vendimeve për transferimin e gjyqtarëve/prokurorëve.</p> <p>E drejta e apelit para gjykatës (Gjykatës Supreme) duhet të parashihet edhe për transfere të përkohshme, mirëpo të kufizohet në çështje të zbatimit të ligjit dhe të lejojë kompensimin ër dëmet e shkaktuara nga vendimet e paligjshme.</p> <p>Apeli nuk duhet të ketë efekt pezullues. Për balancimin e kësaj, duhet të ketë mundësi që të kërkohen masa të përkohshme për pezullimin e menjëhershëm të efekteve të vendimit të KGJK/KPK në raste të shkeljeve të dukshme ligjore ose kur zbatimi i menjëhershëm mund ti shkaktoj dëme të konsiderueshme personit të afektuar (summaria cognitio).</p>	x	x		x	LKGJ K. LKPK	3, 9, 11	J	<p>Implementuar: Ligji për KGJK tashmë vetëm parasheh një proces të apelit në rast të transferit prej gjashtë muajve ose në bazë të përhershme.</p> <p>Pikë veprimi: Për zbatimin e këtij rekomandimi kërkohet ndryshimi i ligjit. Apeli kundër vendimeve për transferimin e gjyqtarëve nuk duhet të kufizohet. Të drejtat dhe procedurat e apelit duhet të përcaktohen me ligj dhe jo me rregullore. Neni 22 (6) i Ligjit për KPK duhet të fshihet.</p>	Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk është bërë ndonjë amendament ligjor.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	81	<p>Baza e vendimi për ngritje në detyrë Kriteret për ngritje në detyrë duhet të përcaktohen me ligj sikurse edhe hapat kryesor procedural. Vendimi për ngritje në detyrë mund të merret pas kalimit të një pragu të caktuar të përvojës profesionale dhe pas një vlerësimi minimal të performancës, në mënyrë që tu ofrohet mundësia e avancimit në karrierë gjyqtarëve/prokurorëve që kanë performancë më të mirë. Në rast të ngritjes në detyrë në pozita menaxheriale (kryetar i gjykatës ose kryeprokuror), duhet të kërkohen trajnime të menaxhimit dhe aftësi menaxhues si kriter për ngritje në detyrë. Së dyti, ngritja në detyrë duhet të bazohet në senioritet (vjetërsi).</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK, LGJ, LPSH	2, 3, 4, 5, 9, 14	PJ	<p>Implementuar: Ligji për Gjykatat dhe Ligji për PSH përcaktojnë një minimum të përvojës profesionale për emërim në gjykata/prokurori më të larta. Ligji për KGJK/KPK përcakton të njëjtat kriteret për vlerësim dhe ngritje të detyrë. KGJK ka përgatitur një Rregullore për Procesin e Ngritjes në Detyrë të Gjyqtarëve. Pikë veprimi: Baza ligjore duhet të ndryshohet për të krijuar një bazë më të mirë për ngritje në detyrë. KPK ende duhet të miratojë Rregulloren përkatëse.</p>	Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk është bërë ndonjë amendament ligjor. Projekti ka hartuar një Rregullore për Transferimin dhe Ngritjen në Detyrë të Prokurorëve që pasqyron sa më shumë që të jetë e mundshme këtë rekomandim. KPK ende duhet ta miratojë Draft Rregulloren
II & III	82	<p>Organizim i transferimit dhe ngritjes në detyrë Duhet të parashihet mundësia e lëvizjes periodike të gjyqtarëve/prokurorëve për të siguruar që secili gjyqtar/prokuror të ketë mundësinë që të kërkojë transfer ose ngritje në detyrë në një pozitë të lirë (para shpalljes së lëvizjes, KGJK/KPK duhet të vlerësojë se cilat ulëse duhet të plotësohen dhe ti bëjë këto informata publike për të gjithë gjyqtarët/prokurorët). Kjo mundëson që të koncentrohen të gjitha transferet/ngritjet në detyrë në një periudhë të caktuar, në mënyrë që të minimizohet kosto e procesit.</p>	x	x				PM	J	<p>Pikë veprimi: KGJK/KPK ende duhet të krijojnë një koncept për transfere dhe ngritje të detyrë.</p>	Projekti u ka dorëzuar të dy Këshillave koncept dokumentet, analizat dhe raportet në vitin 2015 lidhur me transferimin dhe ngritjen në detyrë. Hapa të mëtejshëm duhet të ndërmerren nga Këshillat dhe Komisionet e tyre. Koncept dokumentet duhet të aprovohen nga Këshillat dhe vendimet e politikave duhet të zbatohen përshtatshmërisht.
II & III	83	<p>Pamundësia e uljes në detyrë Pas ngritjes në detyrë në një kategori superiore, një gjyqtar/prokuror nuk duhet në asnjë rat - përveç për arsye disiplinore - të ulet në një kategori më të ulët edhe nëse pozita e tij/saj shuhet.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	3	J	<p>Pikë veprimi: Ligji për KGJK/KPK duhet të sqarohet në këtë pikë.</p>	Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk është bërë ndonjë amendament ligjor.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
Vlerësimi i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve											
II & III	84	<p>Vlerësimi si detyrë e Këshillave</p> <p>Këshillat duhet të kenë kompetencën për krijimin e mekanizmeve të nevojshme për vlerësimin e sistemit gjyqësor/prokurorial dhe për vlerësimin e gjyqtarëve/prokurorëve në mënyrë të pavarur.</p> <p>Vlerësimi i sistemit duhet të dallohet nga vlerësimi i gjyqtarëve/prokurorëve individual, megjithëse disa burime të informacionit (si statistikat) mund të jenë të njëjta. Sa i përket NJSHPP në KPK, është e rëndësishme që të definohen përgjegjësitë e kësaj njësie, në mënyrë që ajo të kryejë vetëm vlerësimin e sistemit prokurorial dhe jo të prokurorëve individual.</p>	x	x		x	LKGJK; LKPK	6, 9, 11, 13, 20, 21	P	<p>Implementuar: Të dy Këshillat kanë kompetenca për vlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve individual si dhe të sistemit gjyqësor/prokurorial si tërësi. Në KPK, detyrat e NJSHPP janë sqaruar dhe kjo njësi kryen vetëm vlerësimin e sistemit dhe jo të prokurorëve individual.</p>	<p>Amendamentet e miratuara në LKGJK (Neni 19A) dhe LKPK (Neni 14B) përcaktojnë themelimin e Komisioneve të Përhershme të Këshillave për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve Prokurorëve si dhe përbërjen dhe kompetencat e tyre. Kështu që, me ligj është bërë një dallim i qartë i organeve dhe kompetencave lidhur me vlerësimin individual të performancës së gjyqtarëve/prokurorëve individual dhe organeve gjyqësore/prokuroriale.</p>
II & III	85	<p>Qëllimi i vlerësimit</p> <p>Qëllimi i vlerësimit të gjyqtarëve/prokurorëve duhet të përcaktohet me ligj. Qëllimi i vlerësimit të gjyqtarëve/prokurorëve duhet të përcaktohet me ligj dhe mund të përfshijë si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të mbështesë procesin e vazhdueshëm të përmirësimit të aftësive dhe kapaciteteve të gjyqtarëve/prokurorëve • Të inkurajojë cilësinë dhe sasinë më të mirë të punës për gjyqtarë/prokurorë • Të vendosë "etapa" konsistente për cilësinë dhe sasinë e punës që duhet të kryhet nga gjyqtarët/prokurorët në Kosovë • Të informojë vendimet e KGJK/KPK lidhur me riemërimin • Të informojë vendimet e KGJK/KPK lidhur me ngritjen në detyrë dhe transferet • Të informojë planifikimin dhe trajnimet e KGJK/KPK dhe metodat tjera të zhvillimit të karrierës profesionale • Të lehtësojë procesin e identifikimit të gjyqtarëve/prokurorëve që mund të kenë aftësi të caktuara. 	x	x		x	LKGJK; LKPK	11, 21	J	<p>Pikë veprimi: Ligjet për KGJK/KPK duhet të ndryshohen.</p>	<p>Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk është bërë ndonjë amendament ligjor. Megjithatë, ligji dhe rregulloret ofrojnë një nivel të mirë të efikasitetit lidhur me sistemin e vlerësimit të performancës së prokurorëve. Në të ardhmen, kriteret dhe indikatorët duhet të rishikohen, përmirësohen dhe zbatohen në mënyrë adekuate. Projekti ka përgatitur një koncept dokument dhe raportet përfundimtare të vlerësimit dhe ka zhvilluar trajnime për ngritjen e kapaciteteve në 2016 për KGJK, KPK, Komisionet e Vlerësimit dhe personelin mbështetës gjatë të cilave është sqaruar dhe diskutuar qëllimi i vlerësimit të performancës.</p>

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	86	<p>Kriteret e vlerësimit të gjyqtarëve/prokurorëve</p> <p>Vlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet të bazohet në kritere objektive dhe të publikuara dhe nuk duhet të përfshijë vetëm një ekzaminim të aftësive profesionale të gjyqtarëve/prokurorëve, mirëpo edhe të informatave personale, siç janë cilësitë personale dhe aftësitë e komunikimit. Të gjithë gjyqtarët/prokurorët duhet t'i nënshtrohen vlerësimit. Këshilli duhet të luajë një rol fundamental në identifikimin e kritereve të përgjithshme të vlerësimit. Kriteret e përcaktuara në ligje rekomandohet që të strukturohen në mënyrë më logjike si dhe të harmonizohen ligjet dhe rregulloret përkatëse.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	11, 15, 19, 20, 21	PJ	<p>Implementuar: Kriteret për vlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve janë përcaktuar në Ligjet për KGJK/KPK. Të dy Këshillat kanë aprovuar Rregulloret për Vlerësimin e Gjyqtarëve/Prokurorëve, që parashohin vlerësimin e përvojës ligjore, aftësive profesionale dhe kualiteteve personale.</p> <p>Pikë veprimi: Kriteret e vlerësimit janë të njëjta me ato për emërimet të përcaktuara në ligj. Ato duhet të ndryshohen në mënyrë që të strukturohen më logjikisht. Kriteret e përcaktuara në ligj duhet të ndërlidhen në mënyrë më konsistente me treguesit e përcaktuar në Rregullore.</p>	Amendamentet ligjore të miratuara në vitin 2015 nuk kanë përfshirë dispozita lidhur me rishikimin e kritereve të vlerësimit. Në të ardhmen, kriteret dhe indikatorët duhet të përmirësohen, Tani për tani, është më mirë që të mbahet struktura aktuale e Rregullores në mënyrë që të shmangen dallimet dhe pabarazitë gjatë procesit të vlerësimit.
II & III	87	<p>Pavarësia, integriteti dhe paanshmëria si kritere të vlerësimit</p> <p>Të gjithë gjyqtarët/prokurorët duhet të vlerësohen kundrejt vlerave të pavarësisë, integritetit dhe paanshmërisë që janë kualitete absolute të domosdoshme për gjyqtarë/prokurorë. Gjithashtu mund të përcaktohet se mungesa e këtyre vlerave ose vlerësimi negativ në këto vlera paraqet vlerësim negativ të përgjithshëm edhe nëse parametrat tjerë janë pozitiv. Këto pasoja duhet të përcaktohen me ligj.</p>	x	x		x	LKGJ K; LKPK	5, 9, 11, 15	PJ	<p>Implementuar: Ligji për KGJK/KPK i referohet paanshmërisë si kriter i vlerësimit. Rregullorja i referohet pavarësisë dhe paanshmërisë.</p> <p>Pikë veprimi: Pavarësia si kriter duhet të përfshihet në ligj. Pasojat e një vlerësimi negativ kundrejt këtyre kritereve duhet të shqyrtohen.</p>	Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk është bërë ndonjë amendament ligjor.
II & III	88	<p>Shpeshhtësia e vlerësimit</p> <p>Shpeshhtësia e vlerësimit duhet të përcaktohet me ligj. Mund të shqyrtohet mundësia e dallimit të kategorive të ndryshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe të ketë ndryshim të shpeshhtësisë së vlerësimit mes gjyqtarëve/prokurorëve me më shumë dhe më pak përvojë.</p>	x	x		x	LKGJ K LKPK	21	PJ	<p>Implementuar: Shpeshhtësia e vlerësimeve është përcaktuar në të dy Rregulloret.</p> <p>Pikë veprimi: Shpeshhtësia minimale e vlerësimit duhet të përcaktohet me ligj. Mund të shqyrtohet mundësia e ndryshimit të shpeshhtësisë së vlerësimit sipas viteve të përvojës së gjyqtarit/prokurorit përkatës.</p>	Në amendamentet e bëra në Ligjin për KPK janë përfshirë dispozita për shpeshhtësinë e vlerësimit të performancës. Është përcaktuar shpeshhtësia diferenciale varësisht nga vitet e përvojës së një gjyqtari/prokurori. Amendamenti është bërë në Nenin 14 të LNP-LKPK që ndryshon Nenin 21 të ligjit bazik për KPK.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	89	<p>Vlerësimi kuantitativ dhe kualitativ dhe pavarësia Kosova ka vendosur që gjyqtarët/prokurorët të vlerësohen edhe sipas treguesve kuantitativ edhe kualitativ. Kjo është në pajtim me standardet ndërkombëtare duhet të përcaktohet si parim i përgjithshëm në ligjet përkatëse. Duhet të përcaktohet shprehimisht se vlerësimi i performancës së gjyqtarëve/prokurorëve nuk duhet të ndërhyjë me pavarësinë e tyre, posaçërisht sa i përket meritave të akteve dhe vendimeve që janë nxjerrë nga ata, duke përfshirë faktet e provuara dhe të pa provuara dhe supozimet dhe vlerësimet përkatëse.</p>	x	x		x	LKGJ K; LKPK	2, 5, 9, 11, 13, 15, 21	PJ	<p>Implementuar: Rregulloret e dy Këshillave parashohin një vlerësim të bazuar në tregues kualitativ dhe kuantitativ. Pikë veprimi: Një dispozitë themelore duhet të përfshihet në ligj dhe ligji duhet të përcaktojë shprehimisht se vlerësimi i performancës së gjyqtarëve/prokurorëve nuk do të ndërhyjë me pavarësinë e tyre.</p>	Kjo dispozitë është përfshirë në Rregulloren për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve, jo në Ligjin për NP e Ligjit për KPK dhe Ligjit për PSH
II & III	90	<p>Treguesit kualitativ * Pasi që për momentin është e pamundshme që të mbështetemi në kritere të pranuar kualitative, kriteret kualitative të paktën duhet të zgjedhen me konsensus të përgjithshëm të profesionistëve ligjor. Këshillat duhet të luajnë një rol qendror në zgjedhjen dhe mbledhjen e të dhënave 'kualitative', në dizejnimin e procedurës për mbledhjen e të dhënave, në vlerësimin e rezultateve, në shpërndarjen e tyre për akterët individual në baza konfidenciale, si dhe për publikun në përgjithësi.</p>	x	x				9, 11, 21	PJ	<p>Implementuar: Të dy Rregulloret parashohin tregues të cilësisë që janë përzgjedhur gjatë përgatitjes së Rregulloreve. Pikë veprimi: Informatat për publikun duhet të zgjerohen.</p>	Nuk ka pasur ndonjë ndryshim ose veprim për zbatimin e këtij rekomandimi

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	91	<p>Burimet e informacionit Burimet e informacionit duhet të përfshijnë:</p> <p>a) një mostër të vendimeve/dokumenteve procedurale të zgjedhura nga Komisioni Vlerësues/mbikëqyrësi b) mostrat e ofruara nga personi i vlerësuar, c) dosja personale e gjyqtarit/prokurorit, d) vetë-vlerësimi, kundërshtimet dhe intervista e të vlerësuarit, e) raporti i vlerësimit nga Kryetari i Gjykatës/Kryeprokurori dhe udhëheqësi i departamentit të të vlerësuarit , f) raportet tjera të mbikëqyrësve, g) vendimet përfundimtare disiplinore, h) të dhënat statistikore të siguruara nga mbikëqyrësit dhe nga sistemit për mbledhjen e të dhënave me nivele të ndryshme të sofistikimit i) dokumentet tjera që tregojnë aftësitë menaxheriale për pozita menaxheriale (udhëzimet, planet e punës, raportet e aktiviteteve, etj), j) dokumente tjera që përmbajnë të dhëna objektive dhe relevante për aktivitetin profesional dhe sjellen personale, sipas rastit.</p> <p>Pasi të arrihet dakordimi se vlerësimi nuk duhet të përfshijë vetëm vlerësimin e përvojës ligjore dhe aftësive të përgjithshme profesionale të gjyqtarëve/prokurorëve por edhe aftësitë personale, siç janë cilësitë personale dhe aftësitë e komunikimit, duhet të shqyrtohet dobishmëria e intervistimit të akterëve tjerë të gjyqësorit si nëpunësit dhe avokatët. Burimet e informacionit duhet të përcaktohen shprehimisht me ligj.</p>	x	x		x	LKGJ K, KPLC	9, 13, 21	PJ	<p>Implementuar: Rregulloret e KGJK/KPK përmbajnë një dispozitë të përgjithshme që i referohet dokumenteve që përmbajnë informata objektive dhe relevante që ndërlidhen me aktivitetin profesional dhe sjellen personale që ndikon në aktivitetin profesional. *</p> <p>Pikë veprimi: Ligji ende duhet të ndryshohet. Pas ndryshimit të ligjit duhet të ndryshohen edhe dy Rregulloret.</p>	Ligjet për KPK dhe PSH nuk janë ndryshuar për ti përfshirë këto pika. Në Rregulloren e KP për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve janë përmirësuar burimet e informacionit.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	92	<p>Dosjet personale të gjyqtarëve dhe prokurorëve si burim i informacionit</p> <p>Dosja personale e gjyqtarëve/prokurorëve ndodhet në KGJK/KPK. Komisioni i Vlerësimit rekomandohet që të kërkojë nga Këshilli informatat që do të vlerësohen. Duke marrë parasysh faktin se disa informata mund të jenë konfidenciale për nga natyra, KGJK/KPK do të definojë paraprakisht cilat informata mund të zbulohen dhe para kujt.</p> <p>Rekomandohet që para Komisionit të Vlerësimit të zbulohen</p> <ul style="list-style-type: none"> • Informatat biografike; • Kualifikimet akademike; • Rruga profesionale; • Të dhënat disiplinore të gjyqtarit/prokurorit; • Rezultatet e procedurave të mëparshme të vlerësimit; • Nëse është e aplikueshme, përmbajtja e vendimeve të mëparshme të vlerësimit ose për çështje disiplinore; • Trajnimet e pranura <p>Vetëm vendimet përfundimtare (si vendimet e vlerësimit ashtu edhe ato disiplinore) duhet të shqyrtohen për qëllime të vlerësimit.</p>	x	x				PM	PJ	<p>Implementuar: Të dy Rregulloret i referohen dosjeve personale të gjyqtarëve/prokurorëve, të cilat duhet të zbulohen para Komisionit të Vlerësimit.*</p> <p>Pikë veprimi: Vendimi për dokumentet në dosjen personale të cilat duhet të zbulohen ende nuk është marrë. Ky rekomandim duhet të zbatohet gjatë secilit vlerësim.</p>	Praktika lidhur me përbërjen dhe ruajtjen e dosjeve personale për procesin e vlerësimit tashmë ekziston dhe duhet të konfirmohet dhe të inkurajohet. "Rregullorja për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit" duhet të përfshijë rregulla për dosjen personale (përbërjen, njësinë përgjegjëse për ruajtje, menaxhimin ...) dhe të drejtën e qasjes nga prokurori përkatës.
II & III	93	<p>Statistikat si burim i informacionit</p> <p>Duhet të sigurohet që të dhënat e përdorura për qëllime të vlerësimit të jenë gjithpërfshirëse dhe të sakta.</p>	x	x				5, 9, 13, 21	PJ	<p>Implementuar: Të dy Këshillat kanë krijuar bazën elektronike të të dhënave që përmban të dhëna relevante për secilin gjyqtar/prokuror.</p> <p>Pikë veprimi: Sistemi duhet të përmirësohet dhe zhvillohet rregullisht.</p>	Përmirësimi dhe zhvillimi përsëri rekomandohet.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	94	<p>Shkalla e kthimit si burim i informacionit</p> <p>Në Kosovë, gjyqtarët/prokurorët vlerësohen, ndër tjera, duka marrë parasysh përqindjen e vendimeve të kthyera gjatë fazës së apelit. Një vlerësim objektiv i cilësisë së vendimeve gjyqësor/prokuroriale mund të jetë njëri nga elementet relevante për vlerësimin profesional të një gjyqtari/prokurori individual, (mirëpo edhe në këtë kontekst duhet të merret parasysh parimi i pavarësisë së brendshme dhe fakti se kthimi i vendimeve duhet të konsiderohet si rezultat normal i procedurës gjyqësore/prokuroriale, pa fajin e gjyqtarit/prokurorit të parë). Rekomandohet që të shmanget përdorimi i shkallës së kthimit të vendimeve si tregues i rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së aktivitetit të gjyqësorit/prokurorisë. Duhet të theksohet se cilësia e rezultatit të një rasti të vetëm varet shumë nga cilësia e të gjitha hapave procedural (të iniciuar nga policia, prokuroria publike, avokatët dhe palët private), ashtu që vlerësimi i performancës së gjyqësorit/prokurorisë është i pamundshëm pa verësimin e secilit hap procedural në kontekst individual. Nëse shkalla e kthimit merret parasysh duhet të sqarohet se vetëm shkeljet kualitative të ligjit mund të shqyrtohen gjatë vlerësimit.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	9, 11, 13, 19, 21	PJ	<p>Implementuar: Rregullorja e KGJK i referohet shprehimisht të dhënave statistikore si tregues subsidiar dhe përcakton se vetëm shkeljet e rënda ligjore merren parasysh kur përdoret shkalla e kthimit të vendimeve si tregues.</p> <p>Rregullorja e KPK përcakton një procedurë e cila mundëson që të dhënat statistikore nuk janë faktori kryesor që merret parasysh gjatë vlerësimit.</p> <p>Pikë veprimi: Pavarësisht nga Rregullorja e KGJK, deklarimi i të dhënave statistikore si tregues subsidiar ka të bëjë kryesisht me statistikat, prandaj duhet të ndryshohet në mënyrë që të sigurohet se të dhënat statistikore përdoren de facto si faktor subsidiar gjatë vlerësimit.</p>	Ky rekomandim duhet të konsiderohet i zbatuar, përmes akteve nënligjore.
II & III	95	<p>Vendimet/aktet ligjore si burim i informacionit</p> <p>Në Kosovë aktgjykimet/vendimet e prokurorisë shqyrtohen për qëllime të vlerësimit. KGJK/KPK rekomandohen të sigurojnë që vetëm vlefshmëria formale e aktit, logjika, shpejtësia me të cilën hartohet dhe përmasat e njohurisë ligjore të gjyqtarit/prokurorit përkatës. Interpretimi i ligjit dhe vlerësimi i fakteve nga ana e gjyqtarit/prokurorit asnjëherë nuk duhet të përdoret për qëllime të vlerësimit .</p>	x	x			5, 9, 11, 15, 21	PJ	<p>Implementuar: Proporcioni mes vendimeve të prokurorëve është përshkruar gjatë trajnimit.</p> <p>Pikë veprimi: Gjatë vlerësimeve të ardhshme, Këshillat duhet ti kushtojnë vëmendje këtij rekomandimi.</p>	Projekti ka rekomanduar që në kuadër të parimeve të vlerësimit të prokurorëve të shtohet dispozita në vijim: "Vlerësimi nuk mund të ketë për objekt meritat e rastit ose përmbajtjen e vendimeve." Ky rekomandim nuk është pranuar.	

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	96	<p>Rregullat për zgjedhjen e rastësishme të vendimeve Këshillat duhet të përcaktojnë kriteret e përgjithshme për zgjedhjen e vendimeve që duhet të analizohen, në mënyrë që mostrat e zgjedhura të përfaqësojnë punën e gjyqtarit/prokurorit të vlerësuar. Për shembull, mund të vendoset numri i vendimeve që do të analizohen sipas fushës së juridiksionit, sipas fushës procedurale, sipas lëndës etj.</p>	x	x				PM	PJ	<p>Implementuar: Rregullorja e KPK përmban një rregull të përgjithshme lidhur me afatet e vlerësimit. KGJK miraton një vendim për zgjedhjen e rastësishme të gjyqtarëve në fillin të çdo viti.</p> <p>Pikë veprimi: Vendimi i KGJK për zgjedhjen e rastësishme të lëndëve përcakton vetëm numrin e lëndëve që do të vlerësohen. Gjithashtu, KPK rekomandohet që ti referohet numrit të lëndëve, mirëpo edhe fushës së juridiksionit, llojit procedural, lëndës etj.</p>	Rregullorja e KPK me ndryshime dhe plotësime (Dhjetor 2015) ka përfshirë një rregull më specifike për zgjedhjen e rastësishme të lëndëve, bazuar në përvojat paraprake
II & III	97	<p>Sjellja jashtë zyrës ose besimet personale si burim i informacionit Sjella private e gjyqtarit/prokurorit ose bindjet politike, ideologjike dhe fetare nuk duhet të merren parasysh, përveç kur këto sjellje kanë ndikim në dëmtimin e kredibilitetit të tyre profesional dhe imazhit të institucionit përkatës.</p>	x	x				3, 6, 14	PJ	<p>Implementuar: Gjatë trajnimeve është shpjeguar proporcioni pas vlerësimit të sjelljes/besimeve të gjyqtarëve/prokurorëve. Rregullorja e KPK shprehimisht përcakton se vetëm ato sjellje jashtë deytës do të vlerësohen 'që ndikojnë në aktivitetin profesional'. Rregullorja e KGJK i referohet 'informatave objektive dhe relevante për sjelljen personale të gjyqtarit që ndikon në aktivitetin e tij/saj profesional'.</p> <p>Pikë veprimi: Gjatë vlerësimeve në të ardhmen, Këshillat duhet ti kushtojnë vëmendje këtij rekomandimi.</p>	Nevojitet zbatimi i më tutjeshëm i këtij rekomandimi nga Komisionet për Vlerësim dhe Këshillat.
II & III	98	<p>Standardet e kohës për zgjidhjen e rasteve gjyqësore Nëse përputhja me standardet e kohës merret parasysh duhet të sigurohet që dallimet në vështirësinë dhe volumin e easteve nuk ndikojnë negativisht në vlerësim.</p>	x					21	P	<p>Implementuar: Rregullorja e ndryshuar e KGJK dhe Rregullorja e KPK nuk i referohen (më) standardeve të kohës.</p> <p>Pikë veprimi: Rregullorja e KGJK për Përcaktimin e Normës së Punës së Gjyqtarëve e mat punën e gjyqtarëve në parametra shumë të përgjithshëm, duke iu referuar përbërjes së panelit ose nëse rasti është zgjidhur me pranimin e fajësisë.</p>	Nuk ka pasur ndonjë ndryshim ose veprim për zbatimin e këtij rekomandimi

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	99	<p>Renditja për zgjidhjen e rasteve</p> <p>Ky tregues është i padobishëm dhe mund të jetë edhe paragjykes. Pas vlerësimit të përputhshmërisë me afatet kohore për zgjidhjen e rasteve dhe për hartimin e vendimeve gjyqësore, vlerësimi i respektimit të renditjes për zgjidhjen e rasteve nuk është më i nevojshëm.</p> <p>Nuk rekomandojmë që të mos vonohet një rast vetëm që të respektohet renditja e zgjidhjes së rasteve.</p>	x					PM	J	<p>Pikë veprimi: Rregullorja e KGJK duhet të ndryshohet për të definuar më mirë renditjen e zgjidhjes së rasteve .</p>	Nuk ka pasur ndonjë ndryshim ose veprim për zbatimin e këtij rekomandimi
II & III	100	<p>Procedura për vlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve</p> <p>Procedura duhet të përfshijë pjesëmarrjen e atyre personave në pozita mbikëqyrëse dhe duhet ti lejojë gjyqtarëve/prokurorëve që të shprehin qëndrimet e tyre lidhur me aktivitetet dhe për vlerësimin e këtyre aktiviteteve. Gjyqtarët/prokurorët duhet të kenë të drejtën e hartimit të raporteve për veten e tyre, të japin një profil të aktiviteteve të tyre profesionale dhe të përcaktojnë kriteret organizative që kanë për qëllim përmirësimin e nivelit të efikasitetit, dhe subordinimin e funksioneve të zyrës. Gjyqtarët/prokurorët duhet të kenë të drejtën që të dëgjohen. Gjithashtu, Këshilli nuk duhet të zëvendësojë organin gjyqësor përkatës për vlerësimin individual të gjyqtarëve dhe në mënyrë të tërthortë të prokurorëve. Dispozitat kryesore duhet të gjenden në ligje.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	3, 9, 13, 19, 20, 21	PJ	<p>Implementuar: Rregulloret e dy Këshillave parashohin vlerësimin nga Kryeprokurori/Kryetari i Gjykatës dhe mundësinë që gjyqtarët/prokurorët të kryejnë një vetë-vlerësim si dhe të kundërshtojnë ndaj vlerësimit në fazat e ndryshme të procedurës. Gjatë trajnimeve, rëndësi e veçantë i është kushtuar shpjegimit të dallimit mes vlerësimit dhe rishikimit gjyqësor.</p> <p>Pikë veprimi: Në ligjin përkatës duhet të përfshihen dispozita themelore. Gjithashtu mund të parashihet përfshirja e një interviste të obligueshme.</p>	Ligjet e ndryshuara dhe plotësuara për KPK dhe PSH nuk e përmbajnë këtë dispozitë.
II & III	101	<p>Notimi i vlerësimit dhe pasojat e vlerësimit</p> <p>Në fund të vlerësimit, nota duhet të epet, që mund të jetë pozitive, e kënaqshme ose e pakënaqshme. Një notë mesatare ose e ulët e obligon gjyqtarin ose prokurorin që ti nënshtrohet trajnimeve specifike profesionale ose kurseve të rikualifikimit. Në përgjithësi, një vlerësim i dytë negativ do të vendosë shkarkimin e gjyqtarit ose prokurorit nga zyra. Shkalla e notave dhe, në veçanti fushëveprimi i secilës notë si dhe pasojat e vlerësimit duhet të përcaktohen me ligj, për shkak të sigurisë ligjore dhe transparente.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	20, 21	PJ	<p>Implementuar: Të dyja Rregulloret parashohin notimin në fund të vlerësimit.</p> <p>Pikë veprimi: Baza ligjore për notimin dhe pasojat e vlerësimit ende duhet të përcaktohen.</p>	Ligjet për KPK dhe PSH nuk e përmbajnë këtë dispozitë. Aktet nënligjore mund të konsiderohet si bazë adekuate ligjore.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	102	Notimi sipas kritereve dhe jo sipas treguesve Rekomandohet që të notohen vetëm kriteret dhe jo secili tregues. Treguesit që nuk janë relevant për gjyqtarin/prokurorin përkatës, ose nëse nuk ka tregues të caktuar, nuk është e nevojshme që të përdoret. Treguesit do të shishen si mjet për lehtësimin e vlerësimit të disa kritereve.	x	x				21	PJ	Implementuar: Proporcioni i këtij rekomandimi është shpjeguar gjatë trajnimeve. Pikë veprimi: Rekomandimi duhet të implementohet në secilin proces të vlerësimit.	Për prokurorët notimi bëhet sipas indikatorit dhe sipas kritereve. Notimi vetëm i kritereve kursen kohën mirëpo është më pak transparent. Rregullat e qarta të notimit janë përcaktuar në Rregullore.
II & III	103	Ankesat kundër vendimeve të vlerësimit Procedura duhet ti lejojë gjyqtarit/prokurorit që të ankohet për vendimin e vlerësimit para një autoriteti të pavarur ose një gjykate. Një ankesë në Gjykatën Supreme mund të konsiderohet. Ankesa mund të kufizohet në çështje ligjore.	x	x		x	LKGJ K, LKPK	3, 9, 11, 19, 20, 21	J	Pikë veprimi: Ligji për KGJK/KPK duhet të ndryshohet.	Ligjet për KPK dhe PSH me ndryshime dhe plotësime nuk i përmbajnë këto dispozita.
II & III	104	Profili i anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit Në mënyrë që të garantohet transparencja e nominimit, profili i anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit duhet të përcaktohet me ligj/akt nënligjor, duke siguruar që ata anëtarë të kenë përvojën profesionale dhe një nivel të lartë të performancës profesionale. Për këtë qëllim, dispozitat ligjore mund të kërkojnë një minimum të senioritetit dhe një notë minimale në vlerësim.	x	x			LKGJ K; LKPK	21	PJ	Implementuar: Rregullorja për KGJK kërkon që kryesuesi i Komisionit të Vlerësimit të jetë gjyqtar nga Gjykata Supreme dhe të gjithë anëtarë të kenë të paktën 5 vite përvojë pune si gjyqtarë. Rregullorja e KPK kërkon që anëtarët të zgjedhen nga disa nivele të shërbimit prokurorial. Pikë veprimi: Të dy Këshillat duhet të përcaktojnë rregulla më të qarta për profilin e anëtarëve. Nuk mjafton që anëtari të jetë gjyqtar/prokuror i një niveli të caktuar, por gjithashtu duhet të ketë pasur performancë të shkëlqyeshme gjatë një periudhe të caktuar kohore.	Ky rekomandim është adresuar pjesërisht përmes shtimit të dispozitës në vijim në Nenin 11 të Ligjit për NP, që ndryshon Nenin 14B të ligjit bazik: 1. Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve përbëhet nga prokurorët me përvojë dhe integritet të lartë oral dhe personal. I njëjti model është miratuar për Komisionin e Vlerësimit të KGJK (amendamentet në nenin 19 të LKGJK)

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	105	<p>Sesioni trajnues për performancën vjetore</p> <p>Përveç vlerësimeve të rregullta nga KGJK/KPK rekomandohet që të konsiderohet obligimi i Kryetarit të Gjykatës/Kryeprokurorit për të mbajtur një "sesion vjetor të trajnimit për performancën" me të gjithë gjyqtarët/prokurorët në gjykatën/prokurorinë e tyre. Ky sesion duhet të regjistrohet me shkrim. Qëllimi i këtij sesioni mund të jetë që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të identifikohen pikat e forta dhe të dobëta • Të adresohen dobësitë e performancës në fazën e tyre të hershme dhe të dakordohen objektivat dhe masat për të siguruar që gjyqtari/prokurori të përmirësohet • Të identifikohen dhe zhvillohen nevojat e trajnimit dhe të hartohet një plan i trajnimit dhe karrierës për secilin gjyqtar/prokuror • Të adresohen dobësitë e identifikuar nga Komisioni për Vlerësimin e Performancës <p>Ky instrument parimisht duhet të përdoret si mjet zhvillimi dhe të bazohet në bashkëpunim. Nuk duhet të shihet si mjet për kontrollimin e gjyqtarëve/prokurorëve, por si mjet për t'i inkurajuar ata që të përmirësohen, të planifikojnë karrierën etj.</p>	x	x				21, PM	J	<p>Pikë veprimi: Rekomandohet mbajtja një sesioni vjetor për performancën.</p>	Ky rekomandim nuk është implementuar

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	106	<p>Detyrat e NJSHPP</p> <p>Mandati i Njesisë është përcaktuar në Ligjin për KPK, që ndër tjera përcakton se NJSHPP duhet të raportojë për punën e prokurorive (Neni 15.1. LKPK). Rekomandohet që Neni 2.1 i Rregullores për Funkzionimin e NJSHPP të harmonizohet me ligjin përkatës dhe të përcaktohet se NJSHPP është organ nën drejtimin e KPK dhe se, ndër tjera, ka mandatin për mbledhjen e informatave nga të gjitha prokuroritë për performancën individuale të prokurorëve dhe për organizimin e punës së prokurorive, dhe ti paraqesë gjetjet para KPK në mënyrë të rregullt dhe sipas kërkesës nga KPK.</p>		x				PM	P	Implementuar: Rregullorja është ndryshuar në Tetor 2013.	Në amendamentet e miratuara me 28 Maj 2015 përcaktohet themelimi i një Sekretariati të ri për KPK dhe nxjerrja e një Rregullore për Sekretariatin. Rekomandohet që struktura dhe detyrat e NJSHPP të rishikohen dhe ndryshohen sipas amendamenteve të reja ligjore dhe dokumenteve të politikave të KPK
II & III	107	<p>Detyrat e Zyrës për Trajnime në NJSHPP</p> <p>Neni përkatës i Rregullores për Funkzionimin e Zyrës për Trajnime në NJSHPP nuk është në pajtim me Ligjin për IGJK dhe Ligjin për KPK. Ofrimi i trajnimeve është kompetencë e IGJK. Sipas Nenit 4.1.23 të Ligjit për KPK, KPK do të "përcaktojë politikën, standardet dhe udhëzimet për trajnimin e prokurorëve dhe personelit tjetër dhe të mbikëqyrë zbatimin e trajnimit profesional dhe zhvillimit të prokurorëve nga instituti ose shoqatat apo organizatat tjera të trajnimit". Rregullorja duhet të ndryshohet për tu harmonizuar me ligjet përkatëse.</p>		x				PM	P	Implementuar: Rregullorja është ndryshuar në Tetor 2013.	Në amendamentet e miratuara me 28 Maj 2015 përcaktohet themelimi i një Sekretariati të ri për KPK dhe nxjerrja e një Rregullore për Sekretariatin. Rekomandohet që struktura dhe detyrat e Zyrës së Trajnimeve të rishikohen dhe ndryshohen në pajtim me amendamentet e reja ligjore, Rregulloret dhe dokumentet e politikave të KPK lidhur me trajnimin e prokurorëve. Projekti ka dorëzuar një koncept dokument për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Nëntor 2015

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
Sistemi Disiplinor											
II & III	108	Procedurat disiplinore si detyrë e Këshillave Duhet të sigurohet që kompetenca për zhvillimin e procedurave disiplinore ti epet plotësisht Këshillave ose kryesisht Këshillave në bashkëpunim me organet e tjera, për shembull organet përgjegjëse për hetime.	x	x		x		3, 5, 6, 11, 13, 16, 18, 20,	P	Implementuar: Kushtetuta dhe Ligjet për KGJK/KPK u japin Këshillave kompetencën për zhvillimin e procedurës disiplinore. Hetimi zhvillohet nga ZPD.	Statusi i këtij rekomandimi mbetet i pandryshuar
II & III	109	Parimet e Përgjithshme Parimet e përgjithshme të procedurës disiplinore duhet të përcaktohen me ligj, si p.sh: <ul style="list-style-type: none"> • Parimi i ligjshmërisë • Parimi i barazisë para ligjit • Prezumi i pafajësisë • Parimi in dubio pro reo • Parimi i proporcionalitetit • Parimi i pavarësisë dhe paanshmërisë • Parimi i publicitetit • Parimi i konfidencialitetit 	x	x		x	LKGJ K, LKPK	2, 3, 4, 9, 22	J	Pikë veprimi: Dispozitat themelore lidhur me procedurën disiplinore duhet të përfshihen në ligj.	Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk është bërë ndonjë amendament ligjor. Statusi i këtij rekomandimi mbetet i pandryshuar.
II & III	110	Përbërja e Këshillave gjatë procedurës disiplinore / Procesi i rishqyrtimit të Këshillat dhe ankesat para gjykatës së pavarur Rishikimi i vendimeve të Komisionit Disiplinor nga Këshillat duhet të jetë procedurë e rishqyrtimit, që kufizohet në çështje të ligjit. Prandaj, Këshilli nuk duhet të obligohet që të mbajë një seancë dëgjimore për të respektuar standardet e gjyqimit të drejtë. Gjithashtu, vendimet e Këshillit duhet të rishikohen nga një gjykatë e pavarur (për shembull Gjykata Supreme). Gjatë kësaj procedure të ankimit, të gjithë anëtarët e Komisioneve Disiplinore, mund të marrin pjesë në procedurën e rishqyrtimit.	x	x		x	LKGJ K, LKPK	3, 6, 9, 11, 13, 22	PJ	Implementuar: Të dy Këshillat kanë përgatitur rekomandime të politikave për përcaktimin e procedurës së rishqyrtimit në Këshillat përkatës si dhe një procedurë të apelit pranë Gjykatës Supreme. Kjo zgjidhje gjithashtu zgjidh edhe problemin e hasur nga KPK kur ka pasur mungesë të kuorumit gjatë vendosjes së 'apeleve' në procedurë disiplinore. Pikë veprimi: Ndryshimi i ligjit është në pritje.	Rekomandimi për parimin e shqyrtimit gjyqësor të vendimeve disiplinore të Këshillave nuk është marrë parasysh dhe nuk është përfshirë në kuadër të ndryshimeve në Ligjet për KGJK/KPK.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	111	<p>Rotacioni i anëtarëve të Komisionit Disiplinor</p> <p>Rotacioni i anëtarëve të Komisionit, gjatë mandatit pesë vjeçar të anëtarëve të Këshillit mund të lejojë një qasje të ndryshme dhe të frytshme ndaj çështjeve të ndjeshme sikurse përgjegjësia disiplinore e gjykatarëve/prokurorëve, duke i dhënë kështu një mundësi anëtarëve të Këshillave që të kenë një pjesëmarrje më intensive dhe efektive në këtë kompetencë të rëndësishme të Këshillave.</p> <p>Rekomandohet që kjo çështje të parashihet me ligj. Megjithatë, pasi që Ligji për KGJK/KPK nuk e parandalon rotacionin e anëtarëve të Komisionit kjo çështje ka mundësi të parashihet edhe me rregullore, duke përcaktuar një madat 2.5 vjeçar në Komisionin Disiplinor dhe ndryshimin e anëtarëve të Komisionit Disiplinor në mesin e mandatit të tyre 5 vjeçar.</p>	x	x				PM	J	<p>Pikë veprimi: Duhet të shqyrtohet mundësia e krijimit të një sistemi të rotacionit për anëtarët e Komisionit Disiplinor.</p>	Statusi i këtij rekomandimi mbetet i pandryshuar.
II & III	112	<p>Përkufizimi i shkeljes disiplinore</p> <p>Rekomandohet që të përkufizohet më mirë 'problemi i performancës', 'neglizhenca në performancë', 'dështimi për të performuar', 'shpërdorimi i funksioneve gjyqësore/prokuroriale', 'dështimi për të performuar në mënyrë të pavarur' dhe 'dështimi për të performuar në mënyrë të paanshme'. Këto terme duhet të përkufizohen në pajtim me parimin 'nulla poene sine lege'. Gjithashtu duhet të bëhet dallimi i qartë i shkeljeve disiplinore nga problemet e performancës.</p> <p>Shkeljet disiplinore gjithmonë duhet të përcaktohen me ligj dhe jo me rregullore.</p>	x	x		x	LKJK, LKPK	1, 5, 6, 13, 14, 18, 20, 22	J	<p>Pikë veprimi: Ligjet duhet të ndryshohet përkatësisht. Neni 34 (3) i Ligjit për KGJK që parasheh se KGJK mund të nxjerrë rregullore për përcaktimin e shkeljeve disiplinore duhet të fshihet .</p>	Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk është bërë ndonjë ndryshim ligjor.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	113	<p>Veprimet e gabueshme gjyqësore/prokuroriale si shkelje disiplinore</p> <p>Një veprim gjyqësor/prokurorial asnjëherë nuk duhet ti nënshtrohet procedurës disiplinore, pasi që këto veprime mund të kundërshtohen vetëm përmes ushtrimit të mjeteve juridike të përcaktuara me ligj, përveç në rastet e shkeljeve të rënda ligjore të shkaktuara nga injoranca apo neglizhenca e pafalshme.</p>	x	x		x	LKGJK, LKPK	5, 11, 13, 15, 20, 21, 22	J	<p>Pikë veprimi: Ligjet duhet të bëjnë dallimin e qartë mes shkeljeve disiplinore nga ato çështje që kontestohen me mjete juridike. Në praktikë, kjo ndarje duhet të bëhet nga praktika gjyqësore .</p>	Statusi i këtij rekomandimi mbetet i pandryshuar.
II & III	114	<p>Shkeljet disiplinore dhe problemet e performancës</p> <p>Standardet etike përcaktojnë praktikën e mirë. Jo çdo shkelje e standardeve të sjelljes profesionale të përcaktuara në Kodin e Etikës Profesionale përbën shkelje disiplinore. Kodi i Etikës shërbën vetëm si instrument i vetë-rregullimit dhe si rregulla të përgjithshme që udhëzojnë aktivitetet e gjyqtarëve/prokurorëve. Vetëm dështimet serioze për respektimin e standardeve profesionale do të konsiderohen. Kërkohet një dispozitë më e qartë për shmangien e automatizmit mes shkeljes së standardeve të Kodit të Etikës dhe shkeljes sipas Ligjit.</p>	x	x		x	LKGJK, LKPK	6, 11, 13, 21, 22	J		Statusi i këtij rekomandimi mbetet i pandryshuar.
II & III	115	<p>Komentari i Parimeve të Bangalorit si dokument udhëzues gjatë procedurave disiplinore</p> <p>Gjatë përcaktimit nëse një rast përbën shkelje disiplinore apo problem të performancës, Komisionet Disiplinore të Këshillave rekomandohet që të përdorin Komentarin e Parimeve të Bangalorit, i cili përmban një përmbeldhje të standardeve më të mira ndërkombëtare lidhur me vlerat kryesore të gjyqësorit.</p>	x	x				14	PJ	<p>Implementuar: Projekti ka përgatitur një tabelë të korrelacionit që i ndërlidh dispozitat e Kodit të Etikës për Prokurorë me dispozitat ligjore në Kosovë dhe paragrafet e Komentarit të Parimeve të Bangalorit. Disa ekstrakte nga komentari janë përkthyer në gjuhën Shqipe dhe i janë dorëzuar Këshillave.</p> <p>Pikë veprimi: Gjatë intepretimit të ligjit organet relevante këshillohen që të konsultojnë këto dokumente.</p>	Tabela e korrelacionit e përgatitur nga Projekti dhe e dorëzuar në KGJK, KPK dhe ZPD në vitin 2013 është dokument shumë i dobishëm që duhet të zbatohet nga organet disiplinore. Ky rekomandim nuk është zbatuar.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	116	<p>Shkeljet disiplinore të anëtarëve të Këshillave</p> <p>Nevojitet një dispozitë specifike që përcakton shkeljet disiplinore për anëtarët e këshillave si dhe rregulla më të qarta për kriteret për pezullime si dhe procedurën që duhet të aplikohet në këto raste.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	9, 22	J	Pikë veprimi: Ligjet duhet të ndryshohen përkatësisht.	Statusi i këtij rekomandimi është pjesërisht i zbatuar për shkak se nuk është përfshirë në amendamentet e Ligjit për KGJK/KPK. KGJK ka miratuar një Rregullore për procedurën disiplinore ndaj anëtarëve të Këshillit. KPK ende ka një draft rregullore për këtë qëllim. Të dy rregulloret janë komentuar nga Projekti. Rekomandimet përkatëse janë dorëzuar në vitin 2015.
II & III	117	<p>Dispozitat themelore procedurale</p> <p>Duhet të vendoset nëse në Ligjin për KGJK/KPK të përfshihet një dispozitë lidhur me ruajtjen e të dhënave, marrjen e provave, kërkesat lidhur me provat etj. Një zgjidhje alternative është që të referohemi në dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, pasi që ligjit për KGJK/KPK nuk përmban dispozita të këtilla.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	2, 3, 4, 6, 9, 22	J	Pikë veprimi: Ligjet duhet të ndryshohen përkatësisht .	Statusi i këtij rekomandimi mbetet i pandryshuar.
II & III	118	<p>Inicimi i procedurës disiplinore</p> <p>Ligjvënësi duhet të vendosë se kujt do ti jape kompetencën për iniciimin e procedurës disiplinore, duke përfshirë hetimet. Në shumicën e shteteve, hapja e një procedure disiplinore, duke përfshirë hetimet, bëhet nga Këshilli kompetent ose në shtetet që nuk kanë Këshill nga organi i pavarur disiplinor. Hapja e hetimeve disiplinore ndaj një gjyqtari/prokurori është vendim që ka ndikim të fuqishëm në reputacionin, punën e përditshme, karrierën dhe jetën personale të gjyqtarit/prokurorit përkatës.</p> <p>Varësisht nga ky vendim themelor, ligji duhet të sigurojë harmonizimin e kompetencave të ZPD dhe procedurës mes ZPD dhe Komisioneve Disiplinore.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	3, 6, 13, 14, 18, 22	J	Pikë veprimi: Ligjet duhet të ndryshohen përkatësisht.	Statusi i këtij rekomandimi mbetet i pandryshuar.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016	
I	119	<p>Natyra dhe detyrat e ZPD si dhe kualifikimet, përzgjedhja dhe mandati i personelit të ZPD</p> <p>ZPD është organi kompetent për hetimin e çështjeve disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë. Detyrat dhe përgjegjësitë e ZPD dhe personelit të saj duhet të përcaktohen me ligj dhe të mbulojnë të paktën aspektet në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kompetencat dhe përgjegjësitë e ZPD • kualifikimet e personelit të ZPD, duke marrë parasysh se Drejtori dhe Prokurorët Disiplinor duhet të jenë gjyqtarë ose prokurorë me të paktën 8 vite përvojë, të cilët duhet të caktohen me vendimin e përbashkët të dy Këshillave bazuar në kritere objektive që bazohen në meritë dhe në konkurrencë të hapur • kualifikimet e personelit mbështetës të ZPD • përzgjedhja, mandati, përgjegjësitë dhe përgjegjësia disiplinore e Drejtorit/Prokurorëve Disiplinor/Personelit në ZPD • pezullimi i Drejtorit dhe Prokurorëve Disiplinor • detyrat dhe kompetencat e Drejtorit/Prokurorëve Disiplinor, që të marrin masat e nevojshme për zhvillimin e hetimeve të rregullta • konflikti i interesit dhe kufizimi për ushtrimin e detyrave të Drejtorit/Prokurorëve Disiplinor • raportimi i ZPD • bashkëpunimi me organet tjera • Buxheti i ZPD • komunikimi me publikun (zëdhënësi, cfarë informata do të zbulohen, duke përfshirë si rregull përtej konfirmimit ose mohimit të ekzistimit të një ankese, shpjegimit të hapave të përgjithshëm procedural të ndërmarrë nga ZPD dhe kërkesës për të mos pasur një gjykim të paragjykuar nga opinioni publik etj). 				x	x	LKGJ K, LKKP	14, 20, 22	J	<p>Implementuar: Disa dispozita themelore tashmë vetëm ndodhen në Ligjet për KGJK/KPK.</p> <p>Pikë veprimi: Nevojitet një ligj i veçantë për fushëperimin dhe përgjegjësitë e ZPD.</p>	<p>Statusi i këtij rekomandimi mbetet i pandryshuar. Draft Ligjit për ZPD dhe një koncept dokument për këtë draft ligj janë hartuar me kontributin e ekspertëve të Projektit në vitin 2015. Megjithatë, Draft Ligji për ZPD është ende në shqyrtim dhe diskutim pranë MD.</p>

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016	
I	120	<p>Dispozitat themelore të procedurës hetimore Ligji duhet të përmbajë të paktën dispozitat themelore në vijim për procesin e hetimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • fushëveprimi, përkufizimet dhe parimet e përgjithshme (pavarësia, paanshmëria, mos-diskriminimi, prezumimi i pafajësisë, hetimet e obligueshme, ...) • mbajtja e shënimeve dhe konfidencialiteti (qasja e drejtpërdrejtë në të gjitha provat e mbledhura gjatë hetimit (preliminar) nga gjyqtari/prokurori nënkupton, domosdoshmërisht, ekzistimin e shënimeve (me shkrim, audio ose video) të dëshmitarëve gjatë hetimit, të gjitha provat, etj) • afatet e parashkrimit • përkufizimi i një ankese, ankesat anonime, pasojat e tërheqjes së ankesës (parashtruesit e ankesave nuk duhet të kenë të drejtë të iniciojnë ose të insistojnë në marrjen e masave disiplinore por duhet të informohen për rezultatin përfundimtar të procedurës disiplinore), rregullat për rastet kur mund të zbulohet dhe nuk mund të zbulohet identiteti i ankuesit • kriteret për pranimin e ankesave • caktimi i rasteve • shqyrtimi fillestar dhe vlerësimi i ankesave • refuzimi i një ankese me mundësi të rishikimit nga Këshillat • shqyrtimi preliminar i një ankese • refuzimi i një ankese pas shqyrtimi preliminar me mundësi të shqyrtimit nga Këshilli • vendimi për hapjen e një hetimi në bazë të një ankese ose ex officio • hetimi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve intervista dhe marrja e provave • suspendimi i hetimeve • mbyllja e hetimeve me procedurën e shqyrtimit të Këshillit • rekomandimi për iniciimin e procedurës disiplinore dhe përmbajtja e rekomandimit • përfaqësimi i ZPD para KD, ri-referimi i rasteve në ZPD • dispozitat kalimtare 			x	x		LKGJ K, LKPK	2, 3, 6, 9, 13, 14, 22	J	<p>Implementuar: Ligjet për KGJK/KPK përmbajnë vetëm disa dispozita.</p> <p>Pikë veprimi: Nevojitet një ligj i veçantë për procedurën hetimore.</p>	Shih komentin më lartë në R.119
I	121	<p>Funksionimi i ZPD ZPD sikurse çdo institucion tjetër i pavarur mund të nxjerrë rregullore të brendshme për funksionimin dhe organizimin. Rregulloret e brendshme duhet të përcaktojnë rregullat për caktimin e rasteve. Rregulloret (me efekt të palët e treta) nuk duhet të përsërisin atë që tashmë është përcaktuar me ligj, nuk duhet të përmbajnë përshkrime të punës, të mos përcaktojnë të drejta dhe detyrime të cilat krijohen me ligj.</p>	x	x	x	x	LKGJ K, LKPK	SL, 20	J	<p>Pikë veprimi: ZPD rekomandohet të nxjerrë rregullore të brendshme për organizimin dhe funksionimin e saj. Këshillat rekomandohen të respektojnë pavarësinë e ZPD të përcaktuar me ligj.</p> <p>Ligji duhet të përmbajë rregulla më të qarta për kompetencën e ZPD si organ i pavarur. Në veçanti, duhet të sqarohet kuptimi i Neneve 33/43 si në raport me Nenet 36/46 të Ligjeve për KGJK/KPK.</p>	Statusi i këtij rekomandimi mbetet i pandryshuar.	

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
I	122	Rekrutimi i personelit të ZPD ZPD, KGJK, KPK dhe organet kompetente për rekrutimin e shërbyesve civil rekomandohen që të krijojnë një mirëkuptim të përbashkët për mënyrën e interpretimit të ligjeve dhe akteve nënligjore për rekrutimin e personelit të ZPD. Për këtë qëllim nevojiten dispozita më të qarta ligjore.	x	x	x	x	LKGJ K, LKPK	PM	J	Pikë veprimi: Elaborimi i një kuptimi të përbashkët për interpretimin e ligjeve dhe akteve nënligjore lidhur me rekrutimin e personelit të ZPD. Ndryshimi i ligjeve për përcaktimin e bazës së qartë të rekrutimit për rekrutimin e personelit të ZPD është në pritje .	Statusi i këtij rekomandimi mbetet i pandryshuar.
I	123	Mbajtja e dosjeve, shënimeve dhe komunikimeve me palët ZPD, Komisionet Disiplinore dhe Këshillat rekomandohen të sigurojnë mbajtjen adekuatë të shënimeve dhe të rishikojnë procedurat standarde të veprimit me qëllim të respektimit të parimeve dhe standardeve të aplikueshme.	x	x	x			PM, 9	PJ	Implementuar: Standardet e mbajtjes së të dhënave janë trajtuar në trajnimin e ofruar nga projekti dhe janë rekomanduar në 3 Manualet për KGJK/KPK/ZPD dhe në formularët përkatës. Pikë veprimi: Kërkohet më shumë vëmendje për përmirësimin e performancës gjatë kryerjes së hetimeve dhe procedurës disiplinore.	PSV dhe rekomandimet lidhur me ruajtjen e dosjeve, të dhënave dhe komunikimin me palët të përgatitura nga Projekti dhe të përfshira në trajnimet pilotë të zhvilluara nga Projekti janë përdorur pjesërisht nga KGJK, KPK dhe ZPD
II & III	124	Pranueshmëria, refuzimi pa hetim/seancë dëgjimore Rekomandohet që të parashihen kritere të pranueshmërisë për hetime/procedura disiplinore si dhe të sqarohet kur një procedurë mund të vendoset pa zhvillimin e hetimeve/procedurës disiplinore si dhe të sqarohet kur një procedurë mund të vendoset pa zhvillimin e hetimeve/seancës dëgjimore, p.sh tejkalimi i afateve të parashkrimit dhe vdekja e të dyshuarit. Ricaktimi/pensionimi/pushimi i të dyshuarit nuk duhet të jetë arsye për mbylljen e hetimeve ose procedurës disiplinore.	x	x		x	LKGJ K, LKPK	2, 6, 9, 22	J	Pikë veprimi: Ligjet duhet të ndryshohen përkatësisht.	Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk është bërë ndonjë amendament ligjor. Statusi i këtij rekomandimi mbetet i pandryshuar.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	125	<p>Afatet e parashkrimit</p> <p>Rekomandohet që të caktohen afatet e parashkrimit. Në Evropë këto afate ndryshojë shumë nga shteti në shtet. Duhet të përcaktohen rregullat për fillimin e afateve të parashkrimit, ndërprerjen e afateve të parashkrimit në rast të përsëritjes dhe për pezullimet në rast të inicimit të procedurës penale/administrative/civile lidhur me të njëjtat fakte.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	2, 9, 22	PJ	<p>Implementuar: Të dy Këshillat kanë përgatitur rekomandime për vendosjen e afateve të parashkrimit.</p> <p>Pikë veprimi: Ndryshimi i ligjit është në pritje.</p>	<p>Ky rekomandim është zbatuar pjesërisht përmes procesit të ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për KGJK dhe KPK, në fuqi që nga 15 Korriku 2015. Rekomandimi është pasqyruar në nenin 15 të Ligjit për NP të Ligjit për KGJK në nenin 17 të ligjit për NP të Ligjit për KPK. Në të dyja rastet, afati i parashkrimit për hetimet disiplinore dhe procedurën disiplinore janë përcaktuar. Megjithatë, për shkak të mungesës së analizës së politikave para përgatitjes së ndryshimeve ligjore, nuk është përfshirë një dispozitë kalimtare për lëndët disiplinore aktualisht në pritje. Për këtë arsye, shumë lëndë duhet të hedhen poshtë në bazë të dispozitave të reja ligjore.</p>
II & III	126	<p>Ndryshimi i fushëveprimit të lëndës ose zgjerimi i fushëveprimit të lëndës</p> <p>Në cilëndo fazë të hetimeve dhe procedurës disiplinore mundtëketë nevojë për ndryshimin e fushëveprimit të lëndës për shkak të provave të reja. Rregullat për këtë çështje duhet të përcaktohen me ligj. Gjatë fazës së hetimeve, vendimet duhet të merren dhe gjyqtari/prokurori përkatës duhet të informohet. Nëse një gjë e tillë ndodh gjatë procedurës disiplinore, Komisioni Disiplinor duhet ta referojë rastin në ZPD nëse ka nevojë për hetime shtesë. Kur nuk ka nevojë për hetime shtesë, gjyqtari/prokurori përkatës duhet të informohet dhe ti epet kohë e mjaftueshme për paraqitjen e provave të tij/saj. Kur kjo ndodh gjatë një seance dëgjimore, seanca duhet të pezullohet.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	SL, 1, 9	J	<p>Pikë veprimi: Ligjet duhet të ndryshohen përkatësisht.</p>	<p>Statusi i këtij rekomandimi mbetet i pandryshuar.</p>
II & III	127	<p>Afatet kohore</p> <p>Afatet kohore për hapjen e hetimeve, mbajtjen e një seance dëgjimore, diskutimet dhe për miratimin e vendimit dhe ekzekutimin e sanksionit duhet të përcaktohen me ligj.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	2, 9, 17, 18	PJ	<p>Implementuar: Ligjet përmbajnë rregulla për afatet kohore për seancat dëgjimore dhe për dorëzimin e propozimeve për shkarkim si dhe për apele.</p> <p>Pikë veprimi: Periudha e parashkrimit për marrjen e vendimit duhet të përfshihet në ligj.</p>	<p>Statusi i këtij rekomandimi mbetet i pandryshuar.</p>

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	128	<p>Të drejtat e gjyqtarëve/prokurorëve në procedurë disiplinore Ligji duhet të përcaktojë të paktën të drejtat në vijim për gjyqtarët/prokurorët në procedurë disiplinore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Së bashku me një kopje të vendimit për incimin e procedurës disiplinore, gjyqtari duhet të nftohet shprehimisht se duhet të dorëzojë, brenda një afati të caktuar kohor, mbrojtjen e tij, të thërrasë një numër të kufizuar të dëshmitarëve, të bashkëngjisë dokumente ose të kërkojë masa tjera të provave; • Gjyqtari/prokurori i akuzuar mund të asistohet nga një avokat dhe gjyqtari/prokurori/avokati ose përfaqësuesi duhet të kenë qasje të drejtpërdrejtë në dosjet ose materialin e hetimit preliminar, gjatë të njëjtit afat kohor; • Parimi i barazisë së armëve duhet të respektohet. • Gjyqtari/prokurori duhet të ftohet që të japë deklaratën/provat e tij dhe mjetet tjera për mbrojtjen e fakteve; • Si rregull, seanca dëgjimore duhet të jetë publike, përveç rasteve të përjashtuara sipas të drejtës ndërkombëtare, dhe ligji duhet të përcaktojë shprehimisht të drejtën e gjyqtarit/prokurorit, avokatit ose përfaqësuesit të tij që të jetë i pranishëm gjatë seancave dëgjimore dhe të ekzaminojë dëshmitarët. • Vendimi duhet të jetë i arsyetuar dhe sanksioni të jetë në proporcion me seriozitetin e shkeljes dhe të bëhet publik; • Duhet të parashihet mundësia e ankesës. 	x	x		x	LKGJ K, LKPK	1, 3, 6, 9, 13, 14, 18, 22	PJ	<p>Implementuar: Ligji për KGJK/KPK parasheh qasjen në dosje, mbrojtjen nga avokati dhe vetë-mbrojtjen.</p> <p>Pikë veprimi: të drejtat duhet të përcakthen më qartë dhe duhet të sqarohet çështja e apeleve .</p>	Statusi i këtij rekomandimi mbetet i pandryshuar.
II & III	129	<p>Seancat disiplinore Rregullat themelore për seancat disiplinore duke përfshirë kur duhet të jenë publike dhe kur të mbyllura si dhe rregullat për ndërprerjen e seancave dëgjimore duhet të përcaktohen me ligj. Seancat- si rregull- duhet të jenë të hapura, mëgjithatë, nën rrethana specifike (për shembull urdhër publikë, siguri kombëtare, mbrojtje të privatësisë) duhet të jetë mundësia të mbyllet për publikun.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	1, 3, 6, 9, 13, 18, 21, 22	PJ	<p>Implementuar: Ligjet për KGJK/KPK përcaktojnë se, në përgjithësi, seancat do të jenë të hapura.</p> <p>Pikë veprimi: Dispozitat përkatëse duhet të përfshihen në ligj.</p>	Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk janë bërë amendamente ligjore.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	130	<p>Procesverbalet e seancave dëgjimore</p> <p>Duhet të përgatitet procesverbali nga secila seancë dëgjimore. Komitetet Disiplinore/Këshillat rekomandohet të sigurojë që procesverbalet të nënshkruhen nga palët e pranishme në seancën dëgjimore. Në këtë mënyrë sigurohet mbrojtja e të drejtave dhe interesave ligjore të palëve . Palët mund të paraqesin komentet e tyre nëse transkripti nuk është i saktë dhe/ose të kërkojnë korrigjimin/plotësimin e pjesëve të caktuara të transkriptit nëse ato nuk janë shënuar në mënyrë të rregullt. Nëse regjistrimi audio nuk është i qartë në disa pjesë, kjo duhet të identifikohet në transkript. Palët nuk mund të shtojnë elemente të reja, pasi që seanca dëgjimore është e mbyllur. Megjithatë, kjo qasje do të siguronte korrektësinë dhe vlerën e regjistrave/transkripteve si njëra nga provat kryesore për vendimmarrje nga KD, KGJK/KPK. Kjo çështje gjithashtu duhet të parashihet me ligj.</p>	x	x		x	LKGJK, LKPK	PM	PJ	<p>Implementuar: Procesverbalet përgatiten rregullisht në bazë të transkripteve të seancave dëgjimore. Nevoja për nënshkrimin e tyre është përcaktuar qartë në Manualin e përgatitura nga Projekti dhe kjo çështje është diskutuar gjatë trajnimeve.</p> <p>Pikë veprimi: Organet kompetente duhet të sigurojnë që palët të informohen për disponueshmërinë e procesverbaleve dhe të kërkohet nga to që ti nënshkruajnë ato. Ligjet duhet të ndryshohen përkatësisht.</p>	Statusi i këtij rekomandimi mbetet i pandryshuar.
II & III	131	<p>Vendimi dhe diskutimet</p> <p>Për vendimin përfundimtar, angazhimi i ekspertëve, përfizimi i lëndës së opinionit të ekspertëve, ndërprerja e seancës dëgjimore, vendimi i KD/KGJK/KPK do të jetë i nevojshëm. Secili anëtar i KD/KGJK/KPK mund të kërkojë në cilëndo kohë vendimin përkatës. Ligji duhet të parashoh që përveç vendimeve përfundimtare, vendimet e KD/KGJK/KPK gjatë procedurës nuk i nënshtrohen ankesës.</p> <p>Duhet të përcaktohet shprehimisht se pas shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe provave, KD/KGJK/KPK do të refuzojë rekomandimet e ZPD në rastet e përcaktuara me ligj ose të vendosë një masë disiplinore.</p>	x	x		x	LKGJK, LKPK	PM, 3, 9, 11	J	<p>Pikë veprimi: Ligjet duhet të ndryshohen përkatësisht.</p>	Amendamentet përkatëse në LKPK dhe LKGJK (Neni 16 LNP-LKGJK+GJ dhe Neni 17, LNP-LKPK rregullojnë pjesërisht kompetencat e Këshillit në rast të ankesave dhe përmbajtës së publikimeve të vendimeve përfundimtare. Megjithatë, aspektet tjera të rekomandimit nuk janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së amendamenteve.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	132	<p>Përcaktimi i masës disiplinore Ligji duhet të përcaktojë elementet të cilat duhet të konsiderohen gjatë zgjedhjes së masës disiplinore, siç është shkalla e përgjegjësisë disiplinore; motivet për kryerjen e veprimit; puna dhe sjellja e mëparshme e gjyqtarit ose prokurorit; shkalla e rrezikimit ose dëmtimit të vlerës së mbrojtur; rrethanat në të cilat është kryer veprimi; dhe rrethanat personale të gjyqtarit ose prokurorit përkatës dhe sjellja e tij pas kryerjes së veprimit përkatës. Rrethanat lehtësuese dhe rënduese gjithashtu duhet të përcaktohen me ligj.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	2, 3, 6, 14, 22	J	Pikë veprimi: Ligjet duhet të ndryshohen përkatësisht.	Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk janë bërë amendamente ligjore.
II & III	133	<p>Masat disiplinore Rekomandohet që të rritet numri i sanksioneve disiplinore në mënyrë që të lehtësohet zbatimi i parimit të proporcionalitetit. Duhet të konsiderohen masat në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vërejtja me shkrim e cila nuk duhet të bëhet publike; • Vërejtja publike; • Reduktimi i pagës deri në maksimumin prej 50% (pesëdhjetë përqind) për një periudhë deri në një (1) vit ; • Transferimi i përkohshëm ose i përhershëm në një gjykatë ose prokurori tjetër; • Ulja në detyrë nga Kryetar i Gjykatës në gjyqtar të thjeshtë ose nga Kryeprokuror në prokuror të thjeshtë; • Shkarkimi nga detyra. <p>Ligji duhet të përcaktojë kushtet në të cilat masat do të konsiderohen efektive, parandaluese dhe proporcionale.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	2, 3, 5, 6, 9, 14, 15, 17, 22	PJ	<p>Implementuar: Ligjet për KGJK/KPK përmbajnë një listë të masave disiplinore.</p> <p>Pikë veprimi: Më shumë masa rekomandohen dhe një sqarim nevojitet për kohën kur duhen aplikuar këto masa.</p>	Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk janë bërë amendamente ligjore.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	134	<p>Pezullimi nga detyra</p> <p>Ligji duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë se pezullimi mund të bëhet vetëm në rastet e shkeljeve të rënda (duke iu referuar sanksionit që mund të vendoset) dhe kur vazhdimi i qëndrimit në punë mund të paragjykojë hetimin e rastit përkatës ose nëse dëmton gjyqësorin/prokurorinë si dhe prestigjin dhe dinjitetin e funksionit. Gjithashtu, Ligji duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë se zbatimi i pezullimit duhet të kryhet në mënyrë që të mbrohet dinjiteti personal dhe profesional i gjyqtarit/prokurorit. Koha maksimale e pezullimit duhet të përcaktohet me Ligj (për shembull jo më shumë se 180 ditë; ish RREGULLORJA E UNMIK-ut 2001/8 parashihte një afat prej 90 ditëve për pezullimin e përkohshëm). Gjithashtu duhet të përcaktohen rregulla dhe kompetenca të qarta procedurale.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	2, 22	J	<p>Pikë veprimi: Ligjet duhet të ndryshohen përkatësisht.</p>	<p>Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk janë bërë amendamente ligjore</p>
II & III	135	<p>Veprimet urgjente</p> <p>Vendimi për pezullimin nuk ndërlidhet domosdoshmërisht me vendimin për përgjegjësinë disiplinore. Ligji për KGJK/KPK qartësisht i referohet cilësdo fazë të procedurës së hetimit ose disiplinore për të lejuar Komisionit Disiplinor që të veprojë dhe të vendosë për pezullimin pa përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore. Kjo i mundëson organit kompetent që të reagojë në mënyrë të përshtatshme dhe të shpejtë në rastet në të cilat sjellja e një gjyqtari/prokurorori rrezikon dëmtimin e reputacionit të gjyqësorit/shërbimit prokurorial. Rekomandohet që të veprohet sa më shpejtë që të jetë e mundshme. Megjithatë nuk ka nevojë që të ketë nguti aq të madhe sa të rrezikohet shkelja e të drejtave themelore.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	SL, 1, 2,	J	<p>Pikë veprimi: Ligji për KGJK/KPK duhet të ndryshohet dhe plotësohet për të krijuar një bazë më të mirë për pezullime. Neni 23 i Rregullores së KPK për Performancën e Komisioneve Disiplinore duhet të shfuqizohet plotësisht. KGJK/KPK rekomandohen që të reagojnë në rastet urgjente duke aplikuar procedurën e pezullimit dhe jo duke e ngutur procedurën disiplinore deri në atë masa sa të shkelin të drejtat themelore.</p>	<p>Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk janë bërë amendamente ligjore.</p>

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	136	<p>Referenca në llojet e ndryshme të shkeljeve disiplinore në vendime.</p> <p>Ligji për KGJK/KPK parasheh disa lloje të ndryshme të shkeljeve disiplinore. Vendimet duhet ti referohen në mënyrë të qartë njëjës apo më shumë shkeljeve të listuara në ligj. Në praktikë duhet të përcaktohen vija të qarta ndarëse mes llojeve të ndryshme të shkeljeve, ashtu që sjelljet e njëjta/ngjashme gjithmonë të subsumohen në llojin e njëjtë të shkeljes disiplinore. Llojet në vijim të shkeljeve janë paraparë me ligj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • vendimi përfundimtar për shkelje penale • neglizhenca në performancë • dështimi në performancë • shpërdorimi i funksionit • dështimi për ushtrimin e funksioneve në mënyrë të pavarur • dështimi për ushtrimin e funksioneve në mënyrë të paanshme • shkelja e kodit të etikës (shih rekomandimet më lartë) 	x	x				SL, 1	J	<p>Pikë veprimi: Një rishikim i vendimeve ka shfaqur se ligji nuk është duke u aplikuar në mënyrë të njëtrajtshme. Është e rëndësishme që të krijohet praktika gjyqësore. Komisionet Disiplinore dhe Këshillat rekomandohen që të përdorin listën kontrolluese për klasifikimin e shkeljeve diLPSHInore të përgatitur nga Projekti dhe të vendosur në Manual.</p>	<p>Statusi i këtij rekomandimi mbetet i pandryshuar. Lista kontrolluese e përgatitur nga Projekti dhe e shpërndarë në KGJK, KPK dhe ZPD. Gjithashtu është përfshirë në programet e trajnimit. Zbatimi i listës kontrolluese do të lehtësojë punën e personave dhe organeve të përfshira në procedurën disiplinore.</p>

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	137	<p>Përmbajtja e Rekomandimit të ZPD dhe Vendimi i Komisioneve Disiplinore/Këshillave</p> <p>Struktura e Rekomandimit të ZPD dhe vendimet në procedurë disiplinore duhet të ndjekin të njëjtin model dhe të përmbajnë të paktën:</p> <ul style="list-style-type: none"> • definimin e qartë të lëndës duke iu referuar dispozitave përkatëse ligjore / llojit të shkeljes • masën disiplinore të propozuar / vendosur duke u referuar në dispozitat përkatëse ligjore • kursin e procedurës (përshkrimin e hapave të ndërmarrë) • motivimin, duke përfshirë <ul style="list-style-type: none"> - bazën ligjore - përmbledhjen e fakteve të provuara - shqyrtimin e provave/fakteve (që mungon në shumicën e vendimeve!) - subsumimi (shpjegoni si dhe pse faktet i plotësojnë të gjitha elementet e ligjit, referimin në praktikën gjyqësore, etj) • udhëzimin për mjetet juridike (vetëm për vendime) 	x	x				11, 9, 22	PJ	<p>Implementuar: Elementet kryesore tashmë vetëm ndodhen në rekomandimet/vendimet.</p> <p>Pikë veprimi: Ende ka hapësirë për përmirësime.</p> <p>Rekomandimet e strukturura mirë e lehtësojnë procedurën dhe procesin e vendimmarrjes para Komisioneve Disiplinore / Këshillave. Vendimet e strukturuar mirë ndihmojnë në zbatimin e njëtrajshëm të ligjit dhe krijimin e praktikës gjyqësore.</p>	<p>Amendamentet e LGJK/LKPK (Neni 16 i LNP-LKGJK dhe Neni 17 i LNP-LKPK) kanë përcaktuar në përgjithësi përmbajtjen e vendimeve disiplinore që duhet të përfshijnë:</p> <p>"Vendimi i tillë i Këshillit duhet të jetë i arsyetuar sa i takon provave të administruara nga të dyja palët, interpretimit të shkeljeve të pretenduara, dhe masës së dënimit të argumentuar që do t'i përshtatej arritjes së qëllimit të përcaktuar me këtë ligj. Në një rast të tillë, vendimi i Këshillit duhet të reflektojë, dhe të arsyetojë, zbatimin e parimit të proporcionalitetit në vendosje për çështjen e tillë. Një vendim i tillë bëhet transparent sipas kushtëzimeve të ligjit mbi të dhënat personale të Republikës së Kosovës." Nevojitet mbështetje e mëtutjeshme për ZPD, KGJK dhe KPK e bazuar në PSV të siguruara na projekti.</p>

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	138	<p>Apelimi para një gjykate të pavarur. Duhet të parashihet mundësia e apelimit të vendimeve disiplinore të Këshillave. Gjykata Supreme është gjykata më e përshtatshme për apelimin e vendimeve të Këshillave. Rekomandohet parashikimi i mundësisë së apelit për meritat e rastet, duke përfshirë rishikimin e fakteve. E drejta e apelit duhet ti epet gjyqtarit/prokurorit përkatës dhe ZPD: Apeli duhet të ketë efekt pezullues. Afati i apelimit duhet të jetë më shumë se 2 javë.</p> <p>KGJK/KPK duhet ti propozojë Presidentit shkarkimin e gjyqtarit/prokurorit nga detyra vetëm nëse kjo kërkohet sipas një vendimi përfundimtar dhe të plotfuqishëm.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	2, 3, 4, 6, 9, 11, 13, 16, 17, 18, 20, 21, 22	PJ	<p>Implementuar: Të dy Këshillat kanë përgatitur rekomandime të politikave për krijimin e procedurës së apelit para Gjykatës Supreme.</p> <p>Pikë veprimi: Ndryshimi i ligjeve është ende në pritje.</p>	Statusi i këtij rekomandimi mbetet i pandryshuar.
II & III	139	<p>Ekzekutimi i vendimit përfundimtar Ligji duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë se Këshilli është përgjegjës për procesimin e të gjitha sanksioneve të përcaktuara me vendim përfundimtar. KGJK/KPK duhet të dorëzojë vendimin përfundimtar për rekomandimin për largimin e gjyqtarit ose prokurorit nga Presidenti.</p> <p>Prokurori ose gjyqtari duhet të njoftohet nga Këshilli lidhur me vendimin e Presidentit për shkarkim.</p> <p>Gjithashtu, ligji duhet të përcaktojë shprehimisht se Këshillat i ekzekutojnë vendimet përfundimtare brenda një periudhe të caktuar kohore, p.sh:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 3 muaj për vërejtje ose reduktim të pagës; • 6 muaj për transferim ose ulje në detyrë; • 1 vit për pezullim ose shkarkim nga detyra 	x	x		x	LKGJ K, LKPK	PM, 9,	J	<p>Pikë veprimi: Ligjet duhet të ndryshohen përkatësisht.</p>	Statusi i këtij rekomandimi mbetet i pandryshuar.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III 140	<p>Publikimi i vendimeve disiplinore</p> <p>Ligji qartazi duhet të përcaktojë në çfarë mënyre dhe ku të kërkojë në mënyrë të qartë që vendimet përfundimtare të KD/KGJK/KPK ose gjykatës (për shembull duhet të publikohen në uebfaqen e Këshillave në mënyrë anonime duke konsideruar që seancat si rregull duhet të jenë të hapura). Në këtë mënyrë jo vetëm gjyqësori por edhe publiku i përgjithshëm është i informuar për mënyrën se si ka shkuar procedura dhe për të treguar se gjyqësori nuk ka për qëllim të mbulojë veprimet shqetësuese të anëtarëve të tij.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	1, 11, 13, 22	J	Pikë veprimi: Ligjet duhet të ndryshohen përkatësisht.	Amendamentet në Nenin 16 të LNP-KGJK dhe Nenin 17 të LNP-LKPK kanë paraparë në përgjithësi aspektet e publikimit të vendimeve disiplinore – shih më lartë R.137
II & III 141	<p>Dosja disiplinore</p> <p>Në disa shtete Evropiane, sanksionet e shqiptuara për shkelje disiplinore fshihen nga dosja e gjyqarit/prokuratorit në mënyrë automatike pas një periudhe të caktuar kohore, periudhë kjo që ndërlihet me seriozitetin e shkeljes. Në shtete të tjera, gjyqtari ose prokurori mund të kërkojë fshirjen e shkeljes disiplinore nga dosja . Në këto raste, Këshilli ose gjykata përkatëse disiplinore mund të vendosë për fshirjen apo jo të shkeljes disiplinore nga dosja. Në shtete të tjera, argumentohet se fshirja automatike pas një periudhe të caktuar kohore i bashkon të gjithë gjyqtarët/prokuratorët së bashku: ata që gjithnjë kanë pasur sjellje shembullore dhe ata që kanë kryer vazhdimisht shkelje disiplinore. Baza ligjore në rastin e Kosovës duhet të përcaktohet me ligj.</p>	x	x		x	LKGJ K, LKPK	PM	J	Pikë veprimi: Ligjet duhet të ndryshohen përkatësisht.	Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk janë bërë amendamente ligjore.

Katalogu i Rekomandimeve

Komponenti	Nr. i Rek.	Rekomandimi	KGJK	KPK	ZPD	MeD/Kuvendi	Akti ligjor përkatës	Standardi ndërkombëtar/tjera	Statusi i implementimit	Komente nga Korriku 2014	Komentet Përfundimtare Shkurt 2016
II & III	142	<p>Dokumentimi i praktikës gjyqësore Vendimet disiplinore janë vendime shumë të ndjeshme. Interpretimi i njëtrajtshëm i ligjit dhe trajtimi i barabartë i të gjithë gjyqtarëve/prokurorëve është i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe për rritjen e vesimit të publikut në sistem. Rekomandohet që të përmirësohet dokumentimi i vendimeve, të shtohen/fshihen fjalët kyçe, fjalitë kyçe të vendimeve dhe që këto vendime dhe dokumente të jenë në dispozicion të gjyqtarëve/prokurorëve dhe publikut.</p>	x	x				PM, 11	J	<p>Implementuar: Dokumentacioni deri më tani është një përmbledhje e thjeshtë e vendimeve. Pikë veprimi: Dokumentimi i vendimeve duhet të përmirësohet dukshëm.</p>	Statusi i këtij rekomandimi mbetet i pandryshuar.

Shkurtesat:

PM..... Praktikant më të Mira
 Kusht ... Kushtetuta
 LKGJK..... Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës
 LKPK..... Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës
 LGJ..... Ligji për Gjykatat
 JAL..... Ligji për Akademinë e Drejtësisë
 LPSH..... Ligji për Prokurorin e Shtetit
 KD..... Komisioni Disiplinor
 ZPD..... Zyra e Prokurorit Disiplinor
 SL..... Sundimi I Ligjit

P.....Plotësisht e implementuar
 PJ.....Pjesërisht e implementuar
 J..... Nuk është implementuar

Ngjyrat:

rozë fushat prioritare në të cilat kërkohet ndryshimi/plotësim i ligjit
 gjelbërfushat prioritare në nivel operacional



An EU funded project managed by
the European Union Office in Kosovo